



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**PASQYRAT FINANCIARE
FONDET NË MIRËBESIM
PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 30 SHTATOR 2016**

PËRMBAJTJA

PASQYRA E GJENDJES SË FONDEVE NË MIRËBESIM	4
GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM	5
LLOGARITË E ARKËTUESHME	6
LLOGARITË E PAGUESHME	7
DETYRIMET KONTIGJENTE	8
HYRJE	10
1.1. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE	10
1.2. SUBJEKTI RAPORTUES	10
1.3. RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË	11
1.4. VALUTA RAPORTUESE	11
1.5. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE	11
1.6. FORMATI DHE LIDHJA E PASQYRAVE FINANCIARE ME SHËNIMET SHPJEGUSE	11
TË HYRAT	12
2. TË HYRAT NGA SHITJA	12
2.1. SHITJET E REALIZUARA PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT DHE LIKUIDIMIT NGA AKP	12
2.2. SHITJET E REALIZURA NGA ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS	12
2.3. SHITJET E REALIZUARA NGA NDËRMARRJET SHOQËRORE	13
3. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË	13
4. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË E KOMERCIALIZIMIT	13
5. INTERESI I FITUAR	13
6. TARIFA PËR PJESËMARRJEN E TENDERËVE TË SHITJES	14
7. TË HYRAT E TJERA	14
8. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	14
SHPENZIMET/SHPËRNDARJA	15
9. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK	15
10. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE	15
10.1. KONTRATA BAZË	16
10.2. ANEKS KONTRATA - 10% E VLERËS SË KONTRATËS BAZË	16
10.3. GARANCION BANKAR	16
11. MALLRA DHE SHËRBIME	17
12. SHËRBIMET PUBLIKE	18
13. TATIMET	18
14. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE (DEPOZITA DHE TAKSA)	18
15. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-SË	18
16. SHPENZIME TË TJERA	18
16.1. PARAJA E IMËT NGA LLOGARITË E LIKUIDIMIT	19
17. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-VE NË LIKUIDIM	19
18. FONDET TEPRICË TRANSFERUAR QE VERISË SË KOSOVËS	19
LLOGARITË E ARKËTUESHME	20
19. NDËSHKIMET NDAJ NSH-VE ME SPIN-OFF SPECIAL	20

20.	SHITJA E ASETVE PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT	21
21.	QIRAJA APO TË HYRAT TË TJERA	21

LLOGARITË E PAGUESHME 22

22.	OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE	22
23.	MALLRA DHE SHËRBIME	22
24.	OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSH-VE	22
25.	DETYRIMET KONTIGJENTE	23

TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE 24

26.	TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM	24
27.	LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE	24

Raporti i Aktiviteteve për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.....1/67

PASQYRA E GJENDJES SË FONDEVE NË MIRËBESIM
PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR 2016

		1	2	3=1+2
PËRSHKRIMI	SHËNIMI SHPJEGUES NR.	DERI MË 31 DHJETOR 2015	TRANSAKSIONET Hyrje/dalje	GJENDJA DERI MË 30 SHTATOR 16
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE				
Të hyrat nga shitjet	2	664,937,929	1,036,338	665,974,267
Të hyrat nga qiraja	3	14,875,555	3,580,912	18,456,467
Qiraja nga komercializimi	4	5,021,319	-	5,021,319
Interesi i fituar	5	34,844,700	-	34,844,700
Tarifa për pjesëmarrjen në tenderat e shitjes	6	7,512,464	-	7,512,464
Të hyra të tjera	7	5,123,101	666,883	5,789,984
Kapitali themeltar i Agjencisë	8	1,013,200	-	1,013,200
GJITHSEJ PRANIMET		733,328,267	5,284,133	738,612,400
SHPENZIMET/SHPËRNDARJA				
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	9	104,245,154	4,363,491	108,608,645
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)	10	10,710,902	3,341,799	14,052,701
Mallra dhe shërbime	11	9,796,874	1,523,876	11,320,750
Shërbime publike	12	827,690	212,546	1,040,236
Tatimet	13	2,358,024	595,079	2,953,103
Vendimet e gjykatave/përmbaruesve (depozita dhe taksa)	14	1,740,001	19,043	1,759,044
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	15	25,848,000	6,300,000	32,148,000
Të tjera	16	692,348	11,271	703,618
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së	17	45,140	13,271,078	13,316,218
Fondet tepriçë transferuar Qeverisë	18	90,244,911	-	90,244,911
GJITHSEJ SHPENZIMET/SHPËRNDARJA		246,509,042	29,638,183	276,147,225
		31 Dhjetor 2015	Hyrje/Dalje	30 SHTATOR 16
GJENDJA BANKARE		486,819,224	(24,354,050)	462,465,175

GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM
PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR 2016

	30 SHTATOR 2016	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
PËRSHKRIMI I LLOGARIVE BANKARE	SHUMA	SHUMA	SHUMA
Privatizim	10,384,503	9,724,189	122,250,942
Likuidim	412,981,267	427,135,392	385,590,737
Para të NSH-ve në mirëbesim	4,337,752	3,544,638	6,893,134
Komercializim	3,667,287	3,667,287	3,667,287
Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët	21,802,277	25,021,170	27,809,806
Depozita nga tenderët e privatizimit	-	-	321,749
Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim	267,527	267,527	267,537
Depozita nga tenderët e shitjeve me Likuidim	10,000	10,000	1,043,427
Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim	335,609	335,609	223,503
Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit	25	25	25
Kapitali themeltar i AKP-së	1,109,549	1,109,549	1,109,549
Fondi rezervë i AKP-së	1,000,000	1,000,000	1,300,459
Donator	8,463	8,463	8,463
Tarifa administrative e AKP-së	6,560,914	14,995,375	19,841,679
Paratë e Llogarisë Rrjedhëse në llogari për depozita kohor	1	1	-
Investimet në letrat me vlerë	- €	- €	- €
GJITHSEJ	462,465,175	486,819,225	570,328,298

LLOGARITË E ARKËTUESHME

PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR 2016

Departamentet/ Njësitë dhe Regjionet	VITI 2015	2	3=1+2	PËRSHKRIMI I LLOGARIVE TË ARKËTUESHME 2016		
		NDRYSHIMET GJATË VITIT 2016	GJITHSEJ	NDËSHKIME PËR SPIN- OFF SPECIALE	SHITJE E ASETEVE NË PRIVATIZIM DHE LIKUIDIM	QIRA TË PAINKASUAR A
Njësia e Monitorimit të NSH-ve	34,437,433	-	34,437,433	34,437,433	-	-
Departamenti i Shitjes	1,592,134	(951,000)	641,134	-	641,134	-
ZR Prishtina	11,058,630	980,580	12,039,210	-	-	12,039,210
ZR Pejë	80,824	3,128	83,952	-	-	83,952
ZR Mitrovicë	826,066	91,087	917,153	-	-	917,153
ZR Gjiilan	529,163	956,189	1,485,352	-	-	1,485,352
ZR Prizren	48,017	8,471	53,200	-	-	53,200
Gjithsej	48,572,267	1,088,454	49,657,433	34,437,433	641,134	14,578,866
JANË SHPALOSUR NË SHËNIMET SHPJEGUESE NUMËR:				19	20	21

LLOGARITË E PAGUESHME

PËR PERIUdhËN JANAR - SHTATOR 2016

	1	2	3=1+2	PËRSHKRIMI I LLOGARIVE TË PAGUESHME 2016		
Departamentet/ Njësitë dhe Regjionet	VITI 2015	Ndryshimet 2016 vs 2015	GJITHSEJ	Ofruesi i Shërbimeve Profesionale	Mallra dhe Shërbime	Kreditorët e NSh-ve
Departamenti për Koordinim të likuidimit	2,124,228	(733,618)	1,390,610	40,096	5,242	1,329,855
ZR Prishtinë	11,735	85,374	97,108	-	97,108	-
ZR Mitrovicë	6,451	(5,853)	597	-	597	-
ZR Pejë	493	6,677	7,170	-	7,170	-
ZR Gjiilan	14,673	18,843	33,516	-	33,516	-
ZR Prizren	1,536	11,113	12,649	-	12,649	-
Gjithsej	2,159,115	(617,465)	1,541,650	40,096	156,282	1,329,855
JANË SHPALOSUR NË SHËNIMET SHPJEGUESE NUMËR:				22	23	24

DETYRIMET KONTIGJENTE

PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR 2016

			1=2+3+4	2	3	4	
Natyrë e detyrime ve kontigjente	Viti i ndodhjes	Arsyeja për detyrime	Gjithsej vlera potenciale deri më 30 Shtator 2016	Kategoria e mundësisë	Vlera potenciale 2016	Vlera potenciale 2015	Gjithsej vlera potenciale të bartura deri më 2014
Kontratë	të ndryshme	Sipas Urdhrit Përmbaues P.nr.479/15, kompensim ne shumë prej 8.216.91 Euro	8,216.91	e ultë	-	8,216.91	-
Kontratë	të ndryshme	Sipas Urdhrit Përmbaues P. nr.397/2015, kompensim ne shumë prej 2.640.00 Euro	2,640.00	e ultë	-	2,640.00	-
Kontratë	të ndryshme	Sipas Urdhrit Përmbaues P. nr.1342/11, kompensim ne shumë prej 3.440.00 Euro	3,440.00	e ultë	-	3,440.00	-
Padi për anulim kontrate	të ndryshme	Sipas Aktgjykimit SCC-09-0135, shpenzime procedurale, në shumë prej 1500 Euro	1,500.00	e ultë	-	1,500.00	-
Kontratë	të ndryshme	Sipas Aktgjykimit SCC-08-0095 -Padia per humbjen e fitimit, kompensimit ne shumen prej 14,478,50 si dhe avokatin ne shumen prej 365,04 Euro.	14,843.54	e ultë	-	-	14,843.54
Padi kompensimi	të ndryshme	Sipas Aktgjykimit SCC-07-0059- Urdhërohet AKM-ja, te ia beje pagesen prej 59,807,04 E, si dhe shpenzimet e e gjykates prej 780 eurove. NSh Famipa	60,587.04	e ultë	-	-	60,587.04
padi kompensimi	të ndryshme	Aktgjykimi SCC-10-00214, AKP-ja detyrohet per pagesen e 35400. NSh Magjistratja Peje	35,400.00	e ultë	-	-	35,400.00
padi kompensimi	të ndryshme	Aktgjykimi SCC-06-0348, NSH Ratko Mitrovicë	122,994.00	e ultë	-	-	122,994.00
padi kompensimi	të ndryshme	Aktgjykimi SCC-10-0091, AKP-ja detyrohet per pagesen e 113.794	113,794.00	e ultë	-	-	113,794.00
padi kompensimi	të ndryshme	Aktgjykimi Cnr.190/2007 NSH Auto Prishtina	35,725.00	e ultë	-	-	35,725.00
padi kompensimi	të ndryshme	Aktgjykimi Cnr.185/2009. për NSh Ujmiri në likuidim	70,000.00	e ultë	-	-	70,000.00
TOTAL			469,140.49		-	15,796.91	453,343.58

SHËNIMET SHPJEGUESE

HYRJE

1.1. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) janë përgatitur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme - Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Këto pasqyra financiare i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga “Rregullorja e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim” aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 23 Shkurt 2011 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare dhe duhet të lexohen së bashku dhe në ndërlidhje me pasqyrat financiare.

1.2. SUBJEKTI RAPORTUES

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 1 Korrik 2008 e ndryshuar me Ligjin nr.04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011 (këtej e tutje “Ligji”) dhe ndryshimet në Ligjin me nr. 080 të datës 24 Dhjetor 2015.

Në pajtim me ligjin mbi themelimin e AKP-së, aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) nëpërmjet të metodave të spin of-it, likuidimit dhe qiradhënies afatgjatë.

Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore.

Agjencia Kosovare e Privatizimit menaxhon Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në Mirëbesim. AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerave të NSH-ve.

Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk kontrollon subjekte tjera të cilat janë/apo mund të jenë konsoliduar në aktivitetet e tyre në këto pasqyra financiare.

Periudha raportuese për pasqyrat financiare është prej 1 Janar deri më 30 Shtator 2016. Në këto pasqyra financiare janë paraqitur edhe raporte që paraqesin të dhënat financiare nga data 1 Korrik 2003 deri më 30 Shtator 2016.

Pasqyrat Financiare janë për Fondet në Mirëbesim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenin 20 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit kontrollohet nga Bordi i Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. AKP i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza vjetore.

1.3. RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË

AKP-ja udhëheq dhe i kontrollon shpenzimet dhe të hyrat e fondeve në mirëbesim përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP-ja bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi i urdhër-transferëve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së.

1.4. VALUTA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në raportin përkatës.

1.5. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë autorizuar për lëshim më datën 31 Tetor 2016 nga: Ekrem Hajdari, Drejtor Menaxhues dhe Adem Selishta, u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

1.6. FORMATI DHE LIDHJA E PASQYRAVE FINANCIARE ME SHËNIMET SHPJEGUSE

Ashtu siç është cekur edhe më lartë, pasqyrat financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) janë përgatitur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme - Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Prandaj, pasqyrat financiare përgatiten sipas parasë së gatshme, llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme dhe llogaritë (detyrimet kontingjente) janë paraqitur si shpalosje në pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim.

Gjatë leximit të pasqyrave financiare, ju mund t'i referoheni edhe shtojcës së pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim. Shtojca e pasqyrave financiare paraqet bilancet përfundimtare më 31 Dhjetor 2015, transaksionet gjatë 2016 dhe bilancet përfundimtare më 30 Shtator 2016. Këto raporte, paraqesin kategorizimet sipas planit kontabël të fondeve në mirëbesim të transaksioneve bankare në llogaritë bankare të cilat administrohen nga AKP-ja për NSh-të përkatëse dhe të tjera.

Shtojca e pasqyrave financiare do t'i dorëzohet vetëm Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Menaxhmentit dhe Departamenteve/Njësive të AKP-së.

TË HYRAT

2. TË HYRAT NGA SHITJA

Të hyrat e realizuara nga shitja përbëjnë bilanci përfundimtare më 30 Shtator 2016 të hyrjeve dhe daljeve në llogaritë bankare të Ndërmarrjeve Shoqërore (fondet në mirëbesim) të cilat administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Pasqyra e gjendjes së Fondeve në Mirëbesim pasqyron gjendjen bankare më 31 Dhjetor 2015, gjendje e transakcioneve Hyrje/Dalse, gjatë periudhës 1 Janar - 30 Shtator 2016 dhe gjendjen përfundimtare bankare më 30 Shtator 2016.

Të hyrat e realizuara nga shitjet përbëjnë:

1. Shitjet e realizuara përmes valëve të privatizimit dhe likuidimit nga AKP-ja;
2. Shitjet e realizuara nga Administrata Tatimore e Kosovës; dhe
3. Shitjet e tjera të realizuara nga NSh-të në tranzicion

2.1. SHITJET E REALIZUARA PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT DHE LIKUIDIMIT NGA AKP

Pagesat e realizuara nga shitjet e aseteve të NSh-ve për të cilat janë nënshkruar kontratat me blerësit. Kemi shitje të aseteve të NSh-ve për të cilat ende nuk janë nënshkruar kontratat deri në lirim të masës së përkohshme nga Gjykata.

Shitjet e realizuara nga AKP-ja janë pagesat e bëra nga blerësit me të cilët janë nënshkruar kontratat dhe blerësit (fitues të përkohshëm) me të cilët ende nuk është nënshkruar kontrata si p.sh. masa e përkohshme nga Gjykata.

Gjatë periudhës raportuese kemi realizuar të hyra në vlerën prej EUR 1,036,338. Llojet e të hyrave janë:

- 2.1.1. Shitja e Ndërmarrjeve të Reja përmes valëve të privatizimit. Ndërmarrjet e Reja janë themeluar nga asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore për të cilat veç e veç janë hapur llogaritë bankare, në të cilat janë realizuar pagesat nga blerësit e këtyre aseteve. Gjatë periudhës raportuese është realizuar pagesa prej EUR 951,000 si rezultat i heqjes së masës së përkohshme nga Gjykata për shitjen e valës 42 në vitin 2010.
- 2.1.2. Të hyrat nga shitja e aseteve të mbetura përmes procesit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur shitje/pagesa të aseteve përmes procesit të likuidimit.
- 2.1.3. Shitjet e aseteve - të së drejtës banesore të Ndërmarrjeve Shoqërore. Shitja e së drejtës banesore bëhet në përputhje me Ligjin nr. 04/L-061. Gjatë kësaj periudhe, gjithsej të hyrat e realizuara janë EUR 85,338.

2.2. SHITJET E REALIZURA NGA ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

Të hyrat nga shitjet për NSh-në, janë rastet kur vlera e shitjes është më e madhe se ajo e barrës tatimore të vendosur nga ana e ATK-së. Organizimi dhe metodologjia e këtyre shitjeve organizohet nga ana e ATK-së.

Administrata Tatimore e Kosovës ka realizuar shitje të aseteve si rezultat i barrës tatimore të vendosur nga ana e saj në asetet përkatëse të NSh-ve dhe ka transferuar në llogaritë e AKP-së vlerën prej EUR 1,686,063.

Gjatë vitit 2016, nuk ka pasur asnjë rast të shitjeve të aseteve nga ana e ATK-së.

2.3. SHITJET E REALIZUARA NGA NDËRMARRJET SHOQËRORE

Nga viti 2008, nuk ka pasur të hyra në llogaritë e Ndërmarrjeve Shoqërore në tranzicion.

3. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË

Janë dhënia me qira e aseteve të NSh-ve në tranzicion dhe NSh-ve në likuidim. Në përgjithësi asetet për këto NSh janë si më poshtë:

- Lokalet;
- Toka bujqësore;
- Pikat e shitjes së derivateve;
- Depot; dhe
- Të tjera

Gjithsej të hyrat e realizuara deri në periudhën raportuese nga dhënia me qira e aseteve është në vlerën prej EUR 18,456,467 nga:

1. Nga llogaritë e NSh-ve në tranzicion në shumën prej EUR 10,428,669; dhe
2. Nga llogaritë e NSh-ve në likuidim në shumën prej EUR 8,027,798.

Gjatë periudhës raportuese të hyrat e realizuara nga dhënia me qira e aseteve është në vlerën prej EUR 3,580,912 nga:

1. Nga llogaritë e NSh-ve në tranzicion në shumën prej EUR 701,466; dhe
2. Nga llogaritë e NSh-ve në likuidim në shumën prej EUR 2,879,446.

4. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË E KOMERCIALIZIMIT

Mban paratë e paguara nga qiratë për kontratat e komercializimit të nënshkruara gjatë vitit 2000 nga UNMIK. Vlera e tërësishme e inkasimeve deri në datën raportuese është EUR 5,021,319.

Gjatë këtij vifi fiskal 2016 nuk kemi pasur inkasime të qirave të Ndërmarrjeve nga komercializimi sepse nuk ka kontrata në fuqi të komercializimit.

5. INTERESI I FITUAR

Të hyrat nga interesi janë:

- interesi i fituar nga llogaritë rrjedhëse në Bankën Qendrore të Kosovës. Nga Korrik 2012, norma e aplikuar e interesit nga BQK është zero%;
- interesi bankar i fituar nga afatizimi për periudhat nga 1 muaj deri në 12 muaj i një pjese të mjeteve nga llogaritë bankare të fondeve në mirëbesim.

Gjithsej interesi i përgjithshëm i fituar nga viti 2003 deri në datën raportuese është EUR 34,844,700 në të gjitha llogaritë bankare të hapura në BQK.

Për vitin fiskal 2016, nuk ka pasur të hyra nga interesi për shkak të normave e interesit nuk janë pozitive.

6. TARIFA PËR PJESËMARRJEN E TENDERËVE TË SHITJES

Në përgjithësi, këto të hyra përfshijnë llogaritë bankare nga të cilat janë gjeneruar të hyra nga tarifat për paraqitjen e tenderëve apo konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve të cilët nuk i kanë përmbushur kushtet e pagesës. Llogaritë janë si më poshtë:

- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të privatizimit;
- Tarifa për dorëzimin e ofertave të privatizimit;
- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të likuidimit; dhe
- Tarifa për dorëzimin e ofertave të likuidimit

Gjatë kësaj periudhe raportuese, nuk ka pasur të hyra në këto llogari bankare.

7. TË HYRAT E TJERA

Janë të hyrat të cilat janë realizuar në llogaritë e NSh-ve në tranzicion, NSh-ve në likuidim, Donatorëve dhe të tjerë në vlerën prej EUR 5,789,984.

Nga viti 2003 këto të hyra trajtojnë inkasimet në llogaritë e sipër shënuara:

- Shitja e mallrave dhe shërbimeve;
- Dividenta dhe shitja e aksioneve;
- Transferimi i mjeteve nga llogaritë bankare të NSh-ve të cilat kanë qenë aktive në bankat komerciale.

Gjatë periudhes raportuese janë realizuar të hyrat prej EUR 666,883 si më poshtë:

- Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim të cilat kanë akvitetet të përditshëm siç janë: Pallati i Rinisë, Grand Hotel dhe ABC Genci etj. Shuma e realizuar është EUR 165,551;
- Nga NSh-të në tranzicion: MIM Golesh në shumën prej EUR 501,332 nga shitjet e realizuar në marrëveshjen me "Bechtel & Enka".

8. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-034, Agjencia ka hapur llogarinë bankare për kapitalin themeltar. Gjithsej vlera e kapitalit themeltar është EUR 10,000,000.00, ndërsa shuma e transferuar nga Qeveria është EUR 1,000,000.00. Pjesa e mbetur mund të kërkohet nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së në kohën dhe në shumën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë.

Gjendja bankare e llogarisë së kapitalit themeltar deri në datën raportuese është EUR 1,013,200.

SHPENZIMET/SHPËRNDARJA

9. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK

Deri në periudhën raportuese shuma e transferuar e 20% në llogarinë e BSPK-së është EUR 108,608,645 në të mirë të punëtorëve të NSh-ve. Të gjitha këto mjete janë transferuar nga llogaritë:

- 9.1. Llogaritë e Privatizimit - Shitjet e Ndërmarrjeve të Reja të themeluara nga asetet e NSh-ve;
- 9.2. Llogaritë e Likuidimit - Shitjet e aseteve dhe aseteve të mbetura përmes procesit të likuidimit;
- 9.3. Llogaritë e Tranzicionit;
- 9.4. Llogaritë në mirëbesim për punëtorët e NSh-ve.

Për periudhën raportuese shuma e totale e transferuar e 20% në llogarinë e BSPK-së është EUR 4,363,491.

10. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Më 11 korrik 2012 është kontraktuar kompania për Ofruesin e Shërbimeve Profesionale mes AKP-së dhe Deloitte Central Europe Limited si pjesë e Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Sipas kontratës bazë janë dy lloje të pagesave: fikse (kuartale) dhe variabile. Pagesat e realizuara nga Tetor 2012 e deri në periudhën raportuese nga kontrata e parë janë paguar në vlerën prej EUR 13,969,701, ndërsa pagesat e realizuar nga aneksi kontrata është në vlerën prej EUR 83,000 si më poshtë:

Përshkrimi	Vlera e kontraktuar	Pagesat e realizuara	Shuma e mbetur nga kontrata	% e shpenzimeve / vlerës së kontraktuar
Kontrata e parë Kostoja fikse 10 Korrik 2012 - 10 Korrik 2016	4,924,740	4,924,740	0	100%
Kontrata e parë Kostoja variabile 10 Korrik 2012 - 10 Korrik 2016	13,003,564	9,044,961	3,958,603	69.56%
10% e vlerës së kontratës	1,992,000	83,000	1,909,000	4.17%
Gjithsej	19,920,304	14,052,701	5,867,603	70.54%

*vlera e kontraktuar në tabelë përfshin edhe TVSh-në prej 16%. Norma e TVSh-së pas periudhës 1 Shtator 2015 është 18%.

Pasi që nuk janë ndarë mjetet nga Buxheti i Kosovës, deri më tani pagesat janë bërë sipas rezolutës së Bordit të Drejtorëve të datës 21 Qershor 2012, financimi i kostove të likuidimit (nenet 40.1.1.1 dhe 40.1.1.3 të Shtojcës së Ligjit të Agjencisë) bëhet si në vijim:

- a) Tarifa fikse e Autoritetit të Likuidimit paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative¹ të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin e caktimit të saktë të kostos fikse

¹ Llogaria e tarifës administrative është llogari e hapur nga ana e AKP-së me qëllim të alokimit të mjeteve të 5% të të hyrave. Shih nenin 21 të Ligjit nr.04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

proporcionalisht për secilën ndërmarrje shoqërore në likuidim, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompenzohet nga llogaria bankare e ndërmarrjes në likuidim;

- b) Tarifa variabile (për kërkesat e shqyrtuara) e Autoritetit të Likuidimit dhe kostot tjera të paraqitura në kostot 1.1 dhe 1.3 të nenit 40.1 të shtojcës së ligjit nr. 04/L-034 paguhet nga fondet e ndërmarrjes në likuidim. Në rast se ende nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit, atëherë tarifa variabile paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompenzohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.

Gjatë periudhës raportuese gjithsej pagesat e realizuara janë (3,258,799 + 83,000) EUR 3,341,799.

10.1. KONTRATA BAZË

Gjithsej vlera e kontraktuar me Ofruesin e Shërbimeve “Deloitte” sipas nr. të kontratës 239/11/068/211 ka qenë në shumën prej EUR 19,920,304. Afati i kontratës ka skaduar më datën **9 Korrik 2016**. Sipas kontratës në fjalë, kanë qenë dy lloje të pagesave:

1. Kosto Fikse në shumën prej EUR 4,912,036 e ndryshuar pastaj me normën e TVSh-së me 18% në 4,924,740 (ndryshimi vetëm prej EUR 12,704). Pagesa realizohet pas aprovimit të raportit nga Komisionin e Bordit për aprovomini e raportëve të kontraktonit; dhe
2. Variabile në shumën prej EUR 14,925,56. Sipas kontratës me Ofruesin e Shërbimeve Profesionale përveç pagesave të kostove fikse, gjithashtu janë edhe pagesat për secilin kërkesë të kreditorit të shqyrtuar (vendim/refuzim). Janë katër llojë kërkesa të kreditorëve të cilët janë kategorizuar. Secili vendim e ka shumën e kontraktuar është në vlerën EUR 299.00 (pronësia e aseteve specifike dhe kërkesat e pronarëve) të tjerat kërkesa të kreditorëve janë përcaktuar në vlerën prej EUR 99.00.

Gjatë periudhës raportuese, kostoja fikse e paguar është në vlerën prej EUR 1,731,916, ndërsa për koston variabile është EUR 1,526,883. Në total janë EUR 3,258,799.

10.2. ANEKS KONTRATA - 10% E VLERËS SË KONTRATËS BAZË

Më datën 8 Gusht 2016 është nënshkruar kontrata e re si aneks i kontratës bazë në vlerën prej 10%. Vlera totale e kontraktuar është EUR 1,992,000. Sipas aneks kontratës, në periudha mujore realizohen pagesat prej EUR 83,000 për 24 periudha. Deri më 30 Shtator 2016 është realizuar vetëm një pagesë prej EUR 83,000.00.

10.3. GARANCION BANKAR

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar një garancion bankar lidhur me performancën e aneks 2 të kontratës nga Deloitte Central Europe Limited për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale për likuidimin e portfolios së NSH-ve (nr. i prokurimit 239-11-068-211). Detajet e garancionit bankar janë si vijon: data e garancionit 21 Shtator 2016, shuma e garancionit € 199,200, emri i bankës që ka lëshuar garancionin: ING Bank N.V. PO BOx 350, 1000 Amsterdam, The Netherlands.

11. MALLRA DHE SHËRBIME

Nga viti 2003 deri më 30 Shtator 2016 gjithsej pagesat e realizura për mallra dhe shërbime janë në vlerën prej EUR 11,320,750.

Në përgjithësi në këtë kategori përfshihen pagesat e bëra si më poshtë:

- Pagesat ndaj Ofruesve të Shërbimeve për NSh në Likuidim;
- Qiraja;
- Shpenzime për reklamim;
- Shërbime profesionale;
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e aseteve;
- Pagat e punëtorëve - NSh në tranzicion; dhe
- Të tjera.

Këto pagesa janë realizuar nga llogaritë e NSh-ve në tranzicion, likuidim dhe tarifa administrative e Agjencisë.

Për vitin fiskal 2016 janë bërë pagesat në vlerë prej EUR 1,523,876 dhe atë:

- 11.1. Pagesat nga NSh në tranzicion - shuma prej EUR 229,631. Pagesat nga NSh Pallati i Rinisë Kulturës dhe Sporeteve pagat e punëtorëve, sindikatës, shërbime dhe të tjera;
- 11.2. Pagesat/shpërndarja nga llogaritë bankare të likuidimit në shumën prej EUR 1,013,792 për Ofruesit e Shërbimeve, mirëmbajtja dhe ruajtja e aseteve, shërbime postare dhe të tjera.
- 11.3. Pagesat nga llogaria e tarifës administrative prej EUR 280,452. Këto pagesa kanë të bëjnë me çështjet e likuidimit dhe raste të tjera të veçanta për NSh-të në tranzicion. Në momentin e realizimit të të hyrave në NSh-të të cilat kanë mungesë të likuiditetit bankar, llogaria e tarifës do të kompenzohen. Nga shuma e sipër shënuar, janë tërhequr mjetet prej EUR 23,500.00 për dhënien e parasë së imët si më poshtë:

Përshkrimi	Avanset	Qëllimi i pagesës
Zyra Regjionale Gjiilan	5,000	Taksa komunale, dërgesa postare dhe pagesa të tjera të vogla
Zyra Regjionale Mitrovicë	2,000	Taksa komunale, dërgesa postare dhe pagesa të tjera të vogla
Zyra Regjionale Pejë	7,000	Taksa komunale, dërgesa postare dhe pagesa të tjera të vogla
Zyra Regjionale Prishtinë	4,000	Taksa komunale, dërgesa postare dhe pagesa të tjera të vogla
Zyra Regjionale Prizren	5,000	Taksa komunale, dërgesa postare dhe pagesa të tjera të vogla
MIM Golesh	500	Shpenzime të imëta për NSh-në në tranzicion MIM Golesh

Pagesat e realizuara nga paraja e imët nga Zyret Regjionale regjistrohen në një regjistër për secilën Ndërmarrje Shoqërore për të cilën është realizuar pagesa. Pastaj, mjetet alokohen në llogarinë e tarifës administrative nga ato NSh për të cilat është bërë shpenzimi dhe që kanë mjete. Para e imët tërhiqet nga llogaria e tarifës dhe jo nga secila llogari e likuidimit për arsye të kursimeve nga shpenzimet administrative që praktikon BQK si tarifë për një tërheqje EUR 50.00. Mbyllja e këtyre avanseve bëhet në fund të vitit fiskal.

12. SHËRBIMET PUBLIKE

Pagesat e realizuara për shërbimet publike (rrymë, ujë, telefoni) kanë të bëjnë me Ndërmarrjet Shoqërore në tranzicion dhe në Likuidim.

Shuma e paguar gjatë vitit 2016 për shërbimet publike është EUR 212,546 të cilat janë si më poshtë:

- 12.1. Nga llogaritë e ndërmarrjeve në likuidim, gjithsej shuma e paguar EUR 209,878;
- 12.2. Nga llogaritë e ndërmarrjeve në tranzicion, gjithsej shuma e paguar EUR 2,668.

13. TATIMET

Pagesat e tatimeve bëhen për NSh-të në tranzicion dhe në likuidim për të hyrat e inkasuara nga qiraja (TVSh dhe tatimi nga fitimi në qira) dhe mbajtja në burim e tatimeve dhe kontributeve për pagesat e OSh-ve.

Gjatë periudhës raportuese, pagesat e realizuara në Administratën Tatimore të Kosovës janë EUR 595,079:

- 13.1. Nga ndërmarrjet në likuidim, gjithsej shuma e paguar EUR 382,535;
- 13.2. Nga ndërmarrjet në tranzicion, gjithsej shuma e paguar EUR 212,544.

14. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE (DEPOZITA DHE TAKSA)

Gjatë periudhës raportuese 2016 janë realizuar pagesat në vlerën prej EUR 19,043 të cilat kanë të bëjnë me rastet e mëposhtme:

- taksave gjyqësore; dhe
- për angazhimin e përmbaruesve për inkasimin e obligimeve të papaguara nga palët e treta për shfrytëzimin e aseteve të disa NSh-ve.

15. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-së

Agjencia Kosovare e Privatizimit që nga vitit 2011 e deri më datën raportuese ka transferuar gjithsej shumën prej EUR 32,148,000 në llogarinë bankare të thesarit për financimin e aktiviteteve administrative dhe operative të AKP-së:

1. Gjatë vitit 2011 ka transferuar shumën prej EUR 1,800,000;
2. Me datën 28 Maj 2012, të transferuara shumën prej EUR 8,200,000.00 për vitin fiskal 2012;
3. Me datën 28 Dhjetor 2012, të transferuara shumën prej EUR 8,048,000.00 për vitin fiskal 2013;
4. Me datën 18 Nëntor 2014, të transferuara shumën shtesë prej EUR 2,300,000.00 për vitin fiskal 2014;
5. Me datën 15 Janar 2015, të transferuara shumën shtesë prej EUR 5,500,000.00 për vitin fiskal 2015; dhe
6. Me datën 15 Janar 2016, të transferuara shumën shtesë prej EUR 6,300,000.00 për vitin fiskal 2016.

16. SHPENZIME TË TJERA

Gjithsej shuma e paguar gjatë vitit 2016 është EUR 11,271. Këto shpenzime përfshijnë avanset për udhëtime zyrtare të Zyrtarëve Ligor dhe Zyrtarëve të Rastit për NSh-të në likuidim (përfaqësime gjyqësore jashtë territorit të Kosovës) dhe pagesat e tarifave për transaksionet dalse nga llogarit bankare të fonde në mirëbesim që i aplikonë BQK.

16.1. PARAJA E IMËT NGA LLOGARITË E LIKUIDIMIT

AKP-ja mban paranë e imët për pagesa të imëta dhe rastet për udhëtime zyrtare jashtë vendit (përfaqësimet në Gjykata) për NSh-të përkatëse. Gjatë periudhës raportuese avans i pambyllur është vetëm për NSh “Pallat i Rinisë dhe Kulturës si më poshtë:

Përshkrimi	Avanset	Nga llogaria	Qëllimi i pagesës
Pallati i Rinisë, Kulutrës	5,000	Llogaria e Pallatit	Për shpenzime të vogla për aktivitetin e NSh-së në likuidim

17. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve NË LIKUIDIM

Janë pagesa të cilat realizohen sipas shtojcës së ligjit të AKP-së nr. 04\L-034. Pagesat ndaj kreditorëve, janë pretendimet e vlefshme të kërkesave të kreditorëve të aprovuara nga Autoriteti i Likuidimit për NSh-të përkatëse. Pastaj, me vendim të Bordit të Drejtorëve realizohet shpërndarja e mjeteve ndaj kreditorëve në fjalë.

Për periudhën raportuese lidhur me pasqyrat kreditorë që janë filluar të procedohen nga muaji Maj 2016 shtë marrë vendim nga Bordi i Drejtorëve për 102 Ndërmarrje Shoqërore në likuidim për shpërndarjen e mjeteve si më poshtë:

Përshkrimi	Shuma e aprovuar nga BD	Pagesat e realizuara	Papaguar
Për paga të punëtorëve të papaguara	5,499,551	4,884,119	615,432
Administratës tatimore të Kosovës	3,544,199	3,177,553	366,646
Trusti pensional i Kosoves	1,539,403	1,478,894	60,509
Komunave - tatimi në pronë	762,320	664,942	97,378
Kreditor të tjerë	3,257,177	3,067,288	189,889
Gjithsej	14,602,650	13,272,796	1,329,854

- Nga shuma prej EUR 13,272,796 (është përfshirë edhe tarifa bankare për transaksion në vlerën prej EUR 1,718 - si ndryshim i vlerës të pasqyrës financiare)

Në shumat e papaguara, kryesisht kanë të bëjnë vendimet e datës 21 Shtatorit 2016, për të cilat është filluar të paguhet në fillim të muajit Tetor 2016. Shuma totale e këtyre totale për shpërndarje e 21 Shtatorit 2016 është EUR 1,098,409. Ndërsa, pjesa tjetër e papaguar është si rezultat i mungesës të informacioneve të sakta të llogarive bankare për ekzekutim të pagesave.

18. FONDET TEPRICË TRANSFERUAR QEVERISË SË KOSOVËS

Në përputhje me nenin 19.3.3 i Ligjit të AKP-së, deri më 31 Dhjetor 2015 shuma e transferuar si fonde tepricë është EUR 90,244,911.

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur transferim të mjeteve tepricë në Llogarinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme janë obligimet e papaguara nga palët e treta ndaj Agjencisë, të cilat paraqiten vetëm si shpalosje. Llojet e të hyrave për Agjencinë janë si më poshtë:

- ndëshkimet financiare për valët e “spin off-ve special”;
- pjesët e papaguara nga valët e privatizimit apo likuidimit; dhe
- qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSh-ve.

Të gjitha këto të dhëna janë të paraqitura nga Njësia për Kontroll dhe Mbikqyrje, Zyrat Regjionale përmes Departamentit të Koordinimit të Rajonal dhe Departamenti i Shitjes.

Gjendja e llogarive të arkëtueshme është EUR 49,657,433 për të gjitha rastet e sipër shënuara.

19. NDËSHKIMET NDAJ NSh-ve ME SPIN-OFF SPECIAL

Ndëshkimet në vlerë monetare për zotimet e dhëna ndaj blersve për disa Ndërmarrjet e Reja si më poshtë, që përveç çmimit të ofertës, ofertuesit kanë dorëzuar dhe ofertat lidhur me investimet për këto Ndërmarrje.

Për shkak të mospërbushjes së zotimeve deri me tani janë aplikuar ndëshkimet financiare për blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet.

Shuma totale e ndëshkimeve për 6 Nsh-ve		
Ndërmarrje Re	Ndëshkimet Janar - Shtator 2016	Prej datës së fillimit deri më 30 Shtator 2016
Ndërmarrja e Re “Grand Hotel”	0.00	8,822,314.97
Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco”	0.00	4,573,649.11
Ndërmarrja e Re “Xim Strezovc”	0.00	7,298,170.76
Ndërmarrja e Re “MIM Golesh”	0.00	8,447,812.27
Ndërmarrja e Re “Agrokosova Holding”	0.00	3,579,997.53
Ndërmarrja e Re “Llamkos”	0.00	1,715,488.79
Totali	0.00	34,437,433.43

Për periudhën Janar - Shtator 2016, nuk ka janë aplikuar ndëshkimet. Vlerat janë të bartura nga periudhat paraqake.

20. SHITJA E ASETEVE PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT

Bilanci i llogarive të arkëtueshme më 1 janar 2016 ka qenë EUR 1,592,134. Gjatë periudhës raportuese është realizuar një pagesë në vlerë prej EUR 951,000 si rezultat i heqjes së përkohshme nga Gjykata për shitjen e bërë në vitin 2010 realizuar në valën 42.

Shuma e mbetur për të realizuar në vlerën prej EUR 641,134 në llogaritë e arkëtueshme janë shitjet e aprovuara nga Bordi i AKP-së, mirëpo këto 4 asete të shitura kanë masë të përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kemi pasur tender për shitje të aseteve përmes valëve të privatizimit dhe likuidimit.

21. QIRAJA APO TË HYRAT TË TJERA

Marrë parasysh natyrën e punës së Agjencisë, faktorët që ndikojnë në llogarit e arkëtueshme janë si më poshtë:

1. Zgjerimi i aktivitetit të Agjencisë rreth administrimit të aseteve të NSh-ve;
 - 1.1. Në krahasim me vitet paraprake, kemi një rritje të madhe të qiramarrëve që kanë pranuar të nënshtrohen nënshkrimit të kontratave për shfrytëzimin e aseteve të NSh-ve. Faktori tjetër i rritjes së llogarive të arkëtueshme dhe inkasimit të lartë të të hyrave nga qiraja ka reflektuar nga periudha e Nëntor të vitit 2014 pas marrjes së vendimit nga menaxhmenti për lirim të pronave nga uzurpatorët;
2. Faturimi ndaj Kosova Petrol për shfrytëzimin e aseteve të NSh-ve "INA TRGOVINA" dhe "JUGOPETROL" për periudhën nga Shkurti i vitit 2000 deri më 30 Prill 2016. Obligimi është EUR 8,708,329. Fatura e parë për obligimet është lëshuar gjatë vitit 2014. Për shfrytëzimin e këtyre aseteve për periudhën e sipër shënuar është ngritur padi ndaj Kosova Petrol në organet përkatëse.

Gjithsej llogaritë e arkëtueshme për qiratë janë EUR 14,578,866. Në përgjithësi, për këto obligime është bërë iniciimi për padi gjyqësore.

Gjithashtu, kemi pranuar të hyra prej EUR 915,063.4 nga shfrytëzimi i objektit nga UNMIK-u për të cilën në periudhat paraprake nuk është paraqitur si llogari e arkëtueshme. Kjo për shkak se nuk kemi pasur njohuri për vlerën e saktë të qirasë.

Vlera e qirasë është përcaktuar nga UNMIK-u, pa ndonjë komunikim zyrtar me AKP-në, por sipas informatave që ka marrë Zyra Regjionale e Mitrovicës, standardi i përcaktuar për vlerën e qirasë nga UNMIK është marrë nga vitet 2005 dhe 2006. Përmes insistimit të Agjencisë mjetet për shfrytëzimin e qiras janë kërkuar nga ish-Menaxhmenti i NSh-së Jugobankes të UNMIK-u, pasi AKP-në si institucion ende kjo organizat nuk e njehë.

LLOGARITË E PAGUESHME

Janë të paraqitura obligimet e papaguara në katër shtylla:

1. Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit);
2. Mallrat dhe Shërbimet;
3. Obligimet ndaj Kërkesave të Kreditorëve; dhe
4. Shërbimet komunale

Të gjitha këto të dhëna janë të paraqitura nga Departamenti për Koordinim të Likuidimit dhe Zyrat Regjionale përmes Departamentit të Koordinim të Rajonal.

Raporti është i shpalosur në tabela në këtë format:

- Në kolonën 1 janë të paraqitura obligimet e papaguara deri më 31 Dhjetor 2015;
- Në kolonën 2 janë të paraqitura rezultatet e rritjeve/zvogëlimeve të balanceve deri në periudhën raportuese në krahasim me fund vitin 2015;
- Në kolonën 3 janë bilancet përfundimtare më 30 Shtator 2016.

Obligimet e papaguara deri më 30 Shtator 2016 janë EUR 1,541,650.

22. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Obligimet në vlerën prej EUR 40,096 ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale i cili është kontraktuar si pjesë e Autoritetit të Likuidimit është për 2 faturat e kostos variabile të kontratës bazë.

Gjatë periudhës së përgatitjes së pasqyrave financiare është realizuar pagesa e dy faturave në vlerën prej EUR 39,139.09. Ndërsa vlera mbetur e papaguar në EUR 956.91, do të bëhet posa të kompletohet raporti me dëshmit e kërkuara.

23. MALLRA DHE SHËRBIME

Shuma prej EUR 156,282 janë për ofruesit e shërbimeve të cilët angazhohen për NSh-të përkatëse, shërbimet për ruajtjen e aseteve, shpalljet në gazeta për shitjen e aseteve përmes likuidimit, shpalljet lidhur me njoftimet për kërkesat e kreditorëve.

24. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSh-ve

Ashtu siç është përmendur edhe në shënimin shpjegues nr. 17 “Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-ve”, obligimet e papagura janë pagesat e perealizuara ndaj kreditorëve të NSh-ve sipas vendimit për shpërndarje të Bordit të Drejtorëve.

Nga shuma e papaguar prej EUR 1,329,854 janë si rezultat:

- Gjithsej shuma prej EUR 1,098,409 nga aprovimi nga Bordi i Drejtorëve për shpërndarje të datës 21 Shtator 2016. Për këto, është filluar procesimi i pagesave gjatë muajit Tetor 2016;
- Gjithsej shuma e papaguar prej EUR 231,446 ndaj gjithsej 188 kreditorëve të NSh-ve. Këto janë shumat të cilat kanë mbetur pa u paguar si rezultat i mungesës të informacioneve të sakta të llogarive bankare. AKP-ja ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të vënë në kontakt kreditorët në fjalë (edhe përmes reklamave në TV). AKP-ja së fundi ka vënë në përdorim edhe aplikacionin në uebfaqen e saj zyrtare në mënyrë që kreditorët të informohen me të dhënat e fundit rreth procesit të shpërndarjes.

25. DETYRIMET KONTIGJENTE

Këto detyrime janë për një numër të Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat nuk janë vendosur në likuidim ende të cilat kanë konteste gjyqësore.

Detyrimet kontingjente janë të shpalosura këtë format: Kolona 1 paraqet totalin e shumave të periudhave 2015 dhe 2016 dhe totalin e të gjitha vlerave të bartura të bilanceve deri më 31 Dhjetor 2014.

Detajet në lidhje me detyrimet kontingjente janë në Tabelën 5 te pasqyrat financiare.

TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE

26. TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Janë transaksione bankare ndërmjet llogarive bankare të fondeve në mirëbesim në BQK. Siç edhe i kemi paraqitur më lartë. Shkurtimisht, këto ndodhin për arsye të mëposhtme:

1. Shpërndarja e 75% nga llogaritë e privatizimit për në llogaritë bankare të likuidimit;
2. Transferimi i gjendjes bankare të NSh-ve në tranzicion për në llogaritë bankare të likuidimit;
3. Transferimi i 5% nga shitjet e aseteve në privatizimit, likuidimit apo cfarëdo shitje tjetër dhe interesi;
4. Konfiskimin e depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likuidimit (regjistruar me shënimin nr. 5 - shih tabelat);
5. Bartjen e BID depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likuidimit për në llogaritë përkatëse të NSh-ve (privatizim apo likuidim). Këto raste janë të paraqitura në shënimin 3;
6. Transferimin e shumave të pa shpërndara si pjesë e 20% për në llogarinë në mirëbesim për punëtorët e NSh-ve. (Shih tabelën 5 në shtojcën e pasqyrave financiare);
7. Transferi nga llogaritë e privatizimit dhe likuidimit në llogaritë e punëtorëve;
8. Pagesa e mjeteve nga Tarifa Administrative për llogaritë e likuidimit dhe pastaj kompenzimi i llogarisë së tarifës nga llogaritë e likuidimit;
9. Tjera.

27. LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE

AKP-ja mban para edhe në llogari tjera (banka komerciale në Procredit) për situatat e mëposhtme:

1. Mbajtja e kapitalit themeltar për Ndërmarrjet e Reja të themeluara nga asetet e NSh-ve (shih shënimin 2.1.1 të shënimeve shpjeguese). Janë tri llogari bankare;
2. Garancioni bankar për MIM Golesh në shumën prej EUR 64,466.50 për licensën sipas rregullorës të Komisionit për Miniera dhe Minerale të Kosovës.

Gjithsej gjendja bankare në periudhën raportuese e këtyre llogarive është në vlerën prej EUR 69,512.

- FUND -



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT

Janar – Shtator 2016

RAPORT NËNTË MUJOR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

31 TETOR 2016

TABELA E PËRMBAJTJES

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
TË ARRITURAT KRYESORE	5
SHITJA E ASETVE.....	5
LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE	6
PAGESAT PËR PUNËTORËT E NDËRMARRJEVE SHOQËRORE (20%).....	7
TRAJTIMI I ASETVE TË UZURPUARA	7
FINANCAT DHE BUXHETI.....	9
SFIDAT KRYESORE NË PERIUdhËN E ARDHSHME	10
SFIDAT KRYESORE NË PËRMBYLLJEN E LIKUIDIMIT TË NSH-VE	11
RREGULLORET DHE PROCEDURAT E APROVUARA GJATË VITIT 2016 NGA AGJENCIA	12
2. KORNIZA LIGJORE	14
LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM NË KUADËR TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	14
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	16
3.1. MISIONI DHE VIZIONI	16
3.2. KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT	16
4.FUSHËVEPRIMI QË E MBULON AGJENCIA	17
BORDI I DREJTORËVE	18
ORGANIZIMIDHE VEPRIMTARIA.....	19
RËNDËSIA, NDËRLIDHJA DHE SFIDAT KRYESORE PËR REALIZIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR VITIN 2016	20
5. AKTIVITETET PËR PERIUdhËN RAPORTUESE	21
5.1. DEPARTAMENTI I SHITJES	21
SHITJET QË KANË NDALESA NGA DHOMA E VEÇANTË E GJYKATËS SUPREME.....	21
SHITJET E PAPËRFUNDUARA ENDE:	22
5.2. NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE ME INVESTITOR	22
5.3. NJËSIA PËR KONTROLLË DHE MBIKËQYRJE	24
5.4. NJËSIA E ADMINISTRIMIT DIREKT	31
5.5. DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUDIMIT	35

NJËSIA PËR MENAXHIMIN E PROJEKTIT TË LIKUIDIMIT	35
NJËSIA PËR LIKUIDIMIN E NSH-VE NGA AKP-JA	38
NJËSIA PËR LISTAT E PUNËTORËVE PËR 20%	39
5.6. NJËSIA E RIORGANIZIMIT DHE ADMINISTRIMI I NSH-VE	39
5.7. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL	41
TRAJTIMI I ASETVE TË UZURPUARA	41
5.8. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT	42
5.9. DEPARTAMENTI LIGJOR	45
5.10. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	47
NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE	47
NJËSITË TJERA TË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS	48
5.11. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT	51
5.12. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM	52
5.13. NJËSIA PËR MEDIA DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN	54
5.14. KOMISIONET	55
KOMISIONI I BANESAVE PËR NSH-TË - SHITJA	55
KOMISIONI PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE JOLIGJORE NË PRONAT E NSH-VE	56
KOMISIONI PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE - KPS	56
7. RAPORTI PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	57
SHTOJCA 1. LISTA E NDËRMARRJEVE NËN ADMINISTRIM DIREKT SIPAS NENIT 6.1	64
SHTOJCA 2. LISTA E TRANSAKSIONEVE SIPAS NENIT 8 DHE NENIT 9	64
SHTOJCA 3. LISTA E NDËRMARRJEVE NË PROCES TË RIORGANIZIMIT	64
SHTOJCA 4. LISTA E NDËRMARRJEVE TË LIKUIDUARA SIPAS NENIT 9	65
SHTOJCA 5. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	66
8. LISTA E RAPORTEVE FINANCIARE VJETORE	67
PASQYRAT FINANCIARE TË BUXHETIT TË AGJENCISË (FAQE 1 DERI 17)	67
PASQYRAT FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM (FAQE 1 DERI 24)	67

PËR VËMENDJEN E MINISTRIË SË FINANCAVE

Raporti nëntëmujor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit i plotëson kërkesat ligjore për raportim sipas nenit 20.1 të ligjit të AKP-së.

Pas përfundimit të vitit fiskal, raporti vjetor i Agjencisë pas miratimit nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së, dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform nenit 20.1 të ligjit të AKP-së.

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë kapitull është paraqitur një përmbledhje e shkurtër për periudhën Janar-Shtator 2016 lidhur me këto fusha:

- Të arriturat kryesore;
- Shitja e aseteve;
- Likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) dhe pagesat për kreditorët e NSH-ve;
- Pagesat për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (20%);
- Administrimi dhe monitorimi i NSH-ve;
- Trajtimi i aseteve të uzurpuara;
- Përmbledhje lidhur me financat.

TË ARRITURAT KRYESORE

- Përkushtimi i personelit të Agjencisë në tejkalimin e sfidave të paraqitura;
- Pagesat për kreditorët e Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Shpërndarja e 20 % për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Rritja e efikasitetit në administrimin, kontrollimin dhe monitorimin e NSH-ve, Spin-Offet special dhe privatizimeve me kushte;
- Trajtimi i aseteve të uzurpuara apo të shfrytëzuara pa bazë ligjore nga palët e treta;
- Rritja e inkasimit të qirasë;
- Bashkëpunimi me Komunitetin;
- Shqyrtimi i kërkesave të kreditorëve.

SHITJA E ASETEVE

Për periudhën raportuese AKP nuk ka realizuar asnjë shitje të aseteve për shkak se gjatë kësaj periudhe është punuar në ndryshimin e akteve nënligjore që rregullojnë procesin e shitjes. Shitjet e reja të aseteve janë planifikuar për muajin Dhjetor 2016. Është nënshkruar një kontratë e shitjes (nga tenderët e viteve të mëparshme) pasi që është hequr masa e përkohshme nga Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme.

Rezultatet tabelare të numrit të shitjeve (kontratave të nënshkruara) dhe totali i shitjeve nga Qershor 2002 – Shtator 2016:

	Tërë procesi Qershor 2002 – Shtator 2016	Gjithsej të ardhurat nga shitjet
Shitja e ndërmarrjeve të reja	766	573,938,929
Shitja e aseteve të NSH-ve në likuidim	528	87,235,540
Gjithsej numri i kontratave	1,294	661,174,469

Një përmbledhje lidhur me numrin e shitjeve të Ndërmarrjeve të Reja dhe asetëve në likuidim është paraqitur në dy tabelat e mëposhtme.

Numri i NSh-ve nën administrim të AKP-së	554	1	
Numri i NSh-ve në likuidim për të cilat ka pasur shitje (ndërmarrje e re apo shitje në likuidim)	316	2	
Numri i NSh-ve të cilat nuk janë në likuidim, por që ka pasur shitje të Ndërmarrjeve të Reja	13	3	
Numri i NSh-ve nga të cilat ka pasur shitje të pronave	329	4=2+3	68%
Numri i NSh-ve të cilat nuk kanë asete	43	5	
Numri i NSh-ve nga të cilat NUK ka pasur shitje të pronave	185	6=1-4-5	32%

Numri i NSh-ve në likuidim	463
Numri i NSh-ve të cilat nuk kanë asete e që janë vendosur në likuidim*	36
Numri i NSh-ve të cilat janë në likuidim, por që s'ka pasur asnjë shitje	111

LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Numri total i NSh-ve për të cilat ka filluar procesi i likuidimit është 463. Gjatë periudhës raportuese janë dorëzuar 244 kërkesa të reja kreditore për PRN067 Pallatin e Rinisë, përderisa janë shqyrtuar dhe dërguar 237 vendime tek pretenduesit. Autoritetet e Likuidimit të NSh-ve në Likuidim kanë përgatitur raportet përfundimtare dhe raportet për shpërndarje për 103 Ndërmarrje Shoqërore të cilat janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjet e mbajtura nga mars deri në shtator 2016. Shpërndarja e mjeteve për kreditorët e ligjshëm është duke u ekzekutuar.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë nën procesin e likuidimit, Bordi i Drejtorëve ka aprovuar Raportet Përfundimtare për 5 NSh, Raporte të shpërndarjes përfundimtare për 18 dhe Raporte të shpërndarjes së përkohshme për 80 NSh në likuidim. Procedurat e likuidimit janë në vazhdim e sipër për 452 NSh (11 NSh janë të mbyllura).

Rezultatet tabelare të likuidimit:

	1 janar - 30 shtator 2016	Tërë procesi
Numri i NSh-ve në likuidim	1	463
Numri i kërkesave të parashtruara nga kreditorët	244	89,896
Numri i kërkesave të shqyrtuara	237	89,505
Numri i NSh-ve të mbyllura sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) (NSH-të pa asete apo pa kërkesa kreditore)	4	11

Numri i raporteve përfundimtare dorëzuar nga AL ¹ te Dhoma e Posaçme për mbyllje të NSh-së (në pritje të vendimit)	1	1
Numri i raporteve përfundimtare	3	4
Numri i raporteve të shpërndarjes përfundimtare	0	19
Numri i raporteve të shpërndarjes së përkohshme	81	81

PAGESAT PËR PUNËTORËT E NDËRMARRJEVE SHOQËRORE (20%)

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia nuk ka publikuar lista të punëtorëve. Shpërndarja e pjesshme të 20 % për punëtorët e kualifikuar për 78 Ndërmarrje Shoqërore dhe shpërndarjen nga shitjet e mëpastajshme të aseteve.

Rezultatet tabelare të 20%-it:

	1 Janar – 30 Shtator 2016	Tërë procesi
Shuma e shpërndarjeve të 20%-it për punëtorët e NSh-ve	4,363,487	108,651,199
Lista finale të punëtorëve	0	312
Vendime të formës së prerë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës	21	148
Listat në pritje për shqyrtim nga gjykata		121
Numri i punëtorëve për të cilët janë bërë pagesat	7,987	43,868
Shuma e fondeve të gatshme për shpërndarje punëtorëve posa të shqyrtohen ankesat nga Gjykata Supreme		22,093,495

TRAJTIMI I ASETEVE TË UZURPUARA

Si rezultat i aktiviteve të shtuara dhe veprimeve të ndërmarra për lirim të aseteve të uzurpuara dhe aktiviteve të shtuara në kontekst të administrimit të Aseteve. Lirimi i aseteve përbën një prej lajmeve më dobiprurëse në të mirë të investitorëve dhe në përmirësimin e pasqyrimit të Kosovës ndaj investitorëve të huaj.

Numri i aseteve të uzurpuara aktualisht si dhe numëri i aseteve që shfrytëzohen nga Institucionet Vendore dhe Ndërkombëtare janë:

¹ AL - Autoriteti i Likuidimit

Rajoni	uzurpator	rast social	institucion vendor	institucion nderkombetar	ndërmarrje publike	shprehje e interesit per qira	kontest pronesor	Gjithsej
Prishtina	9	1	9	1	0	12	6	38
Peja	18	0	0	0	0	8	0	26
Prizren	0	0	21	0	2	25	9	57
Gjilan	0	1	17	2	5	7	0	32
Mitrovica	42	3	37	1	0	49	1	133
Gjithsej	69	5	84	4	7	101	16	286

Nga numëri prej 217 persona të klasifikuar në listën e uzurpatorëve në fund të vitit 2015, në fund të periudhës raportuese ky numër është 69 raste ku kryesisht janë toka bujqësore dhe asetet në komunat në veri të vendit.

Sa i perket rasteve ku kanë shprehur interesim për të hyrë në marrëdhënje kontraktuale për shkak të ndryshimeve në rregullore dhe pritjen e amandamentimit të kësaj rregullore nuk kanë mundur të procesohen për themelime të komisioneve për vlerësim të çmimit të qirave dhe pas amandamentimit të rregullores pritet themelimet e komisioneve për rastet nën kategorinë e shprehjes së interesit për qira.

Planifikohet që adresimi i aseteve të uzurpuara të bëhet në vazhdim gjatë vitit 2016.

Lirimi i aseteve përbën një prej lajmeve më dobiprurëse në të mirë të investitorëve dhe në përmirësimin e paqyrimin të Kosovës ndaj investitorëve të huaj.

Të dhënat në lidhje me numrin e lirimit të aseteve të NSH-ve nga uzurpatorët dhe numrin e kontratave të nënshkruara, pas marrjes së vendimit për lirimin e aseteve nga uzurpatorët dhe aprovimin e Udhëzuesit më 10 Dhjetor 2014 e deri në fund të periudhës raportuese është si në vijim:

Pershkrimi	Gjilani	Mitrovica	Prishtina	Prizreni	Peja	Gjithsej
Liruar nga Uzurpatorët	7	19	78	28	40	172
Hyrja në marrëdhënie kontraktuale me ish-shfrytëzuesit që e kanë pranuar autoritetin administrativ të AKP-së	14	48	91	15	66	234

Si rrjedhojë e veprimeve të marra nga Agjencia për lirimin e aseteve të uzurpuara si dhe rritjes së efikasitetit në administrimin e aseteve paraqiten rritje të theksuara të inkasimit të qirasë në periudhën 2016 në krahasim me periudhën 2015:

Lloji i llogarive bankare	Inkasimet Janar – Shtator 2016	Inkasimet Janar – Shtator 2015	Inkasimet Janar – Shtator 2014	Rritja e qirasë 2016/2015	Rritja me % 2016/2015
Likuidim	2,011,402	1,289,093	749,337	722,309	56.03%
Para të NSH-ve në mirëbesim	699,591	1,090,573	275,098	(390,982)	(55.89)%
GJITHSEJ	2,710,993	2,379,666	1,024,435	331,327	13.9%

* Të hyrat e qirasë në këtë tabelë nuk përfshijnë inkasimin e qirave të NSh-ve në likuidim si Tregu, ABC Genci, Grand Hotel dhe Pallati i Rinisë Kulturës dhe Sporteve.

Ndërsa nëse llogarisim periudhën para dhe pas marrjes së vendimit për lirim e aseteve:

	A	B	C=A+B	E=B/C
Lloji i llogarive bankare	Para marrjes së vendimit 1 Janar 2003 deri 20 Nëntor 2014	Pas marrjes së vendimit 21 Nëntor 2014 deri 30 Shtator 2016	Gjithsej	Pjesëmarrja e shumës totale të inkasuar
Likuidim	2,070,803	3,973,670	6,044,473	65.74%
Para të NSH-ve në mirëbesim	6,865,586	2,193,745	9,059,331	24.22%
GJITHSEJ	8,936,389	6,167,415	15,103,804	40.83%

Prej vitit 2002 e deri më 21 Nëntor 2014 janë inkasuar 8.9 milion euro, prej tyre 4.5 milion janë inkasuar përmes marrëveshjeve me institucionet ndërkombëtare për pagesa të borxheve ndaj NSH-ve, ndërsa 4.4 milion janë inkasuar me qiradhënësit tjerë.

Ndërsa, prej marrjes së vendimit për lirim e aseteve nga uzurpatorët më 21 Nëntor 2014, pra vetëm gjatë periudhës dyvjeçare (Nëntor 2014 – Shtator 2016) janë inkasuar 6.1 milion euro nga qiradhënia e aseteve apo 38% më shumë (rritja nga 4.4 në 6.1 milion) se sa inkasimi i qirasë (4.4 milion) që është realizuar në 12 vitet e mëparshme.

Sa i përket vendimit për lirim e pronave nga uzurpatorët ka rezultuar në performancë të shkëlqyer në administrimin e aseteve.

FINANCAT DHE BUXHETI

Pasqyrat Financiare të buxhetit vjetor

Pasqyrat financiare për periudhën janar - shtator 2016 janë dorëzuar brenda afatit ligjor në Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave. Burim kryesor i financimit për buxhetin e Agjencisë janë të Hyrat e Dedikuara që mbulon aktivitetet direkte administrative dhe operative të saj sipas nenit 21 të ligjit të AKP-së.

Përmbledhja e rezultateve financiare nga buxheti vjetor i të hyrave të dedikuara dhe Granti Qeveritar:

PËRSHKRIMI	JANAR – SHTATOR 2016
Buxheti deri më 31 Dhjetor 2016	8,965,168
Alokimet deri më 30 Shtator 2016	7,109,889
Shpenzimet: (51 % të buxhetit apo 65% të alokimeve)	4,616,287
Numri i transaksioneve	2,553

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim

Pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim për periudhën janar – shtator 2016 janë dorëzuar brenda afateve ligjore në Ministrinë e Financave. Buxheti prej EUR 18.1 milion euro për Fondet në mirëbesim është për ndërmarrjet shoqërore të cilat hyjnë në likuidim për shpenzimet e likuidimit si dhe 20 milion euro për Autoritetin e Likuidimit. Buxheti përfshinë periudhën që nga hyrja e Ndërmarrjes në likuidim e deri në përfundim të saj.

Përmbledhja e rezultateve financiare të fondeve në mirëbesim:***Hyrjet kryesore gjatë tërë procesit nga viti 2003 – Shtator 2016***

Të hyrat nga shitjet e aseteve (ndërmarrjet e reja dhe shitja e aseteve në likuidim, shitja e banesave dhe shitjet tjera nga NSh në tranzicion)	665,974,267
Të hyrat nga komercializimi	5,021,319
Të hyrat nga qiraja	18,456,467
Fondet tjera në mirëbesim të nsh-ve (para likuidimit) dhe tarifat për pjesëmarrjen e tenderëve	13,302,448
Të hyrat nga interesi në bankë (prej të cilave nga depozitimet kohore janë gjeneruar 7,2 milion)	34,844,700

Numri i transaksioneve hyrëse	189,366
Numri i transaksioneve dalëse	100,439
Gjithsej	289,805

Të dhënat janë edhe në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

SFIDAT KRYESORE NË PERIUdhËN E ARDHSHE

Arritja e synimeve dhe objektivave të AKP-së në të ardhmen mund të ngadalësohet marrë parasysh sfidat e mëposhtme që janë identifikuar:

- Menaxhimi i procesit të riorganizimit të Agjencisë;
- Përsheptimi i procesit të shitjes dhe trajtimit të aseteve në mënyra tjera;
- Trepça;

- Pagesa e mjeteve të shpronësimit² nga Qeveria e Republikës së Kosovës për shpronësimet e vendosura në pronat shoqërore. Për asnjë NSH nuk mund të mbyllet procesi i likuidimit pa u paguar fondet e shpronësimit, prej të cilave poashtu pritët të paguhet 20%-i për punëtorët e NSH-ve;
- Vendosja e ndërmarrjeve të mbetura në likuidim;
- Të siguruarit që asnjë kontratë e shitjes në të ardhmen të mos përfundohet/dorëzohet pa u liruar asetit nga uzurpatorët;
- Bashkëpunimi me Komunitat në ofrimin e shërbimeve kadastrale në mënyrë ekspeditive;
- Mungesa e stafit deficitar sic janë Zyrtarët Kadastral;
- Trajtimi i shitjeve kur dokumentet janë të paqarta apo mungojnë dokumentet e pronësisë;
- Vonesat në trajtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës;
- Vonesat në trajtimin e lëndëve nga Gjykatat Themelore;
- Trajtimi i ndërtimeve joligjore; dhe
- Trajtimi i aseteve jashtë Kosovës.
- Vetëdijësimi i komunave rreth kompetencave të tyre në raport me pronën shoqërore, pasi që në shume raste Komunitat kanë bërë ndërrime në mënyrë të njëanshme prej titullarit të pronave shoqërore – prona të cilat janë nën mandatin e AKP-së;
- Mungesa e bashkëpunimit me disa komuna në pjesën veriore të Kosovës. Kjo drejtpërdrejtë ndikon në procesin e privatizimit dhe likuidimit pasi që aty ekziston një numër i konsiderueshëm i pronave të NSH-ve.

Disa prej sfidave të mësipërme varen direkt prej institucioneve tjera.

SFIDAT KRYESORE NË PËRMBYLLJEN E LIKUIDIMIT TË NSH-VE

Procesi i privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) duhet të vazhdojë pa vonesa³ të mëtejme.

Sfidat kryesore për përmbylljen e procesit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore janë:

1. Agjencia ende nuk i ka shitur **1,685** asete të NSH-ve⁴; dhe
2. Deri më 31 dhjetor 2015 janë rreth **29,373 raste gjyqësore** në instancat e ndryshme gjyqësore:
 - 2.1. Rreth 15,000 ankesa⁵ të kreditorëve të NSH-ve që ende janë në shqyrtim e sipër në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (DHPGJS);

² Që prej themelimit të AKP-së në vitin 2008, Qeveria ende nuk e ka paguar asnjë shpronësim për pronat shoqërore. Deri më 10 Shtator 2015 gjithsej janë marrë 555 vendime për shpronësime të pronave shoqërore. Gjatë vitit 2016 parashihet që Agjencia të dërgoj letrat formale me kërkesë për pagesë të këtyre shpronësimeve.

³ Preambula e ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në ka paraparë themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe delegimin në këtë Agjenci të autorizimeve të gjëra publike administrative mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

⁴ Sipas Raportit Përmbledhës të Aktiviteteve të AKP-së janë nënshkruar 1,294 kontrata të shitjes së Ndërmarrjeve të Reja dhe të shitjes së aseteve të NSH-ve në likuidim nga Qershor 2002 (themelimi i ish-AKM-së) e deri në fund të periudhës raportuese.

⁵ Deri më 31 dhjetor 2015 në Autoritetet e Likuidimit (AL) të NSH-ve janë dërguar nga DHPGJS rreth 1,650 Urdhëra për Përgjigje në ankesat e kreditorëve për vendimet e lëshuara nga AL-të. Në bazë të disa parashikimeve të mostrave të ankesave dhe numrit të NSH-ve, mund të jenë edhe rreth 13,350 ankesa tjera për të cilat AKP ende nuk është njoftuar nga DHPGJS, në total pra rreth 15,000 ankesa të kreditorëve të NSH-ve. Sipas komunikatës për shtyp të DHPGJS në Dhjetor 2015, janë 23,327 lëndë gjyqësore të mbetura që kanë të bëjnë me proceset e Agjencisë, ku vetëm brenda vitit 2015 janë pranuar 4,117 lëndë të reja, ndërsa janë zgjidhur gjatë vitit 1,797 lëndë në të dy Shkallët në DHPGJS. Pra, sipas informatave nga DHPGJS numri i lëndëve gjyqësore në shqyrtim është 21,530.

- 2.2. Rreth 6922 ankesa me 10,122 ankues në listat e punëtorëve të NSH-ve që ende janë në shqyrtim e sipër (për 185 NSH deri në fund të periudhës raportuese) në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (DHPGJS). Këto raste mbrohen nga Departamenti Ligjor i AKP-së;
- 2.3. Janë 2,564 raste gjyqësore që procedohen nga zyret rajonale të Agjencisë në Gjykatat Themelore;
- 2.4. Janë 180 raste të inicuar për përmbarime nga zyret rajonale të Agjencisë në Gjykatat Themelore;
- 2.5. Rreth 4,705 raste gjyqësore që procedohen nga Departamenti Ligjor i Agjencisë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme;
- 2.6. Janë 2 raste në Gjykatën Kushtetuese.

3. Agjencia i ka trajtuar një numër tejet të kufizuar të ndërtimeve joligjore në pronat e NSH-ve.

Për këtë arsye është e rëndësishë kritike që:

- I. Çështjet të cilat janë nën kontrollin e Agjencisë, siç janë likuidimi/shitja dhe trajtimi i aseteve, të kryhet me prioritet të lartë ashtu që raportet e Autoriteteve të Likuidimit t'i paraqiten Bordit të Drejtorëve me kohë;
- II. Institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të përgatisin strategjinë përkatëse në përsheptimin e shqyrtimit të lëndëve gjyqësore nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe të lëndëve në Gjykatat Themelore; dhe
- III. Në koordinim me Qeverinë dhe organet komunale të përgatitet një strategji e veçantë për trajtimin e ndërtimeve joligjore jashtë proceseve administrative të Agjencisë.

Është e qartë se pa u likuiduar asetet dhe pa u shqyrtuar të gjitha ankesat kreditore në DHPGJ përfshirë ankesat në kërkesat pronësore lidhur me asetet e NSH-ve në likuidim, nuk mund të likuidohen Ndërmarrjet Shoqërore.

Megjithatë, Autoriteti i Likuidimit / Agjencia ka filluar të bëjë shpërndarjen e përkohshme të pagesave ndaj kreditorëve me aprovim të Bordit të Drejtorëve (parakusht për këtë është që të dihet numri i ankesave dhe vlera e ankesave të paraqitura në DHPGJ). Informata për shpërndarjet e përkohshme për kreditorët deri më tani janë dhënë në tabelat përkatëse të likuidimit në këtë raport.

RREGULLORET DHE PROCEDURAT E APROVUARA GJATË VITIT 2016 NGA AGJENCIA

Rregulloret dhe procedurat e aprovuara gjatë periudhës raportuese janë:

1. Amadamentimi i Rregullores mbi procedurat e rekrutimit, nominimit dhe emërimit të Menaxhmentit dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve të AKP-së – miratuar me 28 Janar/02 Shkurt 2016;
2. Statuti e Komitetit të Auditimit – miratuar me 31 Mars/07 Prill 2016;
3. Amadamentim i Politikave Operacionale të Agjencisë - Amadamentohen nenet 7.12 dhe 7.14.1 të Politikave Operacionale të Agjencisë – miratuar me 31 Mars/07 Prill 2016;
4. Rregullorja e punës së Njesisë së Administrimit Direkt – miratuar me 31 Mars/07 Prill 2016;
5. Amadamentimi i Rregullores së kompensimit të Bordit – miratuar me 31 Mars/07 Prill 2016;
6. Rregullorja e re e Qiradhënies së aseteve të NSH-ve – miratuar me 28 Prill 2016;
7. Udhëzuesi për Lirimin e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit e Paligjshëm – miratuar me 28 Prill 2016;
8. Rregullore për monitorim të Trepçës – 21 Korrik 2016;

9. Amadamentim -Rregullore per Qiradhenie te Ndermarrjeve Shoqerore – 26 Gusht 2016;
10. Shfuqizimi i Aneksit III të Udhëzuesit të Likuidimit - Trajtimi i Kërkesave Kolektive të Kreditorëve - 21 Shtator 2016;
11. Plotesim/Ndryshimi 3 i Politikave Operacionale (nenet 6.4 dhe 7.9) – 21 Shtator 2016;
12. Procedurat e Shitjes dhe Rregullat e Pergjithshme te Tenderit – 21 Shtator 2016.

2. KORNIZA LIGJORE

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 1 Korrik 2008 i ndryshuar me ligjin nr.04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011 (këtej e tutje “Ligji”) i ndryshuar me ligjin nr. 05/L-080 që ka hyrë në fuqi më 24 Dhjetor 2015.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar si pasardhës e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) të themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit” me ndryshime nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18 dhe parasheh që të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit për Ndërmarrjet Shoqërore transferohen tek Agjencia Kosovare e Privatizimit.

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM NË KUADËR TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

1. Ligji i AKP-së;
2. Akti themelues i AKP-së;
3. Statuti i Bordit të Drejtorëve të AKP-së;
4. Politikat Operacionale të AKP-së dhe Aneksat e saj:
 - 4.1. Procedurat e shitjes dhe Rregullat e Përgjithshme të tenderit të AKP-së.
 - 4.2. Rregullat e Procedurës të Komisionit për shqyrtim të ankesave ndaj listave të punëtorëve.
5. Procedurat Financiare të AKP-së;
6. Udhëzuesi i Likuidimit me Aneksat e tij:
 - 6.1. Lista me Format/Formularët për Likuidim;
 - 6.2. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave të Faktuara të Punës (marrëdhënia e punës)
 - 6.3. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore (të NSH-së) gjatë periudhës së transformimit.
7. Rregullore për kompensimin e anëtarëve të Bordit
8. Udhëzuesi për Procedurën e shpërndarjes së 20%-in për punëtorët e NSH-ve nga të hyrat e shitjes;
9. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore;
10. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim;
11. Procedurat e brendshme të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;
12. Procedurat Bankare të AKP-së;
13. Rregullorja Nr. 01/2012 mbi Ruajtjen e Integritetit të AKP-së;
14. Rregullorja për përdorimin të vulave zyrtare të Agjencisë dhe Autorizimit për lejimin e përdorimit të vulave zyrtare të Agjencisë nga Autoriteti i Likuidimit;
15. Statuti Njësies së Auditimit të Brendshëm (NJAB);
16. Rregullore për përcaktimin e mënyrave të kompensimit për menaxherët si dhe punëtorët tjerë të NSH-ve nën mandatin e Njësies së Administrimit Direkt;

17. Rregullore për procedurën e rekrutimit të Drejtorit Menaxhues, dy Zëvendës Drejtorëve Menaxhues dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;
18. Rregullore për Zhvillimin e punonjësve dhe ngritje te kapaciteteve;
19. Rregullore për procedurat dhe masat e nevojshme për sigurinë e personave që hyjnë dhe dalin në AKP;
20. Rregullore e brendshme të Agjencisë për Vlerësim të Performancës së Menaxhmentit;
21. Politikat mbi pagesën e pjesshme për punëtorët e NSH-ve;
22. Udhëzuesi i prokurimit për ndërmarrjen Trepça nën Administrimin e AKP-së;
23. Rregullore e Shitjes e Ndërmarrjes Trepça në Administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
24. Procedurat bankare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
25. Rregullorja e Pagave për nëpunësit e Agjencisë;
26. Rregullorja e Personelit për nëpunësit e Agjencisë;
27. Rregullorja e Përdorimin e Veturave zyrtare të Agjencisë;
28. Rregullat e Procedurës për Shitjen e Banesave të NSH-ve;
29. Rregullat e Punës të Komisionit për ndërtimeve jo ligjore në pronat e ndërmarrjeve shoqërore;
32. Rregullat e Procedurës së Komisionit për shqyrtimin e listave fillestare të punëtorëve (KShLFP);
33. Vendimi për lirim të aseteve të uzurpuara të NSH-ve dhe Udhëzuesi për lirim të aseteve nga uzurpatorët;
34. Rregullore për Procedurat e Njesisë së Kontrollit dhe mbimqyrjes gjatë Monitorimit të Ndërmarrjeve të Privatizuara me Spin Off Special dhe me Kushte;
35. Rregullore mbi Procedurat e trajtimit të llogarive të arkëtueshme;
36. Udhëzuesi për Menaxhimin e Performancës së Personelit;
37. Udhëzuesi për Teknologjinë Informative;
38. Rregullorja e Qiradhënies së Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1. MISIONI DHE VIZIONI

Misioni

Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Për realizimin e këtij misioni, Agjencia mban dhe administron secilën ndërmarrje (nën mandatin e saj) në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, si dhe shet ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin.

Vizioni

Agjencia është e vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet substanciale negative ekonomike dhe sociale si dhe nxitjen e investimeve në Ndërmarrjet Shoqërore, përmes autorizimeve të gjëra publike administrative që i ka Agjencia Kosovare e Privatizimit mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

3.2. KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT

Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej “Agjencia”) është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues⁶, Zëvendës Drejtori Menaxhues-Shitje dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues-likuidimi.

Agjencia ka departamentet në vijim:

- Departamenti i Shitjes;
- Departamenti për Koordinim të Likuidimit;
- Departamenti i Koordinimit Rajonal;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit;
- Departamenti i Administratës; dhe
- Departamentin e Prokurimit.

Agjencia e ka të themeluar edhe Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe Sekretarinë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve. Agjencia ka zyrën qendrore në Prishtinë. Ka pesë (5) zyra rajonale (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan) dhe një (1) zyre satelitore (Shtërpce).

Struktura organizative e Agjencisë është paraqitur në fund të raportit vjetor të Agjencisë.

⁶ Drejtori Menaxhues, Zëvendës Drejtori Menaxhues-shitje dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues-likuidimi janë emëruar me mandat tre vjeçar duke filluar më 1 Qershor 2016.

4.FUSHËVEPRIMI QË E MBULON AGJENCIA

Rreth 642 subjekte juridike në Kosovë kanë qenë të identifikuar nga si Ndërmarrje Shoqërore (NSH) që e kanë selinë në Kosovë apo njësi punuese (në Kosovë) të NSH-ve që selinë e kanë pasur në ish-republikat e federatës jugosllave.

NSH-të kanë funksionuar në sektorë të ndryshëm duke përfshirë përpunimin e metalit, plastikës, letrës, hotele, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, material ndërtimor, ndërtimtari, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me shumicë dhe pakicë.

NSH-të zënë rreth 90% të industrisë dhe minierave në Kosovës, 50% të hapësirës për shitje komerciale me pakicë dhe më pak se 20% të tokës bujqësore duke përfshirë tërë tokën komerciale bujqësore dhe shumicën e pjesës malore të Kosovës.

Shumica e pronës industriale e Kosovës, toka bujqësore, pyje, tokë urbane komerciale dhe pronë komerciale janë pronë e NSH-së. Privatizimi i këtyre aseteve dhe tërheqja e investitorëve të huaj si dhe atyre nga diaspora, rajoni dhe Kosova pritet që të kenë ndikim pozitiv në ekonominë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Nga rreth 642 ndërmarrje, 32 ndërmarrje janë larguar nga administrimi i Agjencisë me vendime të Bordit apo me anë ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, janë 24 ndërmarrjet e Ekonomive Pyjore që nuk do të vendosen në likuidim, janë 12 Kosovatrantsa që janë shëndrruar në ndërmarrje publike si Stacion i Autobusëve, ndërsa sa i përket Trepçës ende pritet se a do të hyj në fuqi ligji i Trepçës pasi rasti është duke u trajtuar në Gjykatën Kushtetuese:

1.	Trepça	20
2.	Ekonomitë Pyjore	24
3.	Kosovatrantsat	12
4.	NSH që janë hequr me vendime të Bordit	32

Pra, numri i NSH-ve nën mandatin e Agjencisë është gjithsej 554 prej të cilave në procesin e likuidimit kanë hyrë gjithsej 463. Janë edhe 91 NSH apo asete të NSH-ve të cilat pritet të vendosen në likuidim deri në fund të vitit 2016 apo një pjesë të vogël të tyre edhe në fillim të vitit 2017 (varësisht aprovimit të statusit të tyre se a janë ende nën administrimin e AKP-së).

AKP-ja vazhdon me privatizimin e NSH-ve nëpërmjet dy metodave:

1. **“Spin-Off”** - Asetet dhe numri i kufizuar i përgjegjësive të NSH-së barten tek shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (“Ndërmarrja e Re sh.p.k.”) me aksionet e ndërmarrjeve të reja të tenderuara për shitje investitorëve privat. Detyrimet e mbetura ndaj kreditorëve dhe punëtorëve mbasin me Ndërmarrjen Shoqërore; dhe
2. **Likuidimi Vullnetar** - Asetet e NSH-ve do të likuidohen/shiten sipas ligjit dhe politikave operacionale të Agjencisë.

BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve të AKP-së takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas ligjit. Që nga data 17 Dhjetor 2015, Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në vitin 2008 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje.

Në vitin 2009 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) mbledhje.

Në vitin 2010 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur dymbëdhjetë (12) mbledhje.

Në vitin 2011 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) mbledhje.

Në vitin 2012 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur tetë (8) mbledhje.

Në vitin 2013 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) mbledhje.

Në vitin 2014 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur nëntë (9) mbledhje.

Në vitin 2015 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur një (1) mbledhje.

Në vitin 2016 Bordi i Drejtorëve deri në muajin shtator ka mbajtur 12 mbledhje.

Mbledhjet e Bordit gjatë vitit 2016 (Deri në muajin shtator 2016):

Takimi i shtatëdhjetë e një (71) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 28 janar dhe 2 shkurt 2016. Gjatë këtij takimi Bordi ka zgjedhur Zëvendës Kryesuesin e tij, ka aprovuar buxhetin për vitin fiskal 2016 si dhe planin e vjetor të Agjencisë për vitin 2014. Bordi nga radhët e veta ka themeluar dy komisione, për aprovimin e raporteve të kontraktorit Autoritetit të Likuidimit për likuidimin e Ndërmarrjeve Shoqërore, respektivisht të Komitetit të Auditimit, si dhe ka aprovuar një raport nga Komisioni për përcaktimin e statusit të ndërmarrjeve shoqërore (SDR). Në këtë takim është themeluar edhe komisioni për shqyrtimin preliminar të kërkesave ndaj NSH Trepça si dhe komisioni për draftimin e Termave të Referencës për Studimin e fizibilitetit të NSH Trepça. Bordi ka aprovuar Rregulloren e re për rekrutimin e Menaxhmentit të Agjencisë dhe në bazë të kësaj Rregulloreje edhe ka aprovuar termat e referencës dhe ka iniciuar procesin e shpalljes për pozitën e Drejtorit Menaxhues të Agjencisë.

Takimi i shtatëdhjetë e dytë (72) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 25 shkurt 2016 në të cilin Bordi ka aprovuar Termat e Referencës dhe ka iniciuar procesin e rekrutimit për Zëvendës Drejtor Menaxhues – Shitje dhe Zëvendës Drejtor Menaxhues – Likuidim, pas hapjes së kësaj pozite. Bordi ka aprovuar një raport të Komisionit për SDR, si dhe ka vendosur nën administrim direkt NSH Pallati i Rinisë.

Takimi i shtatëdhjetë e tretë (73) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 31 mars dhe 7 prill 2016 në të cilin Bordi ka aprovuar Termat e Referencës për studimin e fizibilitetit të NSH Trepça dhe ka autorizuar Menaxhmentin për shpalljen publike të këtij tenderi. Sa i përket Trepçës, Bordi ka aprovuar planin prodhues dhe të prokurimit për këtë ndërmarrje për vitin 2016, si dhe ka aprovuar Raportin Vjetor të Agjencisë për vitin 2015. Në këtë mbledhje Bordi ka aprovuar disa akte të brendshme nënligjore si Statuti i Komitetit të Auditimit, Rregullat e brendshme të Administrimit Direkt, etj., si dhe ka aprovuar raportin e radhës të Komisionit për SDR.

Takimi i shtatëdhjetë e katër (74) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 28 prill 2016 në të cilin takim Bordi ka futur NSH Pallati i Rinisë në likuidim, ka aprovuar raportin e Komisionit për shitjen e banesave dhe atë të Komisionit për SDR. Në takim Bordi po ashtu ka aprovuar Rregulloren e re për Qiradhënien e NSH-ve dhe Udhëzuesin për uzurpime, dhe po ashtu ka marrë vendim për disa qiradhënie të

rekomanduara nga Menaxhmenti. Po ashtu janë aprovuar shpërndarjet e përkohshme për kreditorët e 24 NSH-ve në likuidim.

Takimi i shtatëdhjetë e pestë (75) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 19 maj 2016 në të cilin është diskutuar dhe vendosur vetëm për një pikë të rendit të ditës, rekrutimin e Menaxhmentit të AKP-së. Bordi ka emëruar Drejtorin Menaxhues, Zëvendës Drejtorin Menaxhues Shitje dhe Zëvendës Drejtorin Menaxhues Likuidim për një mandat tre vjeçar duke filluar nga data 1 qershor 2016.

Takimi i shtatëdhjetë e gjashtë (76) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 26 maj 2016 ku është vendosur për dhënien me qira të disa aseteve të NSH-ve, është aprovuar raporti i Komisionit për SDR, si dhe ai i Komisionit të Banesave. Në këtë takim, Bordi ka vendosur për transferimin e NSH Stacioni i Autobusave Malishevë në kompetencë të Komunës, si dhe janë aprovuar shpërndarjet e përkohshme për kreditorët e 12 NSH-ve në likuidim.

Takimi i shtatëdhjetë e shtatë (77) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 17 qershor 2016 ku janë aprovuar shpërndarjet e përkohshme për kreditorët e 14 NSH-ve në likuidim. Në këtë takim është aprovuar raporti i Komisionit të Banesave, si dhe është vendosur për qiradhënie të aseteve të NSH-ve.

Takimi i shtatëdhjetë e tetë (78) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 12 dhe 21 korrik 2016 në të cilin Bordi ka aprovuar shitjen e mbetjeve industriale në Trepçë, ku edhe ka aprovuar edhe Rregulloren për monitorim të Trepçës. Bordi ka aprovuar planin e punës të Agjencisë për pjesën e dytë të vitit 2016 si dhe ka aprovuar buxhetin e Agjencisë për vitin 2017. Janë aprovuar shpërndarjet e përkohshme për kreditorët e 11 NSH-ve në likuidim, është aprovuar raporti i Komisionit të Banesave, si dhe është vendosur për qiradhënie të aseteve të NSH-ve. Bordi ka marrë vendim për shpronësimin e një pjese të pronës së NSH INA dhe Auto Moto sipas vendimit të Qeverisë për interes publik si dhe ka liruar NSH Llotaria e Kosovës nga kompetencat e Agjencisë.

Takimi i shtatëdhjetë e nëntë (79) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 26 gusht 2016, në të cilin Bordi ka amandamentuar Rregulloren e qiradhënies, si dhe ka aprovuar kërkesën e Ferronikelit për shfrytëzimin e parcelës së NSH MIM Golesh.

Takimi i tetëdhjetë (80) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 31 gusht 2016 në të cilin takim Bordi ka aprovuar kërkesën e Komunës së Rahovecit për qiramarrje sezonale të një aseti të NSH-së si dhe ka aprovuar kërkesën e Federatës së Futbollit të Kosovës për marrjen me qira të asetit të NSH Auto Prishtina.

Takimi i tetëdhjetë e një (81) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 21 shtator 2016, në të cilin Bordi ka amandamentuar dhe aprovuar rregullativën e shitjes, ka aprovuar shpërndarjet e përkohshme për kreditorët e 9 NSH-ve në likuidim, është aprovuar raporti i Komisionit të Banesave, si dhe është vendosur për qiradhënie të aseteve të NSH-ve. Po ashtu në takim është liruar nga kushtet e marrëveshjes së zotimit Ndërmarrja e Re Onix Banja e Pejës.

ORGANIZIMIDHE VEPRIMTARIA

Lidhur me këtë nënkapitull, raportimi është bërë siç vijon:

- a) organizimi – struktura organizative e Agjencisë është në shtojcën e raportit vjetor;
- b) veprimtaria e Agjencisë dhe njësisë organizative përkatëse – paraqitet në kapitullin “Aktivitetet për periudhën raportuese”

Selia qendrore e Agjencisë është në rrugën “Agim Ramadani” nr. 23 (ish-“Ilir Konushevci” nr. 8) në Prishtinë. Agjencia ka mungesë të jashtëzakonshme të hapësirës përkatëse për punë për shkak të objektivit të stërvjetruar.

Agjencia ka pranuar kërkesë nga Komuna e Prishtinës për lirim të objektit për arsye të planeve zhvillimore të cilat janë planifikuar nga Komuna. Për këtë është njoftuar Ministria e Administratës Publike me të cilën Agjencia është në diskutime e sipër për zhvendosjen e zyreve të Agjencisë në ndonjë tjetër objekt përkatës.

RËNDËSIA, NDËRLIDHJA DHE SFIDAT KRYESORE PËR REALIZIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR VITIN 2016

Çështjet e ngritura në objektivat e vitit 2016 janë përcaktuar që të jenë në përputhje me interesin e përgjithshëm të Kosovës për të përfunduar procesin e privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) pa vonesa⁷ të mëtejme.

Pengesat kryesore për përmbylljen e procesit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore janë:

1. Agjencia ende nuk i ka shitur rreth 1,721 asete të NSH-ve; dhe
2. Deri më 31 dhjetor 2015 janë rreth 29,373 raste gjyqësore në instancat e ndryshme gjyqësore;
3. Agjencia i ka trajtuar një numër tejet të kufizuar të ndërtimeve jologjore në pronat e NSH-ve.

Për këtë arsye është e rëndësishme kritike që:

1. Çështjet të cilat janë nën kontrollin e Agjencisë, siç janë likuidimi/shitja dhe trajtimi i aseteve, të kryhet me prioritet të lartë ashtu që raportet e Autoriteteve të Likuidimit (raportet e shpërndarjes dhe raportet finale) t'i paraqiten Bordit të Drejtorëve me kohë;
2. Institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të përgatisin strategjinë përkatëse në përsheptimin e shqyrtimit të lëndëve gjyqësore nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe të lëndëve në Gjykatat Themelore; dhe
3. Në koordinim me Qeverinë dhe organet komunale të përgatitet një strategji e vecantë për trajtimin e ndërtimeve jologjore jashtë proceseve administrative të Agjencisë.

Është e qartë se pa u likuiduar (shitur dhe trajtuar në mënyra tjera) asetet dhe pa u shqyrtuar të gjitha ankesat kreditore në DHPSGJ përfshirë ankesat në kërkesat pronësore lidhur me asetet e NSH-ve në likuidim, nuk mund të likuidohen Ndërmarrjet Shoqërore.

Megjithatë, Autoriteti i Likuidimit / Agjencia mund të bëjë shpërndarjen e përkohshme të pagesave ndaj kreditorëve me aprovim të Bordit të Drejtorëve (parakusht për këtë është që të dihet numri i ankesave dhe vlera e ankesave të paraqitura në DHPSGJ).

⁷ Preambula e ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në ka paraparë themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe delegimin në këtë Agjenci të autorizimeve të gjëra publike administrative mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

5.1. DEPARTAMENTI I SHITJES

Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) është paraparë të ketë ndikim pozitiv në komunat e Kosovës nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë duke mundësuar rritjen dhe zhvillimin e sektorit privat. E rëndësishme është që ky proces të kryhet sa më shpejtë në mënyrë të drejtë dhe transparente dhe në përputhje me ligjin.

Departamenti i Shitjes përbëhet nga:

1. Njësia për Përgatitjen dhe Përmbylljen e Shitjes;
2. Njësia e Shqyrtimit të Dokumenteve të Shitjes; dhe
3. Njësia e Kadastrit.

Departamenti i Shitjes është përgjegjës për procesin e privatizimit dhe atë sipas menyrave të cekura më poshtë:

“Spin-Of” - Asetet dhe një numër i kufizuar i detyrimeve të NSH-së barten tek shoqëritë e porsaformuara aksionare (Ndërmarrja e Re) me aksionet e Ndërmarrjes së Re dhe më pas tenderohen për shitje investitorëve privat. Detyrimet ndaj kreditorëve potencial mbasin obligime të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe këto çështje zgjidhen përmes procesit të likuidimit. Pasiqë shumica e Ndërmarrjeve Shoqërore tashmë kanë hyrë në procesin e likuidimit, nuk pritët që të ketë shitje me Spin Of të rregullt.

“Likuidimi Vullnetar” do të mundësoj:

- a) shitjen e aseteve që nuk janë shitur nëpërmjet privatizimit; dhe
- b) shqyrtimin e ankesave të kreditorëve dhe shpërndarjen e fondeve të realizuara në përputhje me prioritetet e parapara me ligj.

Sa i përket pjesës raportuese për këtë periudhë, nuk është mbajtur asnjë valë e privatizimit apo shitjeve të aseteve përmes Likuidimit. Kjo ka ndodh si rrjedhim i moskompletimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe poashtu menaxhmentit të AKP-së, pasi që asnjë shitje nuk mund të mbahet pa miratim paraprak të Bordit, gjithnjë sipas politikave operacionale dhe ligjeve në fuqi.

SHITJET QË KANË NDALESA NGA DHOMA E VEÇANTË E GJYKATËS SUPREME

Për nëntë (9) shitje të organizuara kemi ndalesa nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe derisa nuk hiqen këto ndalesa nuk mund të vazhdohet me shitjen. Ndaletat vlejné për ndërmarrjet/asetet në vijim:

1. Ndërmarrja e Re “AGROKOSOVA – Zyret Sh.P.K.” – Vala 37;
2. Ndërmarrja e Re “Punëtorja Iliria Sh.P.K.” – Vala 43.
3. Ndërmarrja e Re “Jugobanka Zyra në Skenderaj” – Vala 58;
4. Aseti në likuidim “Farmakos Blue Factory” Prizren;
5. Njësia nr. 11: Jugobanka Zyra në Zubin Potok – SHAL 23;
6. Njësia nr. 12: Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme i - SHAL 20;
7. Njësia nr. 12: Jugobanka Zyra në Zveçan – SHAL 23;

8. Njësia nr. 13: Jugobanka Ndërtesa Administrative në Mitrovicë – SHAL 23;
9. Njësia nr. 14: Jugobanka Banesa në Mitrovicë – SHAL 23.

Nga 740 raste të dorëzuara në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për masa të përkohshme ndaj veprimeve të AKP-së, përgjatë periudhës së procesit të privatizimit dhe likuidimit nga qershor 2002 e deri më 31 dhjetor 2015 janë këto të dhëna:

- 93 masa të përkohshme janë ende në fuqi;
- 195 kërkesa për masë të përkohshme janë ende në shqyrtim e sipër nga Gjykata; dhe
- 452 kërkesa janë refuzuar nga Gjykata.

SHITJET E PAPËRFUNDUARA ENDE:

1. Njësia nr. 25: Tokë dhe Objekt në Qendër Mitrovicë (parcela 1451-1) – SHAL 24;
2. Njësia nr. 12: Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme I, Fushë Kosovë SHAL 20;
3. Jugobanka Zyra në Skenderaj Sh.p.k., Vala 58;
4. Punetoria "Iliria" Sh.p.k, Pejë, Vala 43;
5. Kooperimi Toka Bujqësore Treboviq Sh.p.k., Pejë, Vala 42;
6. Ndërmarrja e Re "KB Shtime Ndërtesa Administrative Sh.P.K. Shtime - Vala 42;;
7. AGROKOSOVA OFFICES Sh.p.k., Prishtinë, Vala 37'
8. Farmakos Blue Factory L.L.C. Prizren, Vala 2.

5.2. NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE ME INVESTITOR

Plani i punës së Njesisë së Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor ka paraparë që shtylla kryesore e angazhimit do të jetë në sigurimin e përkrahjes së plotë për të gjitha shitjet e realizuara nga AKP- ja si dhe promovimin dhe ruajtjen e raporteve të mira me investitorët. Në aspektin e realizimit të shpalljes së shitjeve janë planifikuar plane multi-mediale marketingu, përfshirë përdorimin e mjeteve të duhura mediale, në përputhje me strategjinë për marketing masiv. Megjithatë, marrë parasysh që gjatë periudhës janar-shtator 2016 nuk është bërë asnjë shpallje e shitjeve të aseteve për arsye tashmë të ditura, si pasojë plani operacional në këtë aspekt nuk ka arritur të përmbushet.

Me qëllim të ngritjes së vizibilitetit dhe shpërndarjes së informatës tek publiku i gjerë apo palët e interesit si dhe promovimin e procesit të privatizimit tek investitorët potencial lokal dhe ndërkombëtar, Njësia e Marketingut ka përfaqësuar AKP-në në ngjarje dhe aktivitete relevante si dhe ka hulumtuar dhe identifikuar mundësitë e reja alternative për promovimin e punës së Agjencisë.

Aktivitete marketingu dhe aktivitete promovuese

Si vazhdimësi e projektit të iniciuar në fund të vitit 2015, janë ndërmarrë aktivitete në drejtim të identifikimit të një numri të konsiderueshëm të ndërmarrjeve që janë funksionalizuar dhe kanë ndikim pozitiv në aspektin e punësimit, investimeve dhe prodhimit, në periudhën e post-privatizimit. Qëllimi i projektit ka qenë që të promovohet procesi i privatizimit dhe pasqyrimi i efekteve pozitive që ka pasur ky proces në ekonominë e

Kosovës, me fokus të veçantë në performancën e kompanive të privatizuara dhe efektet në ekonominë lokale. Në këtë drejtim, është vazhduar me realizimin e vizitave dhe plotësimin e pyetësorëve për identifikimin e ndërmarrjeve potencialisht të suksesshme. Ngecjet kryesore që janë hasur gjatë këtij aktiviteti kanë të bëjnë me problemet rreth kontakteve me privatizuesit, marr parasysh periodat e gjata kohore që nga privatizimi.

Aktivite promovuese

Në mbështetje të strategjisë për promovimin dhe tërheqjen e investorëve Njësia e Marketingut ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme marketingu:

- a) Realizimi i materialeve të shtypura promovuese - përfshirë konceptimin, dizajnin dhe mbikëqyrjen e shtypit.
- b) Konceptimi i fushatës promovuese për promovimin e aplikacionit për statusin e kërkesave të kreditorëve në procesin e likuidimit, përfshirë përgatitjen e media-planit për mbulimin e fushatës, dizajnin dhe realizimin e reklamës televizive dhe banerit për portale.
- c) Marrë parasysh vendimin e Agjencisë për rritjen e prezencës në rrjetet sociale, në shërbim të ngritjes së transparencës dhe afimit me të gjitha palët e interesit, është siguruar përkrahja teknike dhe përpunimi i materialeve relevante për postim
- d) Pjesëmarrja në konferencën ndërkombëtare për investor, pjesë e “HardhFest” të mbajtur në Rahovec;
- e) Përgatitjet dhe pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar “Prishtina 2016”, i cili është mbajtur me 28 shtator-01 tetor 2016, organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe MBPZhR, ku janë prezantuar mundësitë investive dhe të arriturat e deritanishme të Agjencisë.

Marrëdhënie me Investitorë

Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitorë vazhdon të mbetet pika primare e komunikimit me investorët potencial vendor dhe ndërkombëtar, duke u përgjigjur kërkesave dhe ofruar udhëzime dhe këshillime rreth procesit të privatizimit dhe pjesëmarrjes në tenderët e shpallur, përfshirë parakualifikimin, koordinimin e hulumtimit paraprak dhe sigurimin e materialeve tenderuese (Rregullat e Tenderit, Memorandume Informimi etj).

Ueb Faqja

Në shërbim të ngritjes së transparencës dhe nivelit të informimit të drejtë dhe në kohë reale për të gjitha palët e interesit, ueb faqja e AKP-së popullohet me të gjitha informatat publike në lidhje me procesin e privatizimit. Kjo përfshin lansimin e Valëve të Privatizimit dhe Shitjes së Aseteve, listat preliminare dhe finale të punëtorëve për shpërndarjen e 20%, raportet përfundimtare të likuidimit, komunikatave për media, raportet dhe rregulloret e AKP-së, rezultatet dhe vendimet për shitjet e Ndërmarrjeve të Reja dhe Aseteve, si dhe informatave të tjera të rëndësishme.

Njëkohësisht, si pjesë integrale e ueb faqes së AKP-së është edhe linku për qasje në arhivën e ueb faqes së AKM-së, e cila pasqyron të dhënat mbi privatizimin deri në periudhën Qershor 2008, kur edhe është bërë transferimi i përgjegjësisë në AKP.

Ueb faqja e AKP-se vazhdimisht ka treguar rritje të konsiderueshme të vizitorëve, me punën të cilën ka bërë dhe është duke e bërë që nga marrja e mandatit të saj. Megjithatë, gjatë përdorimit të ueb faqes aktuale janë

evidentuar shumë vështirësi dhe pengesa për funksionim efikas, marrë parasysh vjetërsinë dhe mospërshtatshmërinë me teknologjinë aktuale. Bazuar në trendet aktuale të fushës së teknologjisë, një ueb faqe është e nevojshme që të ri-dizajnohet çdo 2 vjet dhe të rindërtohet çdo 5 vjet. Me qëllim që faqja të menaxhohet në mënyrë proaktive (pasi që aktualja është e punuar me teknologji të vjetër - viti 2011) është shfaqur nevoja për të sjellë teknologjinë dhe një dizajn të ri që do të përmbushte nevojat e vizitorëve dhe punës së Agjencisë. Andaj, marr parasysh nevojën për ndryshim është iniciuar procedura për transferimin në një ueb faqe të re, e cila pritet të aktivizohet deri në fund të vitit 2016.

5.3. NJËSIA PËR KONTROLLË DHE MBIKËQYRJE

Njësia për kontrollë dhe mbikëqyrje ka për detyrë që të monitorojë përmbushjen e zotimeve për investime kapitale, zotimit për punësim dhe vazhdim të aktivitetit të biznesit, sipas Marrëveshjes për Zotime për ndërmarrjet e privatizuarit përmes metodës së Spin Off-it Special dhe Spin Off-et me kushte.

Gjithashtu Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje bazuar në planin e biznesit për 2016 nga ndërmarrjet të cilat ende nuk janë futur në likuidim bën:

- Mbledhjen dhe analizimin e raporteve financiare të NSh-ve të si dhe
- Vizitat dhe kontaktet me institucionet tjera relevante në mënyrë që të kemi një komunikim më të mirë me institucionet e interesit të përbashkët si dhe koordinimin e aktiviteve me njësitë tjera brenda AKP.

Në vazhdim po paraqesim raportin mbi ndërmarrjet që janë nën monitorim të NJKM.

“Spin off-et” Speciale

Që nga fillimi i procesit të privatizimit e deri më tani janë privatizuar 26 ndërmarrje përmes metodës së “Spin Off-it Special”. Nga këto ndërmarrje 20 janë liruar nga marrëveshja e zotimeve, 4 ndërmarrjeve për shkak të mospërmbushjes së zotimeve për investime dhe punësim me vendim të Bordit të AKP-së iu janë marrë aksionet kurse dy ndërmarrje të privatizuara me metodën e “Spin Off-ve Speciale” janë monitoruar nga Njësia për kontroll e mbikëqyrje gjatë periudhës nga 01.01.2016 deri 30.09.2016 e këto janë ‘IDGJ Tobacco’ Gjilan dhe “ NBI Suhareka” (Agrokosova Holding)- Suharekë.

Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco”

Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco” Shpk, është privatizuar përmes metodës së Spin Off-it Special në valën e 11-të shitjes, ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të parapara në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 13 Gusht 2008. Me datë 27 Mars 2012 është aprovuar Marrëveshja për Përtëritje (Novacion) e Marrëveshjes së Zotimeve lidhur me Ndërmarrjen e Re “IDGJ Tobacco” Shpk nga Grupi punues i AKP-së. Kjo Marrëveshje është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 29 mars 2012, si dhe është nënshkruar nga të gjitha palët e përfshira në këtë Marrëveshje me datë 12 prill 2012, ku kusht për këtë Ndërmarrje gjatë periudhës dy vjeçare është të realizoj Investime prej 4,000,000.00 € dhe të plotësoj numrin e punëtorëve prej 14 punëtor në muajin e parë, 35 punëtor në muajin e dytë, 55 punëtor në muajin e tretë dhe 90 punëtor nga muaji i katërt e deri në përfundim të Marrëveshjes së Novacionit. Periudha e raportimit për këtë ndërmarrje ka përfunduar me 10 shtator 2014. Në mënyrë që të verifikohen Investimet e realizuara dhe punësimi në këtë Ndërmarrje nga ana e Blerësit, AKP ka angazhuar kompaninë audituese të pavarur për të bërë auditimin e Investimeve dhe punësimit të realizuar. Kompania audituese më datën 19.12.2014 ka dorëzuar raportin e auditimit ku sipas këtij raporti Blerësi nga 4,000,000.00 Euro investime të zotuar ka

realizuar investime në vlerë prej 3,254,238.07 apo shprehur në përqindje 81.36 %. Sa i përket punësimit sipas raportit të auditimit Blerësi ka përmbushur zotimet për punësim në përqindje prej 95.68%.

Blerësi ka kërkuar që periudha e përmbushjes së zotimeve ti zgjatet deri më 28.02.2015 ngase deri në këtë periudhë ai ka raportuar investime në vlerë prej rreth 4,818,609.47 €. Kërkesa e palës për t'iu zgjatur afati i investimeve ende nuk është shqyrtuar nga ana e Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Ekipi i Njësisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes ka realizuar vizita të rregullt monitoruese në Ndërmarrjen e Re "IDGJ Tobacco" LLC për të parë nga afër gjendjen në Ndërmarrje dhe vizita e fundit ka qenë më datën 04.10.2016 nga kjo vizitë është pa se Blerësi kishte filluar prodhimin më datën 29.09.2016 dhe sipas DEKLARIMEVE TË Blerësit prodhimi dedikohet kruesisht për eksport.

Ndërmarrja e Re "NBI Suhareka/Agrokosova Holding"-

Është privatizuar me 27 gusht 2007 nga blerësi "Gruppo Vinicolo Fantinel" dhe "QMI" përmes metodës së "Spin Off-it Special" në valën e 19-të të shitjes ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të paraparë në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 27 gusht 2009. Sipas Marrëveshjes së Zotimeve blerësi është zotuar se do të bëjë investime kapitale në vlerë prej 8,600,000 euro si dhe të punësoj 173 punëtorë gjatë 6 muorit të parë ndërsa në fund të vitit të parë numri i të punësuarve do të arrijë gjithsej 345 punëtorë. Në mbledhjen e Bordit të AKP-së të mbajtur më datën 26 dhe 31 gusht 2014 Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të privatizimit lidhur me çështjen e Ndërmarrjeve të reja të privatizuara ne Spin off Special ka vendosur që për Ndërmarrjen e Re "Agrokosova Holding" të anulohet vendimi i Bordit të datës 16 dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve dhe t'i vazhdohet afati për përmbushjen e kushteve të Marrëveshjes për Zotime nga 27 gusht 2009 e deri me 31 dhjetor 2014 dhe pas përfundimit të afatit të auditohet ndërmarrja për tërë periudhën e investimeve sipas kontratës për të vërtetuar përmbushjen e zotimeve.

Nga blerësit e Neë Co Agrokosova Holding kemi pranuar kërkesën për zgjatje të afatit për realizimin e investimeve. Kjo kërkesë arsyetohet me kushtet dhe rrethanat e krijuara në këtë ndërmarrje si dhe kërkohet që ti shtyhet afati për investime deri më 30 Prill 2015.

Sipas raportit të fundit të auditimit të realizuar nga kompania e auditimit "AK Konto" për periudhën nga 27.08.2014 deri më 31.12.2014 ku nga vlera 8,600.000.00 Euro janë përmbushur 7,045,713.00 Euro apo 81.93 %. Ku shihet se ka dallimi të mëdha në mes të këtij auditimi dhe atyre të kryera më herët nga kompanitë Univerzum Audit dhe Trend Biz.

Pas këtij raporti Nga blerësit e Ndërmarrjes së Re "Agrokosova Holding" kemi pranuar kërkesën për zgjatje të afatit për realizimin e investimeve. Kjo kërkesë arsyetohet me kushtet dhe rrethanat e krijuara në këtë ndërmarrje si dhe kërkohet që ti shtyhet afati për investime deri më 30 Prill 2015 ngase ata kanë dorëzuar një raport në të cilin theksojnë se ata kanë realizuar për periudhën nga 01.01.2015 deri më 30.04.2015 investime në vlerë prej 1,805,500.00

Përgjatë muajit shtator 2016 është realizuar vizita e fundit në këtë ndërmarrje ku shihet se blerësi është duke u angazhuar për të filluar me prodhimin e verës përgjatë këtij viti ngase për shkak të problemeve me aksionar në vitin e kaluar nuk ka prodhuar fare verë.

Aktualisht në këtë ndërmarrje është duke u punuar në kulturat e vreshtës, ku janë të angazhuar punëtorë sezonal, në murosjen e disa pjesëve brenda hallës së prodhimit dhe rregullimin e pjesës së jashtme të objektit. Në këtë ndërmarrje vazhdon të menaxhojë vetëm përfaqësuesi i aksionarit "QMI".

Lidhur me privatizimin dhe situatën e përgjithshme tek kjo ndërmarrje kemi pasur disa kërkesa për informata nga Policia e Kosovës dhe Dogana të cilat informata ne u kemi siguruar atyre.

Ndërmarrjet e Privatizuara me Kushte

Gjatë periudhës 01.01.2016 deri 30.09.2016, nëntë Ndërmarrje të privatizuara me kushte kanë qenë në procesin e monitorimit të përmbushjes së kushteve të kontratës, kryesisht vazhdimin të aktivitetit të njëjtë të biznesit. Ndërmarrja “Llamkos” L.L.C për shkak se Blerësi i saj kishte obligime ndaj një banke Angleze me vendim të Gjykatës Themelore ka filluar procedurën e likuidimit dhe është caktuar administratori i saj kurse ndërmarrja e Re “Hotel Onix dhe Banja e Pejës” është liruar nga marrëveshja e zotimeve.

Tabela përmbledhëse e ndërmarrjeve të privatizuara me kushte:

Nr.	Emri i Ndërmarrjes	Statusi	Qyteti	Regjioni
1	Ndërmarrja e Re “SharrCem”	Nën monitorim	Hani i Elezit	Gjilan
2	Ndërmarrja e Re “Hotel Union”	Nën monitorim	Prishtinë	Prishtinës
3	Ndërmarrja e Re “Famipa”	Nën monitorim	Prizren	Prizrenit
4	Ndërmarrja e Re “Amortizatorët”	Nën monitorim	Prishtinë	Prishtinës
5	Ndërmarrja e Re “Dubrava DF”	Nën monitorim	Istog	Pejës
6	Ndërmarrja e Re “Emin Duraku-Edico”	Nën monitorim	Gjakovë	Pejës
7	Ndërmarrja e Re “Emin Duraku”- KI	Nën monitorim	Gjakovë	Pejës
8	Ndërmarrja e Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça”	Nën monitorim	Pejë	Pejës
9	Ndërmarrja e Re “Hotel Onix dhe Banja e Pejës”	Nën monitorim	Pejë	Pejës

Ndërmarrja e Re “Hotel Onix dhe Banja e Pejës” është liruar nga monitorimi në Shtator 2016.**Ndërmarrja e Re “Sharrcem”**

Është privatizuar me 9 dhjetor 2010 për shumën prej EUR 30.1 milion. Sipas Marrëveshjes për Shitblerjen e aksioneve blerësi ka marrë përsipër që gjatë 5 viteve në vijim të bëjë investime në vlerë prej 35 milion euro si dhe të vazhdojë të punësoj gjatë 3 viteve të para të gjithë ish- punonjësit e ndërmarrjes, gjithsej 503. Ndërmarrja e Re “Sharrcem” ka qenë e obliguar t’i raportoj AKP-së deri më 9 dhjetor 2015.

AKP ka angazhuar kompaninë audituese ndërkombëtare “BDO Kosovo” që të bëjë auditimin e përmbushjes së zotimeve nga ana e Blerësit. Investimet e raportuara nga ana e Blerësit gjatë periudhës së zotimit kanë qenë në vlerë prej 25,437,000.00 Euro si dhe investime tjera shtesë pas përfundimit të periudhës së zotimeve duke përfshirë blerja e një mulliri horizontal në vlerë prej 3,500,000 si dhe blerja e disa aksioneve në një kompani jashtë hapësirave të ndërmarrjes në vlerë prej 2,900,000 dhe ka blerë disa aksione jashtë Kosovës në vlerë prej 1,408,000.00 Euro dhe pretendon se edhe këto investimet e fundit duhet të njihen si investime kapitale.

Për shkak të interpretimeve të ndryshme të disa termave të kontratës së shitjes nga ana e Blerësit dhe kompanisë audituese kompania audituese ende nuk ka dorëzuar raportin final i cili pritet të finalizohet së shpejti.

Ndërmarrja e Re “Famipa”

Ndërmarrja e Re “Famipa” sh.p.k është privatizuar në valën 49 të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitblerjes është nënshkruar me datën 13 Shtator 2011.

Shtojca 5, Seksioni B i Deklaratës së bartjes të aseteve dhe detyrimeve parasheh që blerësi i Ndërmarrjes së Re “Famipa” do të vazhdoj aktivitetin e njëjtë në ndërmarrje (prodhimin dhe përpunimin e metaleve) si dhe nuk do të çmontoj dhe dislokoj pajisjet nga ndërmarrja deri në përfundim të kontratës që ka qenë 13 shtator 2014.

Pas përfundimit të marrëveshjes së zotimeve AKP ka angazhuar kompaninë audituese e cila ka bërë auditimin e përmbushjes së zotimeve nga ana e Blerësit ku sipas ka dorëzuar raportin e auditimit të kryer për ndërmarrjen e Re, „Famipa” Prizren, ku edhe sipas raporti të kompanisë audituese aktiviteti i ndërmarrjes nuk është mbajtur në kontinuitet por varësisht prej porosive që dhe në kërkesën e AKP-së që kompania audituese të japë opinion të qartë mbi përmbushjen e kushtit të mbajtjes së aktivitetit, kompania audituese në raportin final të dorëzuar ka theksuar se: “pasi që kontrata e shitjes nuk e definon qartë as në mënyrë sasiore, as në vlerë kushtet e përmbushjes së kontratës mbi mbajtjen e aktivitetit”, atëherë sipas tyre është e pamundur që të japin një konstatim të qartë në lidhje me ose në mos përmbushjen e zotimeve.

Ndërmarrja e Re “Hotel Union”

Ndërmarrja e Re Hotel Union është privatizuar në valën 11, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 02 gusht 2006. Bazuar në Marrëveshjen e Zotimeve 541/2006, neni 2 dhe 3, blerësi i Ndërmarrjes së Re është zotuar së do të restauroj dhe mirëmbajë pamjen e jashtme të ndërtesës në atë mënyrë që thellësisht të ruaj stilin dhe karakterin historik të ndërtesës si dhe t’i siguroj Aleancës së Shkrimtarëve të Kosovës një hapësirë prej 200 m² për 13 vitet e ardhshme.

Njësia për Kontrollë dhe Mbikëqyrje vazhdimisht ka angazhuar takime në mes të Benetton Group si palë blerëse e ndërmarrjes dhe Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Gjatë këtyre takimeve asnjëherë nuk është arritur ndonjë marrëveshje për sigurimin e hapësirës për LSHK-në. Përfaqësuesit e Benetton Group kanë ofruar opsione të ndryshme ju kanë dhënë mundësinë e zgjedhjes së lokacionit prej 200 m² në çfarëdo pjese të qytetit por që LSHK vazhdimisht insiston që 200 m² ti ndahen në hapësirën brenda objektit të Ndërmarrjes së Re. Në takimin e fundit përfaqësuesit e Benetton Group ju kanë ofruar shumën prej 150,000.00 Euro LSHK-së por që edhe ky option është refuzuar nga ana e tyre.

Ndërmarrja e Re “Hotel Onix Banja e Pejës dhe Banja e Shëndetit” - Pejë:

Ndërmarrja e Re “Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix” shpk, është privatizuar si projekt individual përmes tenderit ndërkombëtarë ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 22 prill 2013. Bazuar në shtojcën 1, Marrëveshja për Zotime e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve të thjeshta në Ndërmarrjen e Re “Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix” shpk, Blerësi është zotuar si në vijim:

Të vazhdoj aktivitetin aktual të biznesit që nënkupton vazhdimin e veprimtarisë së njëjtë të Ndërmarrjes Shoqërore në banjë shëndetësore dhe hotel deri më 22 prill 2016. Blerësi i Ndërmarrjes së Re siguron dhe garanton se do të vazhdoj dhe do të mbajë aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e Periudhës së Zotimit. Ndërmarrjen e Re “Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix”.

Blerësi ka dorëzuar raportin e fundit gjashtëmujor dhe pritet angazhimi i kompanisë auditues e cila do të bën auditimin e përmbushjes së zotimeve nga ana e Blerësit.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar tri vizita ku nga to dhe nga raportimit e bëra nga ana e Blerësit mund të konstatojmë se Blerësi iu është përmbajtur kushteve të kontratës për mbajtjen e aktivitetit dhe ka bërë një numër të investimesh shtesë si në qendrën rehabilituese por edhe jashtë saj.

AKP ka angazhuar kompaninë audituese “Audit & Konto” për të bërë auditimin e përmbushjes së marrëveshjes së zotimeve. Sipas kompanisë auditues Blerësi ka përmbushur kushtet e parapara me marrëveshjen e zotimeve dhe bazuar në këtë NJKM ka përgaditur memo për Bordin e Drejtorëve të cilët në mbledhjen e mbajtur më datën 21 shtator 2016 kanë liruar ndërmarrjen nga marrëveshja e zotimeve.

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Amortizatorëve”

Është privatizuar në valën 45A, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar më 31 mars 2011. Ndërmarrja e Re “Fabrika e Amortizatorëve” gjendet në Komunën e Prishtinës. Në bazë të marrëveshjes, si detyrim kontraktues Blerësi i ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe mbaj aktivitetin aktual të biznesit. Blerësi ka raportuar në periudha të rregullta ashtu siç parashihet edhe me Kontratë. Periudha e Monitorimit përfundon më 31 mars 2016 dhe Blerësi ka dorëzuar raportin e fundit gjashtëmujor. Pasi që është bërë përzgjedhja e kompanisë audituese pritet vendimi i Bordit të AKP-së që të fillohet ky auditim.

Ndërmarrja nuk ka pasur asnjëherë prodhimtari serike por kryesisht me porosi dhe më shumë të hyrat e tyre janë krijuar nga riparimet e amortizatorëve të vjetër dhe nga qiraja ngase një pjesë të hapësirave të tyre e kanë lëshuar me qira. Blerësi furnizohet me lëndë të parë kryesisht në tregun e Kosovës dhe për ndonjë pjesë specifike furnizohet nga partneri Slloven “Amortizeri D.O.O).

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar disa vizita monitoruese ku situatë ka qenë ashtu siq është përshkruar më lartë, kurse sa i përket numrit të punëtorëve të angazhuar në ndërmarrje ai ka qenë nga 18 deri në 20.

Me datën 9 shtator 2016 është pranuar raporti i auditimit nga Kompania e jashtme e pavaruar “Audit & Konto” ku sipas raportit të auditimit citohet: *“Edhe pse Kontrata e Shitblerjes nuk jep specifika mbi kriteret matëse se çka nënkupton aktiviteti aktual i biznesit apo në cilën masë të qarkullimit do të konsiderohet i mjaftueshëm mbajtja e aktivitetit aktual të biznesit, prandaj duke pasur parasysh gjetjet e specifikuar më lartë, asgjë nuk ka ardhur në vëmendjen tonë që na bën neve të besojmë që Ndërmarrja e Re “Fabrika e Amortizatorëve” sh.p.k nuk e ka vazhduar dhe mbajtur aktivitetin e biznesit në masën e parametrave të shitjes, blerjes, nr. të Punëtorëve dhe Investimeve të specifikuar në fq 4-8 për periudhën pesë (5) vjeçare ashtu siç ka qenë e paraparë në nenin dy (2) të Marrëveshjes për Detyrime Kontraktuese”.*

Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Kompleksi Industrial” Shpk

Është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 03 shtator 2012. Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Kompleksi Industrial” Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 03 shtator 2017. Pjesa dërmuese e ndërmarrjeve të shitura me kushte nuk kanë ndonjë obligim kontraktual për investime apo punësim me shifra por kanë kusht vetëm mbajtjen e aktivitetit aktual të biznesit.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 2 vizita monitoruese dhe nga këto vizita konstatojmë se ndërmarrja kryesisht është duke u marrë me prodhimin e dushekëve kurse nuk ka ndonjë prodhimtari tjetër në fushën e tekstilit. Blerësi i kësaj ndërmarrje ka vazhduar partneritetin me kompaninë “INTERTEX” shpk, dhe ku sipas këtij partneritetit të lidhur ndërmjet “Intertex” dhe Blerësit të Ndërmarrjes së Re “Emin Duraku Kompleksi industrial” Blerësi është duke i ofruar objektin kompanisë “Intertex” e cila është duke prodhuar mbulesa për një përdorim për Kompaninë e veturave “VOLVO” si dhe është duke bërë edhe prodhimin e disa produkteve të tjera. Numri i punëtorëve të angazhuar në ndërmarrje është 14 nga të cilët 8 janë në prodhim kurse 6 punojnë si roje.

Në bazë të raportimeve të Blerësit dhe nga vizitat monitoruese shihet se Blerësi deri më tani nuk ka ndonjë prodhim të kënaqshëm dhe ka të punësuar 14 punëtor, 8 prej tyre në prodhim dhe 6 të tjerë në cilësinë e rojeve.

Ka edhe disa partneritetit me dy Kompani “Intertext” dhe “Bluechip” LLC – “Comodita Home”, Blerësi raporton partneritet me këto dy kompani vetëm në të shkruar si raport, por asnjëherë nuk na ka ofruar ndonjë dëshmi apo kontratë partneriteti me këto dy Kompani edhe pse iu është kërkuar një gjë e tillë.

Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Edico” Shpk,

Është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 14 gusht 2012. Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Edico” Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 14 gusht 2017. Blerësi është duke e vazhduar aktivitetin në fushën e tekstilit, kryesisht prodhimin e trikove, veshjeve sportive dhe xhinseve. Një kohë të gjatë Blerësi ka pasur probleme të furnizimit me energji elektrike por që ky problem gjatë pjesës së parë të këtij viti është zgjidhur.

Nga vizitat dhe raportet e dorëzuara deri më tani nga ana e Blerësit konstatohet se deri më tani Blerësi është duke mbajtur aktivitetin e tij në përputhje me marrëveshjen e zotimeve.

Ndërmarrja e Re “Dubrava Dairy Farm” –

Është privatizuar në valën e 28 –të të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 19 dhjetor 2011. Ndërmarrja e Re “Dubrava Dairy Farm” gjendet në Komunën e Istogut. Në bazë të Marrëveshjes, si detyrim kontraktues Blerësi i Ri ka marrë përsipër që të vazhdojë dhe të mbajë aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së detyrimit kontraktues, respektivisht deri më 19 dhjetor 2016, (periudha prej 5 viteve). Detyrimi kontraktues që del nga kontrata është që Ndërmarrja e Re “Dubrava Dairy Farm” është e obliguar të mbajë të punësuar 17 punëtor, si dhe të mbajë 250 krerë gjedhe për këtë periudhë kohore në bazë të Kontratës.

Blerësi vazhdon aktivitetin e tij në përputhje me marrëveshjen e zotimeve dhe mban numrin prej 260 krerë gjedha dhe 17 punëtor të cilëve përpos pagës iu siguron edhe shujtën e ngohtë. Në bazë të marrëveshjes që ka me kompaninë “Rugova” qumeshtin e shet tek kjo kompani. Gjithashtu vlen të theksohet se ndërmarrja gjatë kësaj periudhe është angazhuar në mbjelljet pranverore të tokës bujqësore që posedon.

Nga raportimet e bëra nga ana e Blerësit dhe nga vizitat monitoruese konstatohet se deri më tani Blerësi dhe ndërmarrja e re ka mbajtur aktivitetin e tij bazuar në marrëveshjen e zotimeve.

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça”

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça” Sh.p.k, është privatizuar si projekt individual ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 14 qershor 2013 dhe sipas marrëveshjes së shitjes Blerësi i Ri siguron dhe garanton se do të vazhdojë dhe do të mbajë aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së Zotimit për tri vitet e ardhshme, konkretisht deri më 14 qershor 2016.

Janë zhvilluar vizita monitoruese ku mund të konstatohet se ndërmarrja prodhon kryesisht bateri me porosi, pasi që sipas përfaqësuesve të Blerësit ata nuk kanë treg për prodhimtari serike prandaj janë të orientuar për prodhimtari vetëm me porosi. Prodhimtaria e tyre e baterive ka qenë kryesisht për Trepçën veriore dhe pak për eksport në Shqipëri.

Sipas raportimeve të Blerësit në ndërmarrje janë duke punuar 38 punëtor për të cilët edhe pagesat e pagave bëhen me vështërsi dhe me vonesa disa muajshe. Gjatë vizitës së fundit të bërë në këtë ndërmarrje është parë se në hapësirat e ndërmarrjes ka filluar ndërtimi i një pike karburanti.

Akp pas përfundimit të marrëveshjes së zotimeve ka angazhaur kompaninë audituese “Audit & Konto” për të bërë auditimin e përmbushjes së kushteve të marrëveshjes së zotimeve. Sipas raportit të kompanisë audituese Blerësi ka prodhuar kryesisht sipas kërkesave individuale dhe përmbushur kushtet e marrëveshjes së zotimeve.

Ndërmarrja e Re “Kualiteti International” Sh.p.k Gjilan

Është privatizuar në valën e 25 të shitjes dhe kontrata është nënshkruar më datën 26 maj 2008. Shitja e ndërmarrjes është bërë me spin off të thjeshtë, por me kusht që gjatë periudhës 2 vjeçare ndërmarrja të mbajë aktivitetin e vet si mulli respektivisht si depo për grumbullimin e drithërave.

Blerësi i ndërmarrjes edhe përkundër shkresave të dërguara nga AKP ka bërë shitjen e pjesës më të madhe të parcelave të ndërmarrjes ku tani aty janë duke u ndërtuar disa objekte afariste banesore. Gjithashtu aty ka filluar demolimi i Mullirit me qëllim të ndërtimit të objekteve banesore. Prona në të cilën ka qenë mulliri tani sipas të dhënave të marra nga kadastru Komunesë së Gjilanit nuk është më në emër të Ndërmarrjes së Re “Kualiteti International”. Lidhur me keto transfere të pronës AKP ka dërguar shkresa në departamentet përkatëse të komunesë së Gjilanit dhe tek blerësi lidhur me shkeljet që janë bërë nga ana e Blerësit. Padin që AKP ka bërë lidhur me fillimin e ndërtimeve pa leje Dhoma e Posaqme e ka hedhur poshtë prandaj zyra ligjore ka bërë prapësim në këtë vendim.

Gjatë këtij viti AKP ka angazhuar kompaninë audituese “Audit & Konto” për të audituar kushtet e kontratës.

Sipas raportit të auditorit blerësi i kësaj ndërmarrje ka mbajtur aktivitetin e vet, por që këtë aktivitet e ka mbajtur me një entitet tjetër biznesor të regjistruar pranë ARBK me emër FBM “Kualiteti” dhe numër tjetër të biznesit që është 70547066.

Ndëshkimet financiare për mospërmbushje të zotimeve nga blerësit:

Për shkak të mospërmbushjes së zotimeve deri me tani janë aplikuar ndëshkimet financiare për blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet.

Me poshtë japim formën tabelore të ndëshkimeve për periudhën kohore nga fillimi i privatizimit të ndërmarrjeve me spin off special deri më 30.09.2016:

Shuma totale e ndëshkimeve për 5 SSO-të dhe një ndërmarrje me likuidim	
Ndërmarrja e Re	Prej datës së fillimit deri më 30.09.2016
Ndërmarrja e Re “Grand Hotel”	8,822,314.97
Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco”	4,573,649.11
Ndërmarrja e Re “Xim Strezovc”	7,298,170.76
Ndërmarrja e Re “MIM Golesh”	8,447,812.27
Ndërmarrja e Re “Agrokosova Holding”	3,579,997.53
Ndërmarrja e Re “Llamkos”	1,715,488.79
Gjithsej	EUR 34,437,433.43

5.4. NJËSIA E ADMINISTRIMIT DIREKT

Në rrjedhën normale të ngjarjeve, mbikëqyrja, kontrolli dhe monitorimi i ndërmarrjeve bëhet nga Zyrat Rajonale të AKP-së. Masat e Administrimit Direkt janë implementuar në rastet specifike kur një NSH kishte ngadalësim apo ngecje në progres apo ishte në rrezikshmëri financiare për shkak të keqmenaxhimit, apo dëmtimit të aseteve e që reflektonte në dëm të interesave të NSH-së dhe punëtorëve të saj. Kur Zyrat Rajonale të kenë shterur të gjitha mundësitë dhe opsionet për të gjeneruar ndikim pozitiv në NSH-në e cila shfaq një trend të rënies, atëherë propozohen masat e Administrimit Direkt nga Zyrat Rajonale të AKP-së për t'u implementuar në këtë ndërmarrje. Të gjitha NSH-të e vendosura dhe/ose të larguara nga AD janë të miratuara nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

Gjatë periudhës raportuese Njësia e AD ishte kryesisht e fokusuar në Administrimin e Ndërmarrjeve të cilat me vendim të Bordit ishin vendosur nën AD, po ashtu kishte përgatitur të dhënat për Ndërmarrjet të cilat janë larguar nga AD.

Ereniku-Industria

- Takime me anëtarët e Bordit të Përkohshëm Menaxhuese të NSH “Ereniku-Industria” Gjakovë dhe Zyrtaren e Financave. Në takime ishin diskutuar problemet financiare me të cilat është duke u ballafaquar aktualisht Ndërmarrja, për shkak të mos inkasimit të qirasë me kohe dhe në lidhje me përgatitjen e vërejtjeve për qiramarrësit.
- Deklarimi dhe procedimi i pagesës së TVSH-së, për muajin Janar - shtator 2016 për NSH “Ereniku-Industria” Gjakovë. Procedimi i tatimit të mbajtur në burim dhe kontributit pensional për punëtorët e Ndërmarrjes për muajin Janar -shtator 2016.
- Është proceduar Memorandumi për Bordin e Drejtorëve të AKP-së me kërkesë për aprovimin e hyrjes në qira për dy asete: Aseti i NSH “Ereniku-Industria” Pronë, është regjistruar në ngastrën kadastrale nr. 78 në vendin e quajtur Piskotë me sipërfaqe prej 0.89.94 ha sipas fletës poseduese nr. 941 ZK Jahoc, në të cilën është ndërtuar një pompë e derivateve si dhe një objekt banimi. Prona është e regjistruar në pronësi të Ndërmarrjes dhe aktualisht është e uzurpuar. Njëherit uzurpatori është në kontest pronësor me Ndërmarrjen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, pasi që pretendon pronësinë mbi ngastrën në fjalë bazuar në një dokument të para luftës. I njëjti ka parashtruar kërkesë për të hyrë në marrëdhënie të qirasë me AKP. Aseti tjetër i NSH “Ereniku-Industria” është regjistruar në çertifikatën e pronësisë me nr. UL-70705029-01474 me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.31,58 ha dhe me sipërfaqe të objektit prej 200m2 e cila shfrytëzohet nga Ndërmarrja Publike për pastrimin e mbeturinave “Çabrat”. Ndërmarrja publike pretendon pronësinë mbi këtë aset dhe e ka në shfrytëzim qysh nga koha e paraluftës.
- Përgatitja e informatave në lidhje me asetin (depon në Fushë Kosovë) e NSH “Ereniku-Industria”, meqenëse NR ishte liruar nga masa e përkohshme dhe ishte kërkuar që të përfundohet me draft kontratën e shitjes. Në këtë kontest Zyra Rajonale e Pejës ka kërkuar informacione, në lidhje me borxhet që Ndërmarrja ka për asetin në fjalë ndaj PTK, KUR Prishtina, KEDS, TVSH-së, tatimit në pronë, informata për hipotekë dhe peng, dhe informata të tjera të cilat janë të nevojshme për përfshirje në kontratën e shitjes.
- Pas disa përpjekjeve kemi arritur që të dorëzojmë asetin tek Blerësi.

NSH “Boksitet e Kosovës”

Kemi ekzekutuar garancionin bankar për kontratën e qirasë për shfrytëzimin e separacionit. Pas shumë përpjekjeve kemi arritur që të ekzekutojmë garancionin bankar të qiramarrësit i cili kishte marrë me qira separacionin në muajin nëntor të vitit 2015 dhe pas nënshkrimit të kontratës së qirasë nuk kishte pranuar ta shfrytëzoj asetin me çmimin e ofertuar. Si rrjedhojë e kësaj NJAD kishte proceduar rastin tek përmbaruesi dhe tek Kompania e Sigurimeve për ekzekutimin e Garancionit Bankar.

Aktivitetet e NSH-së gjatë kësaj periudhe ishte kryesisht qiradhënia e aseteve si dhe kompletimi i dokumentacionit kadastral për pronat e Boksiteve e po ashtu edhe kordinatat e boksive të cilat ishin kërkuar nga KPMM.

Vlenë të theksohet se KPMM kishte kërkuar kordinatat e boksive pasi që një kompani kishte parashtruar kërkesë për hulumtim në zonën e boksive, andaj në mënyrë që të mos japet licenca mbi trupat e boksive janë kërkuar edhe njëherë koordinatat. Kordinatat si dhe të gjitha fletat poseduese dhe dëshmitë pronësore për pronat e boksive dhe ekonomive pyjore nën të cilat shtrihen trupat e boksive janë dorëzuar në KPMM.

Me datën 08 mars 2016 nga menaxhmenti kishte aprovuar lëshimi i separacionit me qira. Pas shpalljes publike qiradhënia kishte rezultuar pa sukses pa ofertues dhe menjëherë për të mos humbur kohë është rishpallur ftesa publike për qiradhënie me datën 13.04.2016. Edhe në këtë rast dy ofertuesit e parë ishin tërhequr duke mos pranuar që të paguajnë kushtet e ofertës për garancione bankare, kështu që është ftuar ofertuesi i tretë që të nënshkruaj kontratën me çmimin e parë.

Duhet theksuar se për Fabrikën e Llaçit të thatë nuk kishte pasur ofertues të serioz pasi që në momentin e kërkesës së garancionit bankar janë tërhequr.

Ndërsa për dy asetet tjera oborrit e ndërmarrjes dhe ish administratën në Volljakë kishte palë të interesuara dhe ishte proceduar me qiradhënie dhe me pagesë të dy qirave në formë avansi.

Po ashtu ndër aktivitetet e Ndërmarrjes ka qenë edhe përpjekja për rrethimin e gropës (bazenit) në zonën sferkës pas kërkesës së inspeksionit komunal. Ndërmarrja kishte filluar aktivitetin e hapjes së gropave mirëpo për shkak të hapësirës së madhe zonës shumë të vështirë për të punuar, petitionit të fshatarëve për ta mos mbyllur bazenin pasi që e shfrytëzojnë për ujë të pishëm për kafshë, është ndërprerë rrethimi i gropës dhe është vendosur të vendosen shenja se afërsia paraqet rrezik për jetë.

Sa i përket separacionit me datën 07 korrik 2016 është përgatitur Memorandumi për qiradhënie me komplet dokumentacionin përcjellës, duke përfshirë ofertat, vendimet e Bordit Menaxhues të Ndërmarrjeë pranimin e operatorit ekonomik që të marrë separacionin me qira sipas çmimit të ofertuesit të parë si dhe dëshimë e pagesës së dy qirave si kushtë për vazhdimin e procedurës së qiradhënies. Me datën 07 korrik 2016 Memorandumi është përcjellë në Menaxhment. Qiradhënia ishte anuluar nga Menaxhmenti.

Me datë 05.08.2016, pas aprovimit paraprak nga Menaxhmenti i AKP-së, Njësia e Administrimit Direkt ka shpallur në gazetën “Koha Ditore” qiradhënien e asetit “Separacionit” të NSH “Boksitet e Kosovës”, duke i ftuar qiramarrësit potencial që me datë 11.08.2016 të shprehin interesim për marrjen me qira të asetit të Ndërmarrjes.

Pas vlerësimit të komisionit me datën 22.08.2016, Menaxhmenti ka aprovuar memon për Bordin e AKP-së me propozimin për qiradhënien e asetit –Separacionit.

Bazuar në piken 6.11-I, të pikave të veprimit nga mbledhja e Bordit të Drejtoreve të muajit shtator Menaxhmenti ishte udhëzuar që të iniciojë serish procedurën e qiradhënies konform procedurave të qiradhënies. Për këtë fakt me datën 09.09.2016 është njoftuar Ndërmarrja dhe është udhëzuar që të njoftohet fituesi i perkohshëm për përsëritjen e tenderit për qiradhënie.

Pas rishpalljes publike me daten 11.10.2016 eshte bere hapja e ofertave. Komisioni kishte konstatuar se kishin ofertuar dy operator ekonomik të cilët i kishin plotësuar kushtet sipas ftesës publike. OP Beni construction-Viti me cmimin prej 1500 euro si dhe Jehona sh.p.k me cmimin prej 4830 euro per muaj. Gjate kesaj jave eshte parapare qe te hartohet procesverbali i vlerësimit të ofertave.

Ndërmarrje e Re “MIM Golesh”

Nga Ndërmarrja kemi pranuar Aktvendimin e lëshuar nga KPMM me të cilin kërkesa e AKP për bartje të licencës për shfrytëzimin e dunitit me nr. 10748/KPMM/2011 është aprovuar. Në arsyetimin e aktvendimit janë kërkuar disa kushte në mënyrë që ky aktvendim të hyjë në fuqi. Ndër këto kushte më i rëndësishmi është pagesa e borxhit ndaj KPMM në vlerë prej 37,229.86 euro, borxh ky i mbetur nga ish pronari por të cilin e kemi trashëguar në momentin e tërheqjes së aksioneve. Afati për përbushjen e kushteve është një muaj.

Me date 8.02.2016 kemi njoftuar Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale në lidhje me procedimin e pagesës së detyrimeve në emër të rentës minerare në vlerë prej 37,229.86 euro. Njoftimit u janë bashkangjitur fletëpagesa si dëshmi e pagesës së detyrimeve, polica e sigurimit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, formulari për caktimin e personit përgjegjës dhe garancioni bankar (siguria e ekzekutimit).

Me date 12.02.2016 kemi pranuar nga KPMM-ja fatura në lidhje me kryerjen e disa obligimeve shtesë për të cilat nuk jemi njoftuar me herët dhe atë totali i pagesave që duhet të procedohet në mënyrë që të behet bartja e licencës për shfrytëzimin e dunitit, është në vlerë prej 2,300.00 euro.

Përgatitja e memos për Departamentin e Financave në lidhje me pagesën e një pjese të borxhit që NR “MIM Golesh” ka ndaj PTK-së. Nga Menaxhmenti i Ndërmarrjes jemi njoftuar se PTK ka ndërprerë telefonin fikse dhe shërbimet e internetit për shkak të borxhit që Ndërmarrja ka ndaj PTK-së, dhe se për riaktivizimin e telefonisë fikse dhe shërbimeve të internetit kërkohet të paguhet vlera prej 354.76 euro që është shuma prej 70% e borxhit total në vlerë prej 506.81 euro.

Pas përpjekjeve një vjeçare më në fund kemi arritur të marrim licencën për shfrytëzimin e Dunitit. AKP ka paguar detyrimet ndaj KPMM për taksat dhe borxhet tjera të Ndërmarrjes të cilat kanë qenë kusht për bartjen e licencës.

Takim me Bechtel Enka dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Transportit lidhur me mundësinë e vazhdimin të kontratës për shitjen e dunitit material ky që i nevojitet Kompanisë Bechtel Enka për punimin e magjstrales Prishtinë – Shkup. Në takim u dakorduar që Bechtel Enka të dërgoj zyrtarisht kërkesën mandej AKP përmes Departamentit Ligjor do të trajtoj bazën ligjore për vazhdimin e kontratës me Bechtel Enka dhe të njëjtën ta procedoj për aprovim tek Bordi i Drejtorëve. Kontrata me Bechtel Enka është nënshkruar në Maj 2016.

Janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e punës të Kompanisë Bechtel Enka, lidhur me vendimin e bordit për vazhdimin e kontratës për shfrytëzimin e dunitit. Është vendosur peshorja elektronike e cila do të bëjë matjen e materialit i cili do të largohet nga Ndërmarrja. Po ashtu Njësia e Administrimit Direkt ka bërë të gjitha përgatitjet në aspektin procedural dhe teknik për të kontrolluar zbatimin e kontratës. Janë porositur paragonët dhe format tjera të cilat do të plotësohen dhe përmes së cilave do të evidentohet lloji dhe sasia e materialit, ku do të nënshkruhen deri në 4 zyrtar, duke filluar nga personi përgjegjës tek peshorja, kontrollori i kamionëve, roja e deri tek zyrtari për kontabilitet.

Me qellim te inkasimit te te hyrave per realizimin e te gjitha obligimeve dhe detyrimeve te Ndermarrjes stafi menaxhues i Ndërmarrjes dhe NJAD kishin shpallur ftesat per tender per shitjen e zhavorrit të Ndërmarrjes së re “MIM Golesh” si dhe për shitjen e materialit shkëmbor ultrabazik i perioditetit të Goleshit (material për mbushje) me granulacion - 60 +10 mm. Miëpo nuk ka pas palë të interesuara.

Licencat për shfrytëzimin e Dunitit dhe Magnezitit

Me qëllim të vazhdimës të kontratës me Bechtel Enka si dhe përpjekjeve për aktivizimin e Ndërmarrjes respektivisht shitjes së materialit të minuar të gatshëm i cili kishte mbetur në minierë nga aktivitetet e kompanisë Amerikano – turke Bechtel Enka, aktivitetet e cila ishin ndërprerë pas vendosjes së Ndërmarrjes nën Administrim Direkt, NJAD dhe Menaxhmenti i AKP-së kishin aplikuar për bartje të licencës nga ish pronari tek AKP. Për të ndërmarr ndonjë aktivitet në Ndërmarrje nëvojiteshin licencat për shfrytëzimin e Dunitit dhe të Magnezitit. KPMM në vazhdimësi kishte hezituuar transferimin e këtyre licencave tek AKP-ja me arsyetimin se në ndërkohë ishte duke u zhvilluar kontesti Gjyqësorë në mest të ish pronarit dhe AKP-së, i cili kishte paditur AKP-në për vendimin e Bordit për tërheqjen e aksioneve. Pas përfundimit të kontestit gjyqësorë në favor të AKP-së, KPMM kishte vazhduar procedurat e bartjes së licencave tek AKP-ja duke lëshuar licencën për shfrytëzimin e dunitit në muajin shkurt 2016.

Kontrata me Bechtel Enka

Si rrjedhojë e situatës së re të krijuar në Ndërmarrje me rastin e tërheqjes së aksioneve dhe ndërprerjes së kontratës e cila ishte në fuqi në mes të ish pronarit të Ndërmarrjes dhe Bechtel Enka, kompania Amerikano-Turke disa herë kishte kërkuar që kontrata në fjalë të vazhdohej apo së paku t'ju lejohet tërheqja e materialit të minuar nga ana e tyre. Për shkak të ndërrimit të pronarit të Minierës KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale) kishte refuzuar disa herë bartjen e licencës për shfrytëzimin e Dunitit tek AKP-ja. Si rrjedhojë e vendimeve të KPMM dhe mungesës së licencës për shfrytëzimin e dunitit, materiali në fjalë kishte mbetur pa tërhequr nga Bechtel Enka. Njëkohësisht kjo ka ndikuar negativisht në afarizmin e Ndërmarrjes duke pamundësuar inkasimin e të hyrave nga ana e Ndërmarrjes.

Me datën 16 mars 2016 Kompania “Hill International” Kompani për shërbime të ndërtimit mbikëqyrjes dhe menaxhimit të rrugës (autostradës) nr.6 Prishtinë – Han i Elezit dhe Ministria e Infrastrukturës bashkërisht kanë parashtruar kërkesë për vazhdimin e kontratës për shfrytëzimin (blerjen) e dunitit nga Ndërmarrja e Re “MIM Golesh” sh.p.k. Ndër të tjera duke sqaruar si në vijim: “Nëse MIM Golesh sh.p.k siguron këtë material atëherë nuk do të ishte humbje për koston totale të Qeverisë së Republikës së Kosovës pasi që një Njësi Publike do të rimbursonte një Njësi tjetër publike nëpërmjet kontratës publike. Në këtë rast për këtë projekt me rëndësi kombëtare, përfitimi i interesit publik mund të maksimizohet.”

Bazuar në kërkesën e kompanisë Bechtel Enka si dhe rekomandimit të Stafit Menaxhues të Ndërmarrjes, Njësisë së Administrimit Direkt dhe Menaxhmentit të AKP-së, Bordi i AKP-së në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2016 ka marrë vendim që të vazhdohej kontrata për shfrytëzimin e Dunitit në mes të NeëCo “Mim Golesh” sh.p.k dhe Bechtel Enka.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM NR.002/2014), neni 5 Plani i Mbylljes së Minierës për të gjitha ngastrat ose vend shfrytëzimet ku kërkohet rikultivimi, kërkohet garanci bankare e që përfshin shumën prej 12,000.00 euro për hektar, e duke marrë parasysh se shpërfaqja e licencuar e dunitit është 49,971.49 m² e që shprehur në vlerë financiare i bie të jetë 59,965.2 Euro, plus tarifa fikse në emër të garancionit në vlerë prej 1500 euro. Shuma e përgjithshme për pagese ka arritur vlerën rreth 61,465.2 Euro. Për ta kryer këtë pagesë, mjetet financiare janë siguruar në avans nga ndërmarrja Bechtel-Enka.

Pas hyrjes në fuqi të kontratës me Bechtel Enka, për shkak të rritjes së volumit të punës stafi menaxhues ka filluar angazhimin e punëtorëve në dy ndërrime. Lidhur me këtë Stafi menaxhues i Ndërmarrjes ka marrë vendim për harmonizimin e pagave si dhe rritjen e numrit të punëtorëve të cilët do të angazhohen nga muaji korrik 2016. Harmonizimi i pagave është bërë konform pozitës, edukimit profesional dhe përshkrimit të detyrave të punës. Të gjithë këta punëtorë ishin punëtorë të Ndërmarrjes “Neë Co MIM Golesh” në momentin e kthimit të aksioneve dhe vendosjes së Ndërmarrjes nën Administrim Direkt.

Aktualisht në Ndërmarrje janë të punësuar gjithsej 46 punëtorë të cilët marrin pagat me rregull paguhen tatimet dhe kontributet pensionale. Kompania Bechtel Enka ka përfunduar gjithsej 8 minime dhe tani mbetet vetëm të vazhdoj me tërheqjen e materialit të përpunuar.

Me datë 27.09.2016 në të përditshmet informative është shpallur Ftesa për Oferte në lidhje me angazhimin e një kompanie të licencuar për matjen e koncentratit të magnezitit dhe llogaritja e sasisë së tyre për nevoja të Ndërmarrjes së Re “MIM-Golesh” dhe AKP-së. Është bërë hapja e ofertave ndërsa vlerësimi pritet të bëhet ditët në vijim.

Është përgatitur lista e pajisjeve makinerisë si dhe hapësirave për deponim të materialeve në ndërmarrje. Kjo listë përmban të dhënat e pajisjeve tipi, viti i prodhimit dhe gjendja aktuale. Kjo listë është kërkuar nga Eksperti Gjerman i angazhuar nga GIZ, Dr. Joachim Schomburg, i cili mori përsipër angazhimin për hartimin e një propozim-projekti si të arrihet deri te maksimizimi i shfrytëzimit racional duke marr parasysh potencialin që ka MIM Goleshi me makineritë dhe pajisjet të cilat do të mund të shfrytëzoheshin ndër të tjerat edhe për përpunimin e hallojziteve të Trepçës. Person kontaktues për koordinim e vizitave të ekspertit Gjerman është Fatos Meça.

5.5. DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUIDIMIT

Divizioni i Likuidimit (DL) është njëri nga dy divizionet përmbajtësore të Agjencisë. Në kuadër të këtij Divizioni vepron Departamenti për Koordinim të Likuidimit (DKL). Qëllimi kryesor i Departamentit për Koordinim të Likuidimit është koordinimi i menaxhimit të procesit të likuidimit në Agjenci, si dhe mbikëqyrja e zhvillimit të politikave në funksion të implementimit të këtij procesi. Departamenti i Koordinimit të Likuidimit përbëhet nga tri njësi:

1. Njësia për Menaxhimin e Projektit të Likuidimit;
2. Njësia e Likuidimeve nga AKP-ja; dhe
3. Njësia për Listat e Punëtorëve.

NJËSIA PËR MENAXHIMIN E PROJEKTIT TË LIKUIDIMIT

Roli i kësaj Njësie shtesë nga menaxhimi i mbarëvajtjes së projektit të likuidimit është edhe përkrahja, këshillimet, udhëzimet dhe mbështetja që duhet ofruar për Autoritetet e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (në rastin konkret Kontraktori - Konzorciumi që përbëhet nga Deloitte dhe Tashko Pustina - Attorneys) gjatë procesit të Likuidimit. Po ashtu kjo njësi menaxhon programin e Likuidimit përmes përkujdesjes rreth implementimit të politikave operative dhe procedurave të AKP-së gjatë procesit të likuidimit.

Aktivitetet e rregullta për periudhën raportuese janë si në vijim:

- Ka filluar shpërndarja e mjeteve tek kreditorët e ligjshëm sipas raporteve të shpërndarjes të aprovuara nga Bordi i Agjencisë, janë gjithsej 103 Ndërmarrje për të cilat tashmë është bërë shpërndarja; ndërsa vlera e fondeve për shpërndarje për të gjitha 103 raportet e shpërndarjes ka arritur shumën € 14,651,943.22.
- Janë mbajtur mbledhja të rregullta me Udhëheqësit e Ekipeve të Likuidimit ku janë vendosur që të bëhet harmonizimi i PAK MS me raportet e shpërndarjes të aprovuara nga Bordi; të dërgohen propozimet për

rritjen e buxhetit të likuidimit për ndërmarrjet të cilat janë në prag të tejkalimit të buxhetit të aprovuar paraprakisht nga Bordi,etj;

- Janë dorëzuar të gjitha raportet me rregull nga kontraktori si dhe janë mbajtur mbledhjet e rregullta ku janë diskutuar çështje të ndryshme lidhur me mbarëvajtjen e procesit të likuidimit;
Për raportet mujore, progresit dhe vjetor janë përgatitur edhe raportet shqyrtuese të tyre, dhe janë prezantuar në Komitetin Drejtues të likuidimit;
- Numri i përgjithshëm i kërkesave kreditore të parashtuara pranë Agjencisë ka arritur në: 89,896 kërkesa, ndërsa numri i vendimeve të vendosura dhe të dërguara tek pretenduesit deri më tani ka arritur shifër: 89,505 vendime (83,519 vendime të marrura nga kontraktori dhe 5,986 vendime të mëhershme të marrura nga KL - AL);
- Numri i përgjithshëm i NSh-ve për të cilat ka filluar procesi i likuidimit deri më tani ka arritur shifrën prej 463 Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim; gjatë periudhës raportuese pas vendimit të bordit të Agjencisë procedurat e likuidimit kanë filluar për PRN067 NSh Qendra Shoqërore, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike “Pallati i Rinisë”;
- Gjatë periudhës raportuese janë regjistruar gjithsejtë: 244 kërkesa kreditore;
- Është pranuar Raporti i Auditimit nga Njësia e auditimit të brendshëm mbi aktivitetet e Departamentit të Koordinimit të likuidimit dhe Autoriteteve të Likuidimit e për periudhën kohore nëntor 2014 - tetor 2015.
- Në funksion të zbatimit të rekomandimeve nga raporti i fundit i pranuar nga auditori i brendshëm si dhe në funksion të mbarëvajtjes së procesit të tërësishëm të likuidimit është punuar në vazhdimësi për azhurnimin i aplikacionit të likuidimit me të gjitha zyrat rajonale.
- Janë publikuar grupe të komunikatave - njoftimet për vendime të AL-ve për pretenduesit për të cilët nuk u janë gjetur adresat në gazetatat vendore si dhe në ato në Serbi dhe Mal të Zi sipas procedurave;
- Janë përgatitur kërkesat dhe Memo për Komitetin Drejtues të Likuidimit-në dhe Komisionin e Bordit për aprovimin e raporteve të prezantuara në mbledhje të ndryshme të KDL-së të mbajtura gjatë periudhës raportuese;
- Janë bërë ndryshimet e nevojshme në përbërjen e AL-ve si nga ana e Kontraktorit ashtu edhe nga ana e stafit të AKP-së me qëllim të organizimit dhe shpërndarjes sa më të mirë të mundshme të punëve në mes të Zyrtarëve të Rastit.
- Vazhdimisht është përcjell insertimi i dokumenteve nga AL-të në aplikacionin e Likuidimit nga të gjitha zyrat rajonale të AKP-së me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të likuidimit;
- Janë përcjell procedurat për angazhimin dhe pagesën e ofruesve të shërbimeve dhe Kompanisë së Sigurimit Fizik për të gjitha Ndërmarrjet të cilat kanë pas kërkesa të tilla.
- Komiteti Drejtues i Likuidimit (KDL) gjatë periudhës raportuese ka mbajtur disa takime. Është vazhduar me llogaritjen e penaleve sipas vendimit të KDL-së (pjesa e përbërjes nga Agjencia) të datës 4 nëntor 2015 ku është vendosur që të zbatohen penalet ndaj kontraktorit për likuidimin e dëmeve të shkaktuara ndaj Agjencisë si pasojë e mos përfundimit të shqyrtimit dhe dërgimit tek pretenduesit të të gjitha kërkesave deri me datë 10 korrik 2015 ashtu si kërkohet edhe me kontratë (neni 17.1 faqe 19 Kushtet e Veçanta të Kontratës). Me këtë rast janë bërë llogaritjet ditore në lidhje me dëmet.
- Me 9 korrik 2016 ka përfunduar kontrata katër vjeçare me Kontraktorin për projektin me ç’rast kontraktori ka dorëzuar shërbimet dhe dokumentacionin përkatës sipas kërkesës së AKP-së ku përfshihen:
 - ✓ Konfirmimi lidhur me lëndët e mbetura për të përfaqësuar në DhPGJSK (afatet ligjore dhe informatat e tjera);
 - ✓ Konfirmim nga Kryesuesit e AL-ve që dosjet fizike dhe elektronike për secilën NSh janë të kompletuara tek zyrtarët e rastit të NSh-ve përkatëse;
 - ✓ Të gjitha faturat/kredit notat janë dorëzuar;
 - ✓ Listën e të gjitha kërkesave kreditore ende të pa vendosura nga AL-të;
 - ✓ Raport përmbledhës për periudhën kontraktuar 2012-2016.

- Të gjitha faturat e dorëzuara nga Kontraktori me rastin e përfundimit të kontratës dhe sipas marrëveshjes në mes të AKP-se dhe Koncorsiumi Deloitte-Tashko Pustina, janë kontrolluar dhe konfirmuar nga zyrat rajonale dhe stafi tjetër përgjegjës në DKL, dhe janë bere kërkesat për pagesë në DBF.
- Me datën 8 gusht 2016 është nënshkruar aneksi 2 i kontratës me për Projektin e Likuidimit të një portofolio të Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës, me ç'rast janë emëruar Kryesuesit dhe Anëtarët e AL-ve për të gjitha Ndërmarrjet për të cilat Kontraktori i ka sjellë në DKL propozimet (408 NSh), për 26 NSh për të cilat ka paqartësi nëse kanë asete ose jo, pritët që të bëhen emërimet në momentin kur të lartësohet lista me Departamentin e Koordinimit Rajonal;

Kontraktori ka vazhduar shqyrtimin e kërkesave si më poshtë:

Muaji	Vendimet
Janar 2016	8
Shkurt 2016	10
Mars 2016	10
Prill 2016	9
Maj 2016	8
Qershor 2016	79
Korrik 2016	54
Gusht 2016	19
Shtator 2016	40

*Sipas planit të punës të prezantuar nga kontraktori për vitin 2015 ishte e paraparë që shqyrtimi i kërkesave të kryhet deri me datë 10 korrik 2015, dhe si pasojë e rrethanave të ndryshme ka mbetur një numër i kërkesave pa u shqyrtuar të cilat vazhdojnë të shqyrtohen nga kontraktori edhe me aneks kontratën 2.

Fokusi kryesor aktual i kontraktorit është në përgatitjen dhe azhurnimin e:

- ✓ Raporteve Finale të Shpërndarjes,
- ✓ Raporteve të shpërndarjes së përkohshme,
- ✓ Listat e llogarive të arkëtueshme dhe procedurat e mbledhjes së tyre,
- ✓ Ballafaqimi me kërkesat e mbrojtjes pranë DHPGJSK,
- ✓ Çështjet e vazhdueshme në lidhje me NSh-të,
- ✓ Aty ku është e mundur procedimi i kërkesave të mbetura;

Statusi i tanishëm i kërkesave:

Përshkrimi	Gjithsej
Numri i përgjithshëm i kërkesave kreditore të dorëzuara në Agjenci që nga fillimi i procesit të likuidimit	89,899
Numri i kërkesave kreditore të vendosura nga Komisionet e Likuidimit - KL	5,986
Numri i kërkesave kreditore të vendosura nga kontraktori nga korriku 2012 deri maj 2016:	83,519
Numri i kërkesave kreditore të dorëzuara nga pretenduesit gjatë periudhës raportuese	244

Numri i vendimeve të dërguara palëve gjatë periudhës raportuese nga kontraktori	237
Numri i NSh-ve për të cilat ka filluar procesi i likuidimit gjatë periudhës raportuese	1
Numri i të gjitha NSh-ve për të cilët ka filluar procesi i likuidimit që nga fillimi i procesit	463
Vlera e fondeve për shpërndarje për të gjitha 103 raportet e shpërndarjes	€ 14,651,943.22
Paguar	€ 13,272,796
Në proces të pagesave	€ 1,329,854

NJËSIA PËR LIKUIDIMIN E NSh-VE NGA AKP-JA

- Është emëruar Autoriteti i Likuidimit për: GJI128 KB Agrokultura dhe PRZ030 NSh Ndërtimi, të njëjtat hyjnë në kategorinë e NSh-ve pa asete dhe/ose pa kërkesa kreditore dhe procesi i likuidimit të tyre do të përmbyllet nga Njësia për Likuidimin e NSh-ve nga AKP-ja;
- Pasi që ndaj PRZ030 NSh Ndërtimi gjatë procesit të likuidimit janë parashtruar kërkesa kreditore, AL-ja sipas procedurave ka dërguar njoftime për mungesë fondesh për kreditorët e kësaj NSh-je;
- Gjatë periudhës janar – shtator 2016 janë përfunduar raportet përfundimtare për: GJI130 KB Bibaj, GJI144 KB Xhafa, PEJ053 KB Vitomirica, PRZ051 NSh Shoqata Auto Moto dhe GJI143 KB Visoqa, të njëjtat sipas procedurave janë dërguar në Bordin e Drejtorëve për njoftim dhe pastaj në DhpGJSK për aprovim dhe lejm të mbylljes së procesit të likuidimit;
- Nga DhpGJSK-ja janë pranuar Aktvendimet pozitive për PEJ053 KB Vitomirica, PRZ051 NSh Shoqata Auto Moto, GJI130 KB Bibaj dhe GJI144 KB Xhafa me të cilat aprovohen raportet përfundimtare të NSh-ve/KB-ve të lartëpërmendura, pas kalimit të afatit 21 ditë të caktuar nga Dhoma për ankesa ndaj këtyre aktvendimeve janë dërguar njoftime për Institucionet relevante sipas kërkesave ligjore për tri NSh-të e para ndërsa për KB Xhafën aktvendimi është pranuar me datë 30 shtator 2016 kështu që duhet të pritët afati 21 ditë dhe pastaj sipas procedurave do dërgohen njoftimet;
- Pasi që ndaj PRZ051 NSh Shoqata Auto Moto janë parashtruar kërkesa gjatë procesit të likuidimit, sipas kërkesave ligjore brenda 5 ditëve u janë dërguar njoftime kreditorëve për lejimin e mbylljes së procesit të likuidimit të kësaj NSh-je nga ana e Dhomës;
- U janë dërguar shkresa AKK-së, ATK-së, DhpGJSK-së dhe komunave përkatëse të NSh-ve për konfirmim nëse kanë asete, ankesa, obligime tatimore dhe obligime të tatimit në pronë ndërmarrjet që janë pjesë e kësaj Njësie;
- Raporti përfundimtar për GJI143 KB Visoqa pas prezentimit në Bordin e Drejtorëve është dërguar në DhpGJSK për aprovim;
- Nga DhpGJSK është pranuar konfirmimi që ndaj PRZ030 NSh Ndërtimi ekziston një ankesë andaj për ta mundësuar përgatitjen e raportit përfundimtar AKP-ja ka kërkuar nga Dhoma të na e dërgoj një kopje të ankesës;
- Nga komuna Ferizaj është pranuar konfirmimi se GJI128 KB Agrokultura nuk ka obligime të tatimit në prone dhe për të njëjtën KB është pranuar konfirmimi nga AKK-ja se nuk ka prona të regjistruara në emër të saj.
- Është punuar në përgatitjen e raporteve përfundimtare të GJI128 KB Agrokultura, GJI157 NSh 16 Nëntori dhe GJI134 KB Gaçkë.

- Është punuar në lidhje me sigurimin e dokumentacionit të duhur në lidhje me përmbylljen e procesit të likuidimit për këto NSh nga kjo njësi.

Në këtë Njësi janë gjithsej 29 ndërmarrje prej të cilave për 11 ka përfunduar i tërë procesi i likuidimit me Aktvendime përkatëse të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, një KB është në Dhomë në pritje të aprovimit të raportit përfundimtar dhe 17 NSh janë ende në proces.

Nga kontraktori është përgatitur edhe një listë shtesë me emrat NSh-ve për të cilat pretendohet se janë pa asete dhe ose pa kërkesa kreditore dhe/ ose asetet e të cilave nuk janë të regjistruara në emër të tyre. Kjo listë do të jetë subjekt i riverifikimit të aseteve para se të dorëzohen për të u likuiduar nga kjo njësi e AKP-së.

NJËSIA PËR LISTAT E PUNËTORËVE PËR 20%

Shpërndarja e 20% për periudhën janar – shtator 2016

Gjatë periudhës raportuese janar - shtator 2016, është bërë shpërndarja e pjesës së 20% për punëtorët e kualifikueshëm të 78 NSh-ve në shumë të përgjithshme prej € 4,363,487, kurse kanë përfituar nga shpërndarja e fondeve të 20% gjithsej 7,987 punëtorë.

5.6. NJËSIA E RIORGANIZIMIT DHE ADMINISTRIMI I NSH-VE

Pas ndryshimit të fundit të Ligjit të Riorganizimit të Ndërmarrjeve të Veçanta afati për dorëzimi e planit të riorganizimit është shtyrë deri me 02 nëntor 2016, NjRT gjatë gjithë kësaj periudhe ka koordinuar dhe mbikëqyr proceset e nevojshme për riorganizim në kuadër të përgatitjes së Planit riorganizimit të Trepçës. Një ndër hapa konkret dhe më të rëndësishëm në këtë aspekt është angazhimi i Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për të realizuar Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj, dokument i cili do jetë bazë për përpilim e planit të riorganizimit.

NjRT, përveç punëve në planin e riorganizimit të ndërmarrjes gjatë periudhës raportuese ka mbikëqyr punët e përditshme në Trepçë (posaçërisht në PIM). Objektivi kryesor i mbikëqyrjes të afarizmit të ndërmarrjes është ruajtja dhe shtimi i vlerës së ndërmarrjes, dhe përgatitja e saj për riorganizim, e që synohet të realizohet përmes veprimeve në vijim:

- Përkujdesja për rritje të prodhimit, rritjen e të hyrave nga shërbimet tjera dhe qiratë,
- Përkujdesja për zvogëlim të dalave/ulje të kostos,
- Sigurimi i takimeve dhe asistimi i takimeve me palët e treta,
- Themelimi dhe pjesëmarrja në komisione me interes të veçantë.

Për këtë mbikëqyrje NjRT raporton rregullisht Menaxhmentit dhe ka përcaktuar edhe mënyrat e komunikimit dhe raportimit ndërmjet AKP-së dhe Menaxhmentit të Trepçës. Vlen të theksohet se kërkesat e shumta për mbikëqyrje në Trepçë me specifika të veçanta teknike në fusha të ndryshme, kanë kërkuar angazhim të shtuar.

Mbikëqyren shumë procese, por do të ndajmë ato më të rëndësishmet:

- Mbikëqyrja e procedurave të shitjes së Koncentratit të Trepçës,
- Mbikëqyrja e procedurave të prokurimit që tejkalon vlerën 10,000 Euro,
- Asistimi i Trepçës dhe angazhimi në kontestet Gjyqësore të saj, si dhe
- Luajtjen e rolit të urës ndërmjetësuese, apo kanalit komunikues ndërmjet Dhomës së Posaçme, AKP-së dhe Trepçës. NjRT gjatë periudhës raportuese ka dorëzuar raportet e rregullta tremujore në DhPGJS, si dhe të gjitha kërkesat, udhëzimet për veprim, dhe komunikimin e natyrave tjera, të

dorëzuara në DhPGjS, të cilat janë iniciuar dhe proceduar nga NjRT, dhe të cilat janë realizuar në bashkëpunim me Trepçën dhe Departamentet gjegjëse të AKP-së.

Në këtë aspekt NjRT ka mbikëqyrë procedurat e shitjes së Koncentratit të Trepçës, procedurat e prokurimit që tejkalojnë vlerën 10,000 Euro të financuara nga mjetet vetanake të Trepçës, duke ndihmuar Trepçën në të gjitha fushat operative të saj, si dhe është angazhuar në kontestet Gjyqësore të saj, etj. Në përgjithësi, NjRT është munduar që me të gjitha kapacitetet që zotëron të mbikëqyr për së afërmi afarizmin e ndërmarrjes. Gjithashtu NjRT në bashkëpunim me Doganat ka kontrolluar sasitë e eksportuara të xehes, nëse të njëjtat janë sipas sasive të miratuara nga AKP.

Në mënyrë që të ilustrojmë aktivitetin primar të Trepçës - e që është nxjerrja dhe përpunimi i xehes, më poshtë mund të shihet raporti i prodhimit për periudhën 1 janar - 31 gusht (meqenëse raportet për muajin shtator ende nuk janë dorëzuar), 2016 të cilin e kanë raportuar Menaxhmenti Mitrovicë dhe Menaxhmenti Zveçan i "Trepca - Ndërmarrje në Administrim të AKP".

Për periudhën 1 janar - 31 gusht, 2016 është realizuar eksploatimin i 240,768 ton xehe të Plumbit dhe Zinkut nga katër minierat. Kjo sasi e prodhuar e koncentratit për këtë periudhë, është më e lartë se prodhimi i vitit të kaluar 2015 për të njëjtën periudhë kohore, kjo ka rezultuar me prodhim shtesë të koncentratit Pb dhe Zn në Flotacionet e Tunelit të Parë, Kizhnicës dhe Leposaviçit.

Periudha	Sasia eksploatuar e xehes Pb & Zn (ton) në minierat Stantërg dhe Artanë	Sasia eksploatuar e xehes Pb & Zn (ton) në minierat Belo Bërdo dhe Cërnac	Gjithsej sasia e eksploatuara e xehes së Pb & Zn (ton)
Janar - Gusht 2016	126,588	114,180	240,768
Pjesëmarrja në % i prodhimit të përgjithshëm të konc.	52.58%	47.42%	100%

Shqetësimet e AKP lidhur me përmbushjen e detyrave në cilësinë e Administratorit të Trepçës

Meqenëse, kontrata me Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për realizim të Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj është nënshkruar në fund të muajit shtator 2016, kontratë e cili planifikohet të përmbushet në shkurt të vitit 2017, shqetësimet janë se edhe në skenarion më të mirë të mundshme, nuk do kemi kohë të mjaftueshme për të kryer punët e domosdoshme për përpilim të Planit të Riorganizimit. Do të thotë se Agjencia do ta ketë të pamundur të realizojë detyrën e vet në cilësinë e Administratorit për dorëzim të Planit të Riorganizimit në kohë, brenda afatit ligjor të paraparë (02/11/2016). Andaj, NjRT ka pas obligim të njoftojë dhe alarmojë për seriozitetin e situatës, e cila nëse nuk ka zgjidhje të shpejtë, mund ta shpijë Trepçën në situatë të ngjashme me atë të vitit të kaluar. Kjo ka ndikuar që të merren masa nga Qeveria e cila ka proceduar në kuvend Ligjin e ri për Trepçën, i cili edhe është miratuar nga kuvendi (kjo ngjarje ka ndodhura pas periudhës raportues e këtij dokumenti).

Për sa i përket zhvillimit të Operacioneve të përditshme në Trepçë, të gjitha informatat për udhëzimet e dhëna dhe kërkesat e vërejtjet për masën e implementimit të këtyre udhëzimeve i janë raportuar rregullisht tek Bordit Drejtorëve të AKP-së.

5.7. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL

Departamenti i Koordinimit Rajonal bën mbikëqyrjen dhe Koordinimin e punës së Zyrove Rajonale të AKP-së. AKP-ja ka pesë Zyra Rajonale (ZR) në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiilan dhe Mitrovicë që përfshin të gjithë territorin e Kosovës dhe dy zyre satelitore në Leposaviq dhe Shtërpce, të cilat përgjegjësi kryesore kanë grumbullimin e informative lidhur me NSh-të në rajonet përkatëse si dhe implementimin e privatizimit, likuidimit dhe aktivitetet e qeverisjes korporative.

Janë finalizuar dokumentet për SHAL 27 dhe SHAL 28 kurse zyret rajonale kane vazhduar me vizitat në teren si dhe përgatitje e dokumenteve për SHAL 29 dhe po ashtu SHAL 30.

TRAJTIMI I ASETEVE TË UZURPUARA

Lidhur me trajtimin e aseteve të uzurpuara të dhënat janë paraqitur në Përmbledhjen Ekzekutive.

Si rezultat i aktiviteve të shtuara dhe veprimeve të ndërmarra për lirin e aseteve të uzurpuara dhe aktiviteve të shtuara në kontekst të administrimit të Aseteve, ka pasur ngritje të jashtëzakonshme në inkasimi i qirave në llogaritë bankare të Ndermarrjeve shoqërore në tranzicion dhe likuidim në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2014.

Përcaktimi Statusit të NSh-ve

Gjatë këtij viti janë procesuar format e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit (SDR) për Asetet e NSh-ve me seli jashtë Kosovës të cilat janë identifikuar gjatë vitit, për shqyrtim nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Përcaktimin e Statusit të NSh-ve.

Qiradhenja e Pronave të NSh-ve në Likuidim

Zyret rajonale kanë përgatit dhe kanë marr aprovim nga kryesuesit e AL-ve dhe menaxhmentit, për qiradhënie të pronave të NSh-ve në përputhje me Rregulloren e Qiradhënjes, dhe janë bërë shpalljet për qiradhënie më 01 qershor 2016, ku janë përfshirë gjithësej 91 asete si dhe janë përgatitur listat për qiradhenje që do të shpallen në muajin tetor 2016.

Punë të Tjera

- Zyret rajonale poashtu kanë përgatitur listën e shitjeve përmes privatizimit dhe likuidimit, listë kjo që përfshin të dhënat në lidhje me të gjitha shtitjet që kanë ndodhur si në AKP po ashtu edhe nga themelimi i AKM-së. Kjo list përbënë informatat në lidhje me blerësit por edhe identifikimin e uzurpatorëve në momentin e shitjes së ndërmarrjeve të reja/aseteve.
- Gjatë kësaj periudhe janë përgaditur dhe publikuar në faqen e internetit të AKP-së edhe:
 - Lista e Aseteve të Pashitura
 - Lista e Qirave Aktive dhe
 - Lista e Uzurpatorëve dhe shfrytëzuesëve të jashtëligjshëm
- Sipas kërkesës së Bordit të Drejtorëve është përgatitur nga Grupi Punues ku pjesë e grupit kanë qenë edhe zyrtarët e DKR, për unifikimin e Rregullores së unifikuar për qiradhënie, pra Rregulloret ekzistuese për qiradhënie të aseteve janë përfshirë në një Rregullore të vetme dhe aty janë vendosur edhe dispozitat e nevojshme për asetet e NSh-ve, në likuidim dhe nën administrim direkt si dhe Udhëzuesin për Trajtimin e Aseteve të Uzurpuara po ashtu edhe në modifikimin e kësaj rregullore kanë qenë të përfshir zyrtarët e DKR.

- Zyrtaret e rastit kanë vazhduar punën me përgatitjen e vendimeve të lëshuara nga AL, regjistrimin e kërkesave të reja në databazë, verifikimin e të gjitha kërkesave të regjistruara në databazë, skanimet e tyre, rregullimet e arkivave si dhe insertimin e dokumentet në databazë.
- Zyret rajonale kanë vazhduar me takime të ndryshme me menaxhmente të NSH-ve, zyrtar të lartë komunal, palë të ndryshme, vizita në teren po ashtu zyrtaret ligjor kanë marr pjesë në përfaqësime në gjykata, ushtrimin e padive, ushtrimin e ankesave, ushtrimin e përgjigjeve në ankesa, ushtrimin e përgjigjeve në padi dhe të parashtrësive tjera drejtuar gjykatave, etj.

5.8. DEPARTAMENTI I FINANCE DHE BUXHETIT

Departamenti i Financave dhe Buxhetit ofron shërbime financiare për Agjencinë: Divizionin e Shitjes, Divizionin e Likuidimit, degën Ekzekutive, Zyrtat Rajonale dhe Departamentet/Njësitetë përkatëse të Agjencisë.

Departamenti i Financave dhe Buxhetit kontribuon duke ofruar përkrahje profesionale në zbatimin e procedurave të mirëfillta financiare, operimin e duhur të sistemeve financiare dhe praktikave më të mira sipas standardeve vendore dhe ndërkombëtare.

Departamenti i Financave dhe Buxhetit në kuadër të Agjencisë mbulon dy aktivitete të menaxhimit financiar:

1. Buxhetin për: aktivitetet administrative dhe operative të Agjencisë dhe aktivitete të tjera nën administrim të saj; dhe
2. Fondet në mirëbesim të Ndërmarrjeve Shoqërore.

1. AKTIVITETET NGA BUXHETI I AGJENCISË

1.1 PASQYRAT FINANCIARE

- Pasqyrat financiare 9 mujore për Buxhetin e Agjencisë nga të Hyrat e dedikuara dhe Granti Qeveritar për periudhën Janar – Shtator 2016 janë përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe Sekretariatit e Bordit të Drejtorëve.

1.2 BUXHETI

Burim kryesor i financimit për aktivitetet e Agjencisë për periudhën Janar – Shtator 2016 janë të **Hytrat e Dedikuara**⁸ dhe **Fondi i Përgjithshëm Qeveritar**⁹. Agjencia gjatë kësaj periudhe nuk ka përfituar financime nga Grandet e Donatorëve apo pagesa që janë realizuar nga palët e treta në të mirë të Agjencisë.

Departamenti i Financave dhe Buxhetit gjatë kësaj periudhe sa i përket buxhetit ka përfshirë aktivitetet e mëposhtme:

- Monitorimi i performancës së buxhetit 2016;
- Korniza afatmesme e shpenzimeve 2017 - 2019; dhe
- Përgatitja e buxhetit për vitin 2017 dhe parashikimet e hershme 2018 – 2019.

⁸ Shih nenin 21 të ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit si dhe nenin 64 të ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë.

⁹ Fondi i përgjithshëm Qeveritar apo Granti Qeveritar janë burim i financimit për të mbuluar aktivitetet që nuk ndërlidhen në mënyrë direkte për Agjencinë, por janë për mbulimin e shpenzimeve që Agjencia administron e që kanë të bëjnë me riorganizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore e në këtë rast është vetëm Riorganizimi i NSH Trepça. Fondi i përgjithshëm qeveritar është fondi kryesor i Republikës së Kosovës për financimin e buxheteve të organizatave buxhetore.

1.2.1. Performanca e Buxhetit për periudhën Janar – Shtator 2016

Përformanca e buxhetit gjatë periudhës raportuese ka përfshirë monitorimin dhe implementimin e buxhetit të Agjencisë si dhe aktivitetet e kërkesave për kurse, transfere dhe nevoja shtesë për programet buxhetore gjatë procesit të rishikimit gjysmë vjetor.

	A	C	C/A
Përshkrimi	Buxheti më 31 Dhjetor 2016	Shpenzimet	Realizimi në %
Gjithsej	8,965,168	4,616,287	51%
Te hyrat e dedikuara	7,149,129	4,606,872	64%
Te hyrat Qeveritare	1,816,039	9,415	1%

Rishikimi i buxhetit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për vitin 2016 (LIGJI Nr. 05/L -109)

Për të pasur një planifikim sa më të mirë të buxhetit dhe shpenzimeve, nga Ministria e Financave është kërkuar aprovimi i transfereve në mes programeve buxhetore në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime.

Me miratimin e Ligjit të Rishikimit nga Qeveria (LIGJI Nr. 05/L -109), transferet e kërkuara janë aprovuar ashtu siç kemi kërkuar.

Tabela e transfereve në mes programeve buxhetore të aprovuara sipas Ligjit Nr. 05/L109

Programet Buxhetore – Mallra dhe Shërbime	Buxheti fillestar i aprovuar 2016	Shuma e transferit	Buxheti pas transfereve
Likuidimi	654,045	(150,000)	504,045
Departamenti Ligjor	30,000	20,000	50,000
Administrata Qendrore	1,314,200	130,000	1,444,200

1.2.2 Korniza afatmesme e shpenzimeve

Sipas kërkesës së Ministrisë së Financave lidhur përgatitjen e Kornizës Afat-Mesme të Shpenzimeve (KASH), AKP me datën 29 Mars 2016 ka përgatitur dhe dorëzuar në MF përmbledhjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të AKP-së për vitet 2017-2019 si më poshtë:

KASH	2017	2018	2019
Gjithsej	7,115,458	6,887,320	6,824,181
Te hyrat e dedikuara	7,015,458	6,787,320	6,724,181
Te hyrat Qeveritare	100,000	100,000	100,000

1.2.3 Kërkesa buxhetore 2017 dhe parashikimet e hershme 2018 - 2019

Me datën 20 Qershor 2016 sipas afatit të caktuar në Qarkoren 2017/1, në Departamentin e buxhetit pranë MF kemi dërguar Kërkesën Buxhetore për vitin 2017 si dhe vlerësimet 2018-2019.

Gjithsej shuma e kërkesës buxhetore për vitin 2017 është € 10,140,333.

- Kërkesa brenda kufijve buxhetor të përcaktuar në Qarkoren 2017/1, shuma prej EUR 6,823,657 si dhe;
- Kërkesa shtesë mbi kufijtë buxhetor të përcaktuar në Qarkoren 2017/1, shuma prej €3,316,676.

1.3 PROCESIMI I PAGESAVE

- Procesimi i 2,553 transaksioneve (1,222 zotime dhe 1,331 pagesa) nga buxhetit vjetor i AKP-së e cila financohet nga të hyrave të dedikuara të Agjencisë dhe fondit të përgjithshëm të Qeverisë (për Trepçën).

1.4 RAPORTIMET

- Harmonizimi i raporteve dhe raportimi në baza mujore i raporteve financiare për pasqyrat financiare 2016 ndaj;
 - Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave;
 - Menaxhmentit dhe mbajtësve të Buxhetit;
 - Publikimi i raporteve në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë në gjuhën shqip, serbisht dhe anglisht;
- Raportimet mujore në Ministrinë e Financave për faturat e papaguara;
- Raporti i blerjeve mbi EUR 500.00 për vitin 2015 ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.

1.5 AKTIVITETET TJERA

- Harmonizimi mujor i listës së pagave për periudhën Janar – Shtator 2016 me Ministrinë e Administratës Publike;
- Inkasimet ditore për telefoninë fikse dhe mobile. Këto inkasime janë për shpenzimet që kanë tejkaluar limitet të cilat i mbulon Agjencia sipas politikave për telefoni fikse dhe mobile. Vlen të theksohet se pas propozimit nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit është marrë vendim nga Menaxhmenti për ndalesë në 50% të pagës bruto për obligimet e papaguara deri në periudhën 31 Dhjetor 2015;

1.6 PASURITË

Pasuritë e Agjencisë të blera nga fondet e buxhetit dhe pasuritë e dhëna donacion janë mbajtur në përputhje me Rregulloren nr. 02/2013 të Ministrisë së Financave. Detaje lidhur me pasuritë janë shpalosur në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese.

2. FONDET NË MIRËBESIM

2.1 PASQYRAT FINANCIARE

- Pasqyrat financiare 9 mujore për Fondet në Mirëbesim për periudhën Janar – Shtator 2016 janë përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe Sekretariatit e Bordit të Drejtorëve.

2.2 BUXHETI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE I CILI FINANCOHET NGA FONDET NË MIRËBESIM

Buxhet për Fondet në mirëbesim është për ndërmarrjet shoqërore të cilat hyjnë në likuidim. Janë gjithsej 463 Ndërmarrje Shoqërore të cilat kanë hyrë në likuidim. Buxheti përfshinë periudhën që nga hyrja e Ndërmarrjes në likuidim e deri në përfundim të saj.

Buxheti i NSh-ve i shpenzuar deri më 30 Shtator 2016

Buxheti	GJITHSEJ SHPENZIMET	Buxheti i mbetur	% e shpenzimeve
18,143,879	6,864,311	11,279,568	37.83

2.3 PROCESIMI I PAGESAVE

- Procesimi dhe harmonizimi i 27,455 transaksioneve (hyrëse dhe dalëse) nga fondet në mirëbesim.

2.4 RAPORTIMET

- Harmonizimi me Bankën Qendrore të Kosovës dhe raportimet në baza mujore të raporteve për pasqyrat financiare për Fondet në Mirëbesim ndaj:
 - Menaxhmentit dhe Drejtorëve;
 - Zyrrave Rajonale dhe Autoritetit të Likuidimit - Raporteve Përmbledhëse të Llogarive të Likuidimit dhe Kartelave bankare. Raportimi në baza mujore përfshinë periudhën Janar deri më 30 Shtator 2016. Raportet janë paraqitur dhe në ueb-faqen e AKP-së (në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze); dhe
 - Publikimi i raporteve në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë në gjuhët: shqipe, serbe dhe angleze.

2.5 DETAJE TJERA LIDHUR ME AKTIVITETET FINANCIARE TË AGJENCISË

Detaje tjera lidhur me aktivitetet financiare të Agjencisë janë shpalosur në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Buxhetit Vjetor dhe në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim.

5.9. DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor (tutje DL) ofron shërbime ligjore për aktivitetet e Agjencisë përfshirë privatizimin, likuidimin, prokurimin dhe rastet specifike të Trepçës.

Departamenti është ndarë në njësi punuese të organizimit, ndarjes së punëve dhe përgjegjësi me qëllim të realizimit në mënyrë efikase dhe efektive në tërësi të objektivave dhe përgjegjësi të Departamentit Ligjor dhe të cilat janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e përgjithshme të AKP-së.

Në vijim janë sqaruar aktivitetet bazuar në sipas njësive në Departamentin Ligjor:

1. Njësia për Përfaqësime në Gjykatë(NjPGj).
2. Njësia për Opinione Ligjore(NjOL).
3. Njësia për Regjistrimin e Ankesave (NjRA).
4. Sekretariati i KSHALP-së: Për shqyrtimin e ankesave për 20 %.
5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KShALP).

Departamenti Ligjor shërben si ombrellë për Komisionin Shqyrtues për Ankesat e Listave të Punëtorëve (KShALP), megjithëse ky komision vepron në mënyrë autonome dhe i raporton vetëm Bordit të Drejtorëve të Agjencisë.

1. Njësia për Çështjet Gjyqësore

Informatat për periudhën raportuese:

Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar: 1035

Veprimet procedurale të ndërmarra në lëndë: Mbrojtje në padi 890, Kundërpërgjigje 208, Përgjigje në masë të përkohshme 15, Ankesë 27, Përgjigje në ankesë 52, Parashtresë 36, Padi 2, Seanca Gjyqësore 60, Përgjigje në urdhër 73, Aktvendim 50, Aktgjykim 30.

Raporti i lëndëve dhe veprimeve procedurale të ndërmarra nga njësia e përfaqësimeve gjyqësore, në çështjet lidhur me listat e punëtorëve:

Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar: 373

Veprimet procedurale të ndërmarra në lëndë: Përgjigje në urdhër 38, Pjesëmarrje në seancë gjyqësore 9, Ankesa 69, Aktgjykim 101, Përgjigje në ankesë 13, Parashtresa 77, Aktvendim 59, Vërejtje për pagim të taksave gjyqësore 16.

2. Raporti i Sekretariatit dhe KSHALP-së

I. Sekretariati i KSHALP-së

1. Për këtë periudhë Sekretariati i KSHALP-së ka punuar rreth shqyrtimit të ankesave dhe çështjeve tjera relevante për ndërmarrjet e poshtë shënuara:

2. Shqyrtimi i ankesave të pas afatshme për NSH-të si në vijim:

NSH “Liria” Prizren/ZR Prishtinë; NSH “Ratar” Llapnasellë; NSH “Urata/Voqar”; NSH “Produkti” – Mitrovicë; NSH “Theranda” - Therandë; NSH “Trasing” - Prishtinë; NSH “IBG Fabrika e Baterive” - Gjilan; NSH “Fabrika e gypave” - Ferizaj; NSH “Gërmija” - Prishtinë; NSH “Morava e Binqes” - Gjilan; NSH “Progres” - Prizren; NSH “Fazita” - Prishtinë; NSH “Bankkos” – Prishtinë; NSH “Inxhineringu” - Prishtinë; NSH “Integj” - Gjilan; NSH “Fabrika e veglave” – Ferizaj.

II. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KSHALP).

1. Takimet me palë për sqarim për mospërfshirjen e tyre në listat finale lidhur me 20%.

3. Njësia e Opinioneve Ligjore

Njësia e Opinioneve Ligjore (NJOL) ka zhvilluar aktivitete të ndryshme, por që kryesisht konsistojnë në dhënien e mendimeve dhe këshillave ligjore, hartimin e dokumenteve juridike rregullore apo akte tjera juridike) si dhe pjesëmarrjen në takimet e ndryshme.

Përmbledhja e aktiviteve të NJOL gjatë periudhës raportuese, është paraqitur më poshtë:

- Opinione Ligjore të kërkuara me Kërkesë për Veprim apo nga Menaxhmenti 18
- Hartimi, shqyrtimi apo analizimi i dokumenteve të ndryshme 74
- Takimet në të cilat është kërkuar pjesëmarrja e zyrtarëve ligjorë..... 98

4. Njësia për Regjistrimin e Kërkesave (NJRK)

Gjatë këtij muaji në Njësinë për ankesa e Departamentit Ligjor janë regjistruar dhe proceduar gjithsejtë 2.793 parashtresa, prej tyre 999 kërkesa/lëndë të reja dhe 1.794 dokumente/ parashtresa shtesë lidhur me lëndët e regjistruara me herët.

7 Njoftime për iniciimin e procedurës gjyqësore ne baze te nenit 29 dhe 30 të Ligjit të AKP-së.

1498 Kërkesa lidhur me likuidimin ose ndaj NSH-ve në likuidim. Gjithashtu 222 lende gjyqësore nga DHPGJSK janë dorëzuar tek AL pranë ZR.

Rreth 42.877 fletë janë fotokopjuar lidhur me parashtesat e lëndëve të Njesisë së përfaqësimeve, për dorëzim në gjykatë.

5.060 Dokumente nga kopjet fizike të lëndëve të ndryshme janë radhitur sipas regjistrimit në sistem.

1.167 parashtresa me kopje të mjaftueshme janë dorëzuar për gjykatë në zyrën e protokollit.

2.825 fajllime lidhur me lëndët gjyqësore të Njesisë së përfaqësimeve dhe parashtresa te ndryshme, te cilat janë dorëzuar tek zyrtaret kompetent.

6.141 Aktivitete tjera në ndihmë të njësive dhe departamenteve tjera të Agjencisë.

5.10. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i Administratës ka për detyrë të ofroj kushte sa më të mira njerëzore, infrastrukturore dhe logjistike për arritjen e objektivave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në kuadër të Departamentit të Administratës bëjnë pjesë këto njësi: Njësia e Burimeve Njerëzore, Njësia e Përkthimeve, Njësia e Protokollit, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Arkivit, Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme dhe Zyra e Transportit.

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë periudhës raportuese në Njësinë e Burimeve Njerëzore janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

PAGAT:

- Është përgatitur dhe dërguar për ekzekutim në baza mujore Lista e Pagave (Payrollit) për muajt Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht dhe Shtator 2016.

REKRUTIMET DHE FLUKTUIMET E STAFIT:

- Me vendim të Bordit të Drejtorëve janë emëruar:
 - Drejtori Menaxhues;
 - Zëvendësdrejtor Menaxhues – shitje;
 - Zëvendësdrejtor Menaxhues – likuidimi;
- Ka përfunduar procesi i rekrutimit për pozitën:
 - Pastruese;
- Në proces rekrutimi për:
 - Zyrtar Kadastral ZR Mitrovicë dhe ZR Gjilan;
 - Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për pozitën: Avokat për Përfaqësime Gjyqësore;
- Gjatë kësaj periudhe:
 - Janë pensionuar dy (2) zyrtarë të AKP-së;
 - Kanë dhënë dorëheqje dy (2) zyrtarë të AKP-së;
 - Me vendim të Bordit të Drejtorëve është shkarkuar Zëvendësdrejtori Menaxhues – likuidimi;
 - I është shqiptuar masa e pezullimit parandalues dy (2) zyrtarëve të AKP-së;
 - Gjashtë (6) zyrtarë të AKP-së në shfrytëzim të pjesës së parë të pushimit të lehonisë;
 - Dy (2) zyrtarë në shfrytëzim të pezullimit të dakorduar/ pushim pa pagesë;
 - Një (1) zyrtare në shfrytëzim të pushimit mjekësor pa pagesë;
 - Dy (2) zyrtarë janë transferuar në mënyrë të përhershme;

- Tre (3) zyrtarë janë transferuar në mënyrë të përkohshme;
- Dy (2) zyrtarëve i është vazhduar transferi i përkohshëm;
- Një (1) zyrtarë është caktuar ushtrues detyre;
- Një (1) zyrtarë është kthyer në pozitën paraprake sipas Aktit të Emërimit;
- Një (1) zyrtarë është emëruar në KShBNSh;
- Janë vazhduar kontratat edhe për 1 vit për 4 pozitës;

RAPORTET:

- Është finalizuar raporti i planit të trajnimeve të Menaxhmenti i AKP-së dhe raporti për vlerësim të performancës;
- Raporte mbi vlerësimin e aktiviteve zhvillimore;

TRAJNIMET:

Koordinimi i pjesëmarrjes në Trajnimet/ programet certifikuese për 52 zyrtarë:

- Provim të Jurisprudencës për tre (3) zyrtarë;
- E-prokurimin për nëntë (9) zyrtarë;
- Marrëdhëniet me publikun për një (1) zyrtar;
- Komunikimi qeveritar me publikun për një (1) zyrtar;
- Ankimimi dhe çështjet e disiplinës ofruar për dy (2) zyrtarë;
- Korniza e Përbashkët e Vetëvlerësimit (KPV)/ Common Assessment Framework (CAF) për pesë (5) zyrtarë;
- Sistemi i SIMBNJ për një (1) zyrtar;
- Advanced Corporate Financial Planning për njëmbëdhjetë (11) zyrtarë;
- Infographics Design & Data Visualization për një (1) zyrtar;
- Auditimi i brendshëm dhe siguria për dy (2) zyrtarë;
- Social Media Management për pesë (5) zyrtarë;
- Procedurat Administrative për gjashtë (6) zyrtarë;
- Teknik i Kontabilitetit (Niveli I-rë) për dy (2) zyrtarë;
- Praktikat Juridike për tre (3) zyrtarë.

ÇËSHTJE TJERA:

- Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka shqyrtuar shtatë (7) ankesa;
- Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar dhe ka marr vendim për katër (4) raste;
- AKP është njoftuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për marrje të vendimit për shtatë (7) raste;
- Agjencia kundër Korrupsion është njoftuar për anëtarët e ri të Bordit të Drejtorëve si dhe për listën finale të Zyrtarëve të Lartë Publik;
- Është ri –dërguar në Ministri të Administratës Publike kërkesa për opinion ligjor për njohje të stazhit të veteranit të luftës;
- Koordinim i kryerjes së punës praktike të praktikantëve në kooperim me projektin AFAS.

NJËSITË TJERA TË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS

Aktivitetet kryesore për këtë periudhë të raportimit paraqiten për njësitë: **Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme, Njësia e Arkivit, Njësia e Përkthimeve, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Protokollit dhe Zyra e Transportit.**

Njësia e Përkthimeve:

Njësia e Përkthimeve ka përkthyer **709 dokumente me 4,613 faqe** dhe ka siguruar përkthyesit për **19 takime**.

Njësia e Protokollit:

Gjate kësaj periudhe janë pranuar procesuar:

- Dokumente hyrëse në këtë zyre 3945 shkresa;
- Shkresa dalëse nga kjo zyre janë regjistruar 3288;
- Të regjistruara në sistem hyrje/dalje janë 7233;
- Të skanuara 7233;
- Pranimi me Postë 605;
- Dërgimi me Postë 1366;
- Dërgimi me Libër Personal brenda AKP-së 3945;
- Dërgimi me Libër jashtë AKP-së 106;

Njësia e Teknologjisë Informative:

- Viti 2016 është karakterizuar me një **stabilitet të qëndrueshëm të sistemit** që nuk e kemi pas asnjë vit tjetër. Duke marrë parasysh që roli i TI-së është në ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme elektronike, Njësiti i TI-së ka ndërmarr shumë masa parandaluese të cilat kanë rezultuar në shërbime kualitative të pa-ndërprera. Përveç 2-3 intervenimeve në sistem të rezultuara me prishje të ndonjë pajisje të rrjetit (me doëntime rreth gjysmë ore), gjatë vitit 2016 nuk është paraqit ndonjë problem serioz rreth funksionimit të sistemit. Përveç kujdesit të përgjithshëm janë këto pika specifike që kanë rezultuar në funksionimin optimal. Duhet cekur që në vitin 2016 është rritur edhe kujdesi i zyrtarëve rreth bontonit të përdorimit të internetit. Shumë rrallë ka ndodhë që për shkak të përdorimit joadekuat të shkarkohen viruse të cilat janë detektuar nga **Sophos Management Console** (Menaxhmenti i antivirus sistemit). Njësia e TI-së ka tërhequr vërejtje secilit përdorues mbi kujdesin gjatë përdorimit të internetit e sidomos të USB-Flash drajvave;
- **Avancimi i Backup-sistemit** në nga LTO5 në LTO 6 që do të mundësojë menaxhimin e backup-ave në mënyrë më të lehtë. I planifikuar në planin e prokurimit por i nxituar me urgjencë për shkak disa problemeve me pajisjen e vjetër të LTO5 gjatë periudhës Prill-Maj 2016;
- **Ri-dizajnimi i rrymës në server room**- instalimi i 3 siguresave të cilat ndihmojnë në identifikimin më të lehtë kur ka probleme me rrymë në server room. (Maj 2016);
- **Zëvendësimi i baterive në server room**. Ndërrimi i baterive që furnizojnë UPS e mëdhenj në server room. Në këtë mënyrë është siguruar kontinuiteti i server romit në kohë më të zgjatur para sezonit dimëror ku priten ndërprerje të energjisë elektrike të cilat gjithmonë shkaktojnë telashe pajisjeve elektronike. (shtator 2016);
- **Të gjitha planifikimet e prokurimit të TI-së për vitin 2016 janë përmbushur**. Furnizimi me pajisje të TI-së për klientë është afër përfundimit, po ashtu është kontrata për “Shërbime të Fotokopjimit dhe Printimit” është afër finalizimit. Procedurat e tenderit janë iniciuar me sukses dhe është përmbush plani vjetor i lidhur me blerjen e shërbimeve apo pajisjeve të TI-së;
- **Zëvendësimi i HDD të vjetër** – Të gjithë HDD e vjetër janë zëvendësuar me HDD të rinj dhe është minimizuar në shkallë të lartë rreziku i humbjes së shënimeve në kompjuterët e zyrtarëve. Kjo është dëshmuar e suksesshme sepse në vitin e 2016 nuk është paraqitur prishje fizike e HDD (përveç dëmtimeve direkte fizike);
- **Monitorimi i shenjave të diskut**- përmes programit të integruar **Spiceeorks** ne kontrollojmë në baza javore nëse ndonjë disk të zyrtarëve ka filluar të degradohet. Momentin që shohim se disku tregon shenjat e para që po fillon me u prish, ne iniciojmë ndërrimin në kohën e përshtatshme me zyrtarin. Me këtë metodë shumë probleme janë evituar;
- Sfida që do përpiqemi t’i evitojmë mbeten si më poshtë:

- Është e nevojshme të sistemi i mbrojtjes nga sulmet kibernetike të avancohet duke marrë parasysh që MICROSOFT TMG 2010 fireëëalli që përdorim ne, nuk përkrahet më as nga Microsoft sepse konsiderohet si LEGACY device (pajisje e vjetërsuar). Avancimi i fireëëallit në 3rd Generation fireëëall do të mundësonte një kontroll më të mirë të internetit dhe mbrojtjes nga sulmet kibernetike;
- Njësitë e TI-së përdorë edhe forma tjera të Backupit përveç offline backup në tape. Backup2Disk sistemi i cili përdoret nga AKP që nga viti 2012 është i vjetër nuk ka kapacitet për të ruajtur shumë backup-a për shkak se sasia e shënimeve të AKP-së që nga ajo kohë është rritur shumë (3x më shumë se 2012). Është e dëshirueshme blerja e kësaj pajisje e cila do të mundësonte online backup më të menaxhueshëm nga administratori i TI-së, duke rritur frekuencën e backupit dhe efikasitetin e backup-it (shpejtësinë e backupit);
- Përpilimi i strategjisë për ruajtjen e arkivave të e-mailave të cilat gjenden në kompjuterët lokal, me qëllim të backupit në rast të dështimit eventual të Diskut ende mbetë sfidë. Për momentin është e pamundur që të gjithë e-mail arkivat të qëndrojnë në server, andaj për të minimizuar humbjet eventuale nga fatkeqësitë harduerike (prishjet e HDD) është e nevojshme që të ballafaqohemi me këtë risk mesatar. Ne kemi filluar integrimin e softuerit që krijon kopje të arkivës në server në mënyrë automatike. Po ky sistem kërkon kohë për implementim.

Njësia e Arkivit:

- Regjistratorë të skanuar, regjistruar dhe arkivuar për Departamentet dhe Njësitë e AKP-së, gjithsej 415 regjistratorë;
- utja e të dhënave në softuerin e Arkivit për 415 regjistratorët e skanuar;
- Ofrim i ekzaminimit të dokumentacionit arkivor, Departamenteve/Njësitë/Regjioneve të AKP-së, si dhe kërkesa nga pala e jashtme, gjithsej 11 kërkesa.

Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme:

- Gjatë kësaj periudhe nëntëmuajore kemi asistuar në dëbimin e uzurpatorëve të pronave shoqërore në rajonin e Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Gjilanit dhe Prishtinës, në gjithsej 62 njësi aty ku është shfaqur nevoja;
- Kemi bërë të gjitha riparimet e kërkuar si brava, cilindra, rregullime të dyerve dhe dritareve, riparimet sanitare si dhe riparimet e vogla elektrike, varësisht ku është shfaqur nevoja si në Zyrën Qendrore po ashtu edhe në Zyrat Rajonale të AKP-së, që në total janë 291 riparime;
- Janë protokolluar 240 fatura, të cilat janë përcjellë në Departamentin e Financave, prej tyre janë futur në freebalance 195 fatura, si dhe janë nënshkruar 208 urdhërblerje;
- Kemi mbuluar 310 kërkesa për furnizim me material administrativ;
- Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi iniciuar 13 deklarata të nevojave pas analizave dhe hulumtimeve dhe kërkesave për nevoja të ndryshme të AKP-së;

Zyra e Transportit:

- Gjatë kësaj periudhe 9 muajore kemi pasur 847 kërkesa për shërbime të rregullta dhe 1124 shërbime-kërkesa urgjente dhe të cilat janë mbuluar po ashtu;
- Në servisim i kemi pasur 63 vetura të cilat janë servisuar dhe vazhdon procesi i servisimit dhe i kontrollimit të të gjitha veturave sipas nevojës;
- Janë nënshkruar kontratat për furnizimin me karburante për vetura nga AQP-ja, kontrata për sigurimin e veturave dhe është bërë kontrollimi dhe regjistrimi i të gjitha veturave që i kemi, si dhe kontrata për pastrimin e veturave;

- Është bërë çregjistrimi i 3 veturave për shkak të vjetërsisë së tyre dhe gjatë servisimit të disa veturave Clio, kemi bërë ndërrimin e pjesëve duke ua marr pjesët këtyre veturave të cilat nuk do ti përdorim duke kursyer dukshëm shpenzimet e mirëmbajtjes së tyre;
- Është nënshkruar edhe kontrata për mirëmbajtjen dhe servisimin me kontraktin e ri "Europa" si dhe nga AQP-ja është nënshkruar kontrata 3 vjeçare për furnizimin me goma;
- Për shkak të mungesës së një vozitësi, i cili ka marr pushim pa pagesë për 3 muaj, vozitësit tjerë është dashur që të punojnë shpesh jashtë orarit për ti mbuluar kërkesat e shumta të stafit dhe Bordit të AKP-së.

5.11. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Departamenti i Prokurimit gjatë periudhës raportuese ka nënshkruar **51** kontrata duke përdorur të gjitha procedurat e prokurimit: procedura të prokurimit me vlerë të madhe, procedura e prokurimit me vlerë të mesme, kuotimi me vlerë të vogël dhe kuotimi me vlerë minimale si dhe procedura e negociuar pa publikim e njoftimit për kontratë. Vlera e përgjithshme e kontratave është **4,218,147.14** EUR.

Gjithsej janë **30** kontrata në kategorinë e shërbimeve dhe **21** janë Furnizime.

Departamenti i Prokurimit gjatë periudhës raportuese ka nënshkruar 51 kontrata duke përdorur të gjitha procedurat e prokurimit: procedura të prokurimit me vlerë të madhe, procedura e prokurimit me vlerë të mesme, kuotimi me vlerë të vogël dhe kuotimi me vlerë minimale si dhe procedura e negociuar pa publikim e njoftimit për kontratë.

Lista e kontratave të nënshkruara në Departamentin e Prokurimit për periudhën Janar- Shtator, 2016.

1. Shërbimet e internetit dhe rrjetit të Teknologjisë Informative
2. Furnizimi dhe montimi i pompave dhe kontraktorëve automatik
3. Certifikata për Server SSL (Secure Socket Layer) për 3 vite
4. Vlerësimi i investimeve të bëra nga Ndërmarrja "Sharrcem"
5. Kontrate me dy gazetë jashtë vendit: Dangraf dhe Daily press Vijesti
6. 10% kontratës bazë Furnizim me karburante për veturat e AKP-se
7. Shërbimet e Sigurimit Fizik Aneks 10% i kontratës bazë
8. Furnizim me pajisje të TI-se (laptop dhe skaner të avancuar)
9. Furnizime me karburante për ngrohje qendrore
10. Angazhimi i një kompanie të jashtme për përkthim
11. Aneks kontratë "Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave"
12. Furnizim me karrige për nevojat e AKP-se
13. Larja e veturave zyrtare të AKP-se
14. Prodhimi dhe shtypja e biznes kartelave
15. Emetimi i TV reklamave dhe shpalljeve
16. Auditimi i ndërmarrjeve të privatizuara me kushte të veçanta
17. Furnizim me naftë për vetura, furnizim me naftë për ngrohje dhe gjenerator -Procedure që e ka kryer AQP-ja për autoritete
18. Mirëmbajtja e databazës së njësive për Ankesa të Departamentit Ligjor
19. Ritender- Mirëmbajtja dhe servisimi i veturave
20. Furnizim me material administrativ për nevojat e AKP-së

21. Kontraktimi i Kompanisë për ofrim të shërbimit profesional për realizim të Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj
22. Mjetet për zërim dhe përkthim simulant
23. Ri-Shtypja e materialeve promovuese
24. Kontraktimi për shërbime të publikimeve në revistën The Economist
25. Shërbimi i Sigurimit Fizik
26. Publikimet në gazetën Sllovene, Maqedone dhe Bosnje e Hercegovine
27. Furnizim me pajisje për backup të serverëve
28. Aneks kontrate "Furnizim me tonerë"
29. Furnizim me material higjenik
30. Lidhja e kontratës për zyrën me qira në Shtëpi
31. Furnizimi dhe shtrirja me laminat 16m²
32. Furnizim me lule për nevoja të AKP-së
33. Furnizim me tonerë për nevoja të AKP-se
34. Ri-Ritender- Mirëmbajtja dhe servisi i veturave
35. Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative (TI-së)
36. Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative (TI-se) Bateria për UPS të serverit
37. Blerja e licencave për softuer
38. Rindërtimi dhe ri-dizajnimi i faqes së Internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (www.paks.org)
39. Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative (TI-së)
40. Publikim i njoftimit në gazetën Kroate
41. Sigurimi Fizik -Procedurë emergjent
42. Shfrytëzimi i platformës edukative dhe informative me portalin Qysh. Me
43. Furnizim me orëndi për Zyre
44. Angazhimi i Ofruesve të Shërbimeve Profesionale për likuidimin e portfolios të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) në Republikën e Kosovës
45. Kontratë për realizimin dhe transmetimin e reklamave promovuese të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Radio Stacione Lokale dhe Nacionale
46. Kontratë me të gjitha gazetat ditore të Kosovës: Koha Ditore, Kosova Sot, Epoka e Re, Zëri, Bota Sot
47. Vazhdim i Kontratës për arkivë ZR Prizren
48. Vazhdim i Kontratës për arkivë ZR Mitrovicë
49. Vazhdim i Kontratës për arkivë ZR Prishtinë
50. Vazhdim i Kontratës për arkivë ZR Gjiat
51. Vazhdim i Kontratës për arkivë ZR Pejë

5.12. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Në vazhdimësi paraqiten aktivitetet e NJAB-së gjatë periudhës Janar - Shtator 2016:

1. **Auditimi i Departamentit të Koordinimit të Likuidimit (DKL) dhe Autoriteteve të Likuidimit (AL):** duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it, ky auditim ka filluar në fund të muajit Tetor të vitit të kaluar. Auditimi në fjalë është përqendruar kryesisht në rishikimin e procedurave të Autoriteteve të

Likuidimit, gjegjësisht procesit të qiradhënies së aseteve nga AL-të. Pasi që ky auditim kishte kompleksitet më të madh, si dhe për shkak të vonesave në kompletimin e dokumentacionit nga Autoritetet e Likuidimit, ky auditim është finalizuar në fillim të vitit 2016. Bazuar në të gjeturat e auditimit dhe konkluzionet e dhëna, ky auditim ka rezultuar me 8 rekomandime përkatëse.

2. **Auditimi i Divizionit të Shitjes, përkatësisht Njesisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes:** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda Divizionit të Shitjes, përkatësisht në Njësinë e Kontrollit dhe të Mbikëqyrjes, nëse këto veprime ishin në pajtueshmëri me kornizën ligjore të AKP-së. Ky auditim ishte planifikuar të kryhej në fund të vitit 2015, mirëpo, gjatë kryerjes së këtij auditimi jemi ballafaquar me vonesën e ofrimit të disa informatave nga Sekretaria Ekzekutive e Bordit të Drejtorëve, e që kishin të bënin me disa vendime që ndërlidhen me Divizionin e Shitjes, andaj finalizimi i këtij auditimi është bërë në fillim të vitit 2016. Ky auditim ka rezultuar me 2 rekomandime përkatëse.
3. **Auditimi i Departamentit të Administratës (Njësia e Burimeve Njerëzore):** duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2016, ky auditim ka filluar në muajin Mars. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda Departamentit të Administratës, përkatësisht në Njësinë e Burimeve Njerëzore, nëse këto veprime ishin në pajtueshmëri me kornizën ligjore të AKP-së. Ky auditim ka rezultuar me gjithsej 12 rekomandime përkatëse.
4. **Auditimi i Departamentit të Koordinimit të Likuidimit (Njësia e Monitorimit të Likuidimit dhe Fondet e Mbetura, Njësia e Likuidimit dhe Njësia e Listave të Punëtorëve):** duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2016, ky auditim ka filluar në muajin Shkurt. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda Departamentit të Koordinimit të Likuidimit, përkatësisht në Njësinë e Listave të punëtorëve, Njësinë e Likuidimit dhe Njësinë e Monitorimit të Likuidimit dhe Fondet e Mbetura, nëse këto veprime ishin në pajtueshmëri me kornizën ligjore të AKP-së. Bazuar në të gjeturat e auditimit dhe konkluzionet e dhëna, ky auditim ka rezultuar me 7 rekomandime përkatëse.
5. **Auditimi i Departamentit të Prokurimit:** duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2016, ky auditim ka filluar në muajin Qershor. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda Departamentit të Prokurimit, nëse këto veprime ishin në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Ky auditim ka rezultuar me gjithsej 8 rekomandime.
6. **Auditimi i Departamentit të Koordinimit Rajonal (Zyra Rajonale e Prishtinës):** duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2016, ky auditim ka filluar në muajin Qershor. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda Departamentit të Koordinimit Rajonal, përkatësisht në Zyrën Rajonale të Prishtinës, nëse këto veprime ishin në pajtueshmëri me kornizën ligjore të AKP-së. Gjatë periudhës raportuese draft-raporti i këtij auditimi është diskutuar me Menaxhmentit dhe është në proces të finalizimit;
7. **Auditimi i Divizionit të Shitjes (Njësia e Administrimit Direkt):** duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2016, ky auditim ka filluar në muajin Gusht. Gjatë periudhës raportuese ky auditim është në fazën e kryerjes së testimeve;
8. **Auditimi i Departamentit të Financave dhe Buxhetit (Fondet në Mirëbesim):** duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2016, ky auditim ka filluar në fund të muajit Gusht. Gjatë periudhës raportuese ky auditim është në fazën e kryerjes së testimeve;
9. **Mbajtja e takimeve të Komitetit të Auditimit:** Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur tri takime të Komitetit të Auditimit. Në këto takime është diskutuar puna rreth aktiviteve të Njesisë së Auditimit

të Brendshëm si dhe janë diskutuar raportet e auditimit të kryera nga kjo njësi. Komiteti i Auditimit i ka dhënë mbështetje NJAB-it dhe e ka inkurajuar për vazhdimin e punës audituese;

10. **Pjesëmarrja në grupin punues lidhur me hartimin e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike:** Përfaqësuesi i NJAB-it, gjatë muajit Mars ka marrë pjesë në grupin punues për hartimin e ligjit në fjalë.
11. **Përgatitja e strategjisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2017-2019 si dhe përgatitja e Planit Vjetor të NJAB-it për vitin 2017:** Gjatë periudhës raportuese NJAB ka përgatitur Strategjinë për vitet 2017-2019 si dhe Planin e Punës për vitin 2017. Dokumentet e lartpërmendura i janë dërguar Menaxhmentit dhe Komitetit të Auditimit për komente eventuale. Këto dokumente pritet që të aprovohen nga Komiteti i Auditimit dhe Bordi i Drejtorëve në muajin Tetor.
12. **Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA):** Gjatë periudhës raportuese, është kryer auditimi i PF-ve të Fondeve në Mirëbesim dhe AKP-së për vitin 2015 nga ekipi i auditimit të ZKA-së. Raporti final i auditimit të ZKA-së është pranuar në fund të muajit Qershor. Ndërsa në muajin Korrik, konform kërkesave ligjore, AKP-ja ka përgatitur Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit të ZKA-së. I njëjti plan i është dorëzuar edhe Auditorit të Përgjithshëm.
13. **Fillimi i auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për AKP-në dhe Fondet në Mirëbesim nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA):** Në fund të muajit Shtator, ZKA-ja ka filluar auditimin preliminar të PVF-ve për AKP-në dhe Fondet në Mirëbesim për vitin 2016;
14. **Përcjellja e implementimit të rekomandimeve:** Gjatë periudhës raportuese NJAB ka filluar me auditimin e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve për periudhën 2009-2016;
15. **Përgatitja e dokumentacionit për palët e jashtme:** Gjatë periudhës raportuese NJAB ka pasur kërkesë nga Policia e Kosovës dhe Agjencia Kundër Korrupsionit lidhur me NSH të caktuara për dokumentacion, të cilin dokumentacion NJAB e ka përgatitur dhe dorëzuar konform kërkesave në fjalë.

5.13. NJËSIA PËR MEDIA DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Në përputhje me Planin Vjetor të Punës së AKP-së, raporti i Njesisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun për periudhën e vitit **2016** përfshinë realizimin e aktiviteve të parapara për realizimin e objektivave të përgjithshme.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka siguruar përkrahje të plotë për të gjitha aktivitetet e realizuara nga AKP, Institucioneve të Shtetit dhe Organizatave vendore dhe ndërkombëtare, përgatitja e komunikatave për media lidhur me takimet me Institucione ndërkombëtare dhe vendore, odat ekonomike dhe delegacione të ndryshme përgatitja e komunikatave për media dhe publikimin në veb faqen e Agjencisë dhe mediat sociale (face book, tëëitter dhe Instagram).

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun është pikë kontaktuese me media në ofrimin dhe sigurimin e komunikimit me media lidhur me aktivitet e Agjencisë, si në pranimin e pyetjeve dhe në përgatitjen e përgjigjeve duke u koordinuar me departamentet/njësitet përkatëse dhe Drejtorin Menaxhues. Njësia ka pasqyruar aktivitetet e Agjencisë tek mediat dhe opinioni i gjerë, duke prezantuar aktivitetet dhe qëndrimet e Agjencisë në media.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka përgatitur rreth **150** përgjigje me shkrim të dërguara përmes emailit në pyetje të gazetarëve të medieve të ndryshme;

- Prononcime përmes telefonit – Mbi **30** prononcime me telefon;
- Përgjigje dhe prononcime në **Televizione** - (Rreth **10** prononcimet në TV);

- Përgjigje dhe prononcime në **Radio**: Rreth **20** prononcime për Radio vendore dhe ndërkombëtare;

Njësia për Marrëdhënie me Publikun dhe Media, gjatë vitit 2016 ka hartuar dhe dërguar për media dhe përmes tyre tek opinioni i gjerë mbi **40 Komunikata për Media** për aktivitetet e ndryshme të Agjencisë, ndërkaq ka lëshuar 4 **Komunikata** në formë sqarimi/reagimi ndaj shkrimeve/deklaratave dezinformuese për Agjencinë.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka vazhduar të populloj ueb faqen e AKP-së me të gjitha informatat në lidhje me aktivitetet e Agjencisë dhe procesin e privatizimit në Kosovë.

Marrëdhënie me Publik dhe Qasje në dokumente Publike

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka bërë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në Dokumente, mbajtjen e evidencës së saktë për numrin e kërkesave për qasje në dokumente si dhe për numrin e lejuar apo refuzuar të këtyre kërkesave.

Janë përgatitur raporte të rregullta (çdo tre muaj) dhe këto raporte i janë dërguar njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit, e cila përgatit raportin gjithëpërfshirëse të institucioneve publike, për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

Numri i kërkesave të pranuar					
Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E kufizuar	Pa përgjigje	Arsye tjera
5	3	2			

5.14. KOMISIONET

Agjencia ka një numër të caktuar të komisioneve të cilat i kryejnë detyrat sipas udhëzimeve të Bordit apo Menaxhmentit.

KOMISIONI I BANESAVE PËR NSH-TË - SHITJA

Komisioni për Shitjen e Banesave në Pronësi të NSH-ve ka pranuar gjithsej **1421** kërkesa për blerje të banesave nga periudha 01/04/2012, prej të cilave deri me tani nga Bordi i AKP-së janë vendosur **886** kërkesa:

- Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2015, nga Komisioni për Shitjen e Banesave janë shqyrtuar 336 kërkesa dhe janë vendosur nga Bordi i Drejtorëve.
- Janë përmbyllur 170 kontrata për shitjen e banesave;
- Janë pranuar 186 kërkesa të reja për blerjen e banesave të cilat janë sistemuar në bazën e të dhënave;
- Gjatë periudhës raportuese Komisioni ka kërkuar 97 konfirmime nga Agjencia Kosovare e Pronës lidhur me atë nëse banesat për të cilat palët kanë paraqitur kërkesë për shitjen e banesave pranë AKP-së kanë qenë objekt kontesti pranë ish Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore apo tani pranë Agjencisë Kosovare për Prona;
- Janë draftuar gjithsej 97 Memorandume Informuese për kërkesat e paraqitura në Komision për shqyrtim.

KOMISIONI PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE JOLIGJORE NË PRONAT E NSH-VE

1. Komisioni ka vazhduar me pranimin e lëndëve gjatë periudhës raportuese si nga ana e anëtarëve të Komisionit, po ashtu edhe nga palët të cilët kanë ardhur për këshilla/kompletime të lëndëve dhe në fund i kanë dorëzuar personalisht në Komision;
2. Janë realizuar gjithsejtë 7 (shtatë) takime me anëtarët e Komisionit nga Zyrat Regjionale, pas konsultimeve dhe prezantimeve të lëndëve janë aprovuar 10 (dhjetë) lëndë me konkluzion pa vërejtje nga ana e anëtarëve të Komisionit. Po ashtu janë realizuar takime të shumta në teren për identifikimin e rasteve për së afërmi, janë vizituar pothuajse të gjitha Zyrat Rajonale pastaj me Zyrтарin Ligjor janë vizituar palët në teren;
3. Janë draftuar dhe firmosur afër 60 Konkluzione për 60 raste të shqyrtuara nga Komisioni;
4. Në vijim gjeni tabelën e rasteve të pranuar dhe të shqyrtuara në Komision.

	Pranuar	Aprovuar	Refuzuar	Në pritje
	70	39	1	31
Zyra Rajonale në Prishtinë	70	55	/	15
Zyra Rajonale në Mitrovicë	32	28	/	04
Zyra Rajonale në Prizren	55	0	/	55
Zyra Rajonale në Pejë	29	13	/	17
Pranuar gjatë periudhës raportuese				
GJITHSEJT	256	135	1	122

KOMISIONI PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE - KPS

Komisioni për përcaktimin e statusit juridik të ndërmarrjeve është Komision i themeluar me Vendim të Drejtorit Menaxhues të AKP-së më 15 Gusht 2012, në përputhje me nenin 11, pika 4 dhe nenin 16, pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenit 2.1 të Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të aprovuara më 28 shtator 2011.

Ky komision është themeluar me qëllim të përcaktimit të statusit juridik të ndërmarrjeve dhe aseteve që bien në kompetencën administrative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Të dhënat lidhur me shqyrtimin e KPS-ne në periudhën raportuese Janar-shtator 2016 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Statusi i KPS-ve	numri
1. Numri i KPS-ve të shqyrtuara nga Komisioni dhe aprovuar nga Bordi i Drejtoreve	21 KPS
2. Numri i KPS-ve të shqyrtuara nga Komisioni, por të pa aprovuara nga Bordi i Drejtoreve	7 KPS
3. Numri i KPS-ve të shqyrtuara nga Komisioni, për të cilat është njoftuar Menaxhmenti i AKP-së lidhur me pengesat për aprovim të mëtutjeshëm në Bordin e Drejtoreve	4 KPS
4. Numri i KPS-ve në proces shqyrtimi	17 KPS

7. RAPORTI PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PLANI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZAP–së TË DHËNA NË RAPORTIN E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË VITIT 2015 PËR FONDIN E PRIVATIZIMIT DHE AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Data e fundit e freskimit të këtij plani nga AKP është: **28 korrik 2016**

Reko mandi mi nr.	Neni në raport	Fa qe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
1.	1.4	12	Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari i BD-së: Të rishqyrtoj mundësinë e përfshirjes së shpenzimeve të likuidimit në buxhetin e Agjencisë, në mënyrë që fondet në mirëbesim të mos zvogëlohen përmes transferimeve për t'i mbështetur shpenzimet e Agjencisë.	- Bordi i Drejtorëve; - Menaxhmenti i AKP-së	31 dhjetor 2016	Edhe pse vendimi për financimin e procesit të likuidimit është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në Qershor 2012, AKP vazhdimisht ka kërkuar mjete buxhetore për procesin e likuidimit gjatë procesit të rishikimit gjysmë vjetor të buxhetit të vitit 2016, buxhetit të vitit 2016, rishikimit gjysmë vjetor të vitit 2015, si dhe tani gjatë procesit të buxhetit të vitit 2017. Buxheti ndahet nga Ministria e Financave, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës.

Reko mandi mi nr.	Neni në raport	Fa qe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
2.	1.4	12	Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari i BD-së: Të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshij rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF duhet të dorëzohet nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	- Bordi i Drejtorëve; - Menaxhmenti; - Departamenti i Financave	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm. Pasi është themeluar Komiteti i Auditimit, për pasqyrat financiare të vitit 2016 Menaxhmenti dhe KA do të bëjnë rishikimin e pasqyrave financiare para finalizimit të tyre.
3.	2.3	14	Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i BD-së: Të siguroj zbatimin e plotë dhe me kohë planin e rishikuar për adresimin e rekomandimeve. Kjo duhet të monitorohet në baza të rregullta kohore dhe arsytet për mos adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak duhet të përcaktohen nga zyrtarët relevant dhe t'i raportohen menaxhmentit.	- Bordi i Drejtorëve; - Menaxhmenti; - Departamentet dhe Njësitë përkatëse brenda AKP	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm. Në bashkëpunim ndërmjet Menaxhmentit dhe Komitetit të Auditimit.
4.	2.4	15	Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari i BD-së: Të siguroj se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	- Menaxhmenti si dhe - Të gjitha departamentet/ njësitë brenda AKP-së.	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.
5.	2.5.1	16	Hartimi i objektivave strategjike	Kryetari i BD-së: Të siguroj se janë ndërmarrë veprime për vendosjen e objektivave strategjike dhe hartimin e planit strategjik.	- Menaxhmenti si dhe - Të gjitha departamentet/njësitë brenda AKP-së	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm. Plan i punës për vitin 2017 dhe objektivat strategjike të Agjencisë për periudhën e

Reko mandi mi nr.	Neni në raport	Fa qe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
							ardhshme do të përgatiten marrë parasysh strategjinë e përmbylljes së aktiviteve nga ana e AKP-së.
7.	2.5.3	17	Raportimi Menaxherial	Kryetari i BD-së: Të shqyrtoj shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushat e cekura dhe të siguroj eliminimin e tyre në mënyrë që të përmirësoj dobësitë në procesin e shpenzimeve.	- Menaxhmenti - Departamenti i Financave dhe Buxhetit; - Departamenti i Administratës	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.
8.	2.5.3	17	Raportimi Menaxherial	Kryetari i BD-së: Duhet të sigurojnë rekrutim të stafit me kohë për të minimizuar periudhën e ushtruesit të detyrës.	- Bordi i Drejtorëve; - Menaxhmenti	19 maj 2016 (I implementuar)	Për pozitat në të cilat zyrtarët përkatës janë të suspenduar (pra, pozitat nuk janë të lira), është e pamundur marrja e ndonjë mase përpos caktimit të zyrtarëve tjerë si u.d për plotësimin e atyre pozitave.
9.	2.6	18	Qeverisja e mirë	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm: KA duhet të rishikoj në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe ti ofroj sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.	- Komiteti i Auditimit	30 korrik 2016 (I implementuar)	Komiteti i Auditimit është themeluar nga Bordi i Drejtorëve dhe është plotësisht funksional që nga muaji Shkurt 2016. KA-ja gjatë periudhës Shkurt-Qershor, në vazhdimësi ka bërë rishikimin e

Reko mandi mi nr.	Neni në raport	Fa qe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
							veprimeve të ndërmarra lidhur me rekomandimet e auditimit të brendshëm.
10.	3.1	20	Fondet në Mirëbesim	Kryetari i BD-së: Të siguroj se dokumentacioni i shitjes/tenderimit përmban informatat e sakta dhe të drejta në veçanti ato për sipërfaqen e objektit të shitjes. Po ashtu, të siguroj se është analizuar rasti dhe të kuptoj arsyet e paraqitjes së sipërfaqes së gabuar në dokumenta- cionin e shitjes përfshirë edhe ato të publikuara.	- Departamenti i Koordinimit Rajonal (Zyrat Rajonale) - Departamenti i Shitjes - Menaxhmenti	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm gjatë proceseve të ardhshme të tenderimit.
11.	3.1.2	21	Të hyrat nga qiratë	Kryetari i BD-së: Të siguroj se të gjitha kontratat për qiratë të jenë të nënshkruara nga qiramarrësit.	- Autoritetet e Likuidimit; - Departamenti i Koordinimit Rajonal (Zyrat Rajonale përkatese); - Menaxhmenti	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.
12.	3.2.1	22	Shpërndarja e 20% të punëtorëve	Kryetari i BD-së: Të siguroj se është bërë marrëveshja me BSPK-në për të siguruar një monitorim dhe harmonizim se shpërndarja e 20% është bërë ashtu siç është pritur.	- Departamenti i Koordinimit të Likuidimit; - Departamenti i Financave; - Menaxhmenti	31 dhjetor 2016	Sipas nevojës do të rishikohet marrëveshja me BSPK-në.
13	3.2.2	23	Ofruesi i shërbimeve profesionale	Kryetari i BD-së: Të siguroj që OSHP-ja ka shtuar dinamikën e kryerjes së punëve si dhe hartimin e raporteve finale të likuidimit, në mënyrë që procesi i likuidimit të përfundojë brenda afatit kohor të paraparë me kontratë. Po ashtu, të siguroj që në kontratën eventuale të ardhshme, të parashihet që kërkesat kolektive të së njëjtës natyrë të mos trajtohen si	- Menaxheri i Kontratës; - Departamenti i Koordinimit të Likuidimit; - Menaxhmenti	31 dhjetor 2016	Kontrata e AKP-së me OSHP-në ka skaduar më 9 Korrik 2016. Varësisht nga rrethanat e reja të krijuara, do të ndërmerren masat konform situatës së

Reko mandi mi nr.	Neni në raport	Fa qe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
				individuale në mënyrë që të kursehet kohë dhe mjete financiare.			re të krijuar. Varësisht situatave që janë brenda kontrollit të AKP-së, procesi do të vazhdoj pa pengesa. (Zbatim i vazhdueshëm)
14	3.3	24	Llogaritë e Arkëtueshme	Kryetari i BD-së: Të siguroj se janë hartuar afate të qarta kohore për mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe marrjen e masave ligjore për t'i realizuar ato.	- Departamenti i Koordinimit Rajonal - Departamenti i Financave dhe Buxhetit; - Menaxhmenti; Bordi i Drejtorëve	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.
15	3.4	25	Llogaritë e Pagueshme	Kryetari i BD-së: Të siguroj se është ndërtuar një sistem i besueshëm i kontrollit për pranimin e faturave, pagesën e tyre brenda afatit ligjor si dhe prezantimin e obligimeve në PVF.	- Departamenti i Administratës; - Departamenti i Financave dhe Buxhetit; - Menaxhmenti	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.
16	4.3	28	Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari i BD-së: Të siguroj se janë analizuar arsyet për mos realizimin e buxhetit dhe të përcaktoj veprimet praktike për të përmirësuar mangësitë. Për më tepër, të ketë një ndikim më të madh në të gjithë pjesëmarrësit në planifikim të buxhetit, për të krijuar buxhetin më real financiar dhe në përputhje me objektivat e organizatës.	- Menaxhmenti si dhe - Të gjitha departamentet/njësit ë brenda AKP-së	30 tetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.
17	4.4	29	Prokurimi	Kryetari i BD-së: Të siguroj ndjekjen e procedurave në mënyrë kronologjike ashtu siç përcaktohet me kornizën rregulluese.	- Departamenti i Prokurimit; - Departamenti i Financave dhe Buxhetit	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.

Reko mandi mi nr.	Neni në raport	Fa qe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
18	4.5.1	30	Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	Kryetari i BD-së: Të siguroj që zbatimi i procedurave me rastin e rekrutimit të punonjësve të bëhet konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi për shërbyesit civil.	- Njësia e Burimeve Njerëzore; - Menaxhmenti	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.
19	4.5.1	31	Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	Kryetari i BD-së: Të siguroj që zbatimi i procedurave me rastin e avancimit dhe gradimit të nëpunësve të bëhet konform rregullores mbi avancimin dhe gradimin e punonjësve.	- Njësia e Burimeve Njerëzore; - Menaxhmenti	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.
20	4.5.1	31	Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	Kryetari i BD-së: Të siguroj kryerjen e vlerësimeve të performancës për të gjithë punonjësit.	- Njësia e Burimeve Njerëzore; - Menaxhmenti; - Bordi i Drejtorëve	31 janar 2017	Zbatim i vazhdueshëm.
21	4.6.1	32	Pasuritë kapitale dhe jo- kapitale	Kryetari i BD-së: Duhet të siguroj që pasuritë regjistrohen në grupimet e pasurive sipas kriterëve për regjistrimin e tyre.	- Departamenti i Financave dhe Buxhetit	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.
22	4.6.2	33	Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari i BD-së: Duhet të forcoj nivelin e kontrolleve mbi menaxhimin e shpenzimeve të telefonisë mobile dhe të krijojë një sistem për arkëtimin e obligimeve të krijuara si rezultat i tejkalimeve të limiteve të përcaktuara.	- Departamenti i Financave dhe Buxhetit - Të gjitha departamentet/ njësitë brenda AKP-së	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.
23	4.6.3	34	Trajtimi i borxheve	Kryetari i BD-së: Duhet të inicioj një analizë për furnizimet/shërbimet e marra pa u mbuluar me kontratë dhe të siguroj që ZKF e ka shtuar fokusin duke ofruar një sistem të besueshëm të kontrollit për shërbimet apo furnizimet e porositura.	- Departamenti i Administratës; - Departamenti i Financave dhe Buxhetit; - Menaxhmenti	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.

Reko mandi mi nr.	Neni në raport	Fa qe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
24	4.6.3	35	Trajtimi i borxheve	Kryetari i BD-së: Të siguroj që faturat evidentohen dhe protokolohen në librin e faturave dhe pastaj të bëhet shpërndarja për zyrtarët përkatës. Kjo praktikë mundëson që raportimi i obligimeve të jetë i saktë dhe i plotë dhe jep informata të plota për menaxhmentin dhe palët tjera për obligimet aktuale.	- Departamenti i Administratës (Njësia e Protokollit)	31 dhjetor 2016	Zbatim i vazhdueshëm.

SHTOJCA 1. LISTA E NDËRMARRJEVE NËN ADMINISTRIM DIREKT SIPAS NENIT 6.1

Nr.	Emri i NSH-ve nën AD	Vendi	Data e hyrjes në AD	Komente
1	NSH "Ereniku-Industria"	Gjakove	22/06/2011	
2	NSH "Boksitet e Kosoves"	Kline	20/01/2012	
3	MIM Golesh	Lipjan	31 Gusht 2014	

SHTOJCA 2. LISTA E TRANSAKSIONEVE SIPAS NENIT 8 DHE NENIT 9

Nuk ka pasur shtje nëpërmjet likuidimit gjatë periudhës Janar – Shtator 2016:

Shitja	Data e Shitjes	Nr i Aseteve	Nr. i Ofertave të Pranuara	Gjithsej Vlera e Ofertave EUR	Tërheqjet, Anulimet EUR	Gjithsej Vlera EUR	Nr. i Aseteve të anuluar nga BiD, tërheqjet	Shitjet e realizuara	Shitjet e parealizuar – në proces
Vala 59	09.10.2013	1	6		-	951,000	-	1	-
Total						951,000			


SHTOJCA 3. LISTA E NDËRMARRJEVE NË PROCES TË RIORGANIZIMIT

Nr.	Emri i NSH-ve	Vendi	Komente
1	Trepça	Mitrovicë	Sipas Aktvendimit të Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme, data e fundit për dorëzimin e planit të riorganizimit është 1 Nëntor 2016.

SHTOJCA 4. LISTA E NDËRMARRJEVE TË LIKUIDUARA SIPAS NENIT 9

N	Komuna	Emri i NSh-së	Kategoria	Data e fillimit të procesit të likuidimit	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në Bordin e AKP-së	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në DhPGjS	Aktevendimi i DhPGjS për mbylljen e likuidimit
1	Pejë	Kooperativa Bujqësore "Vitimirica"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	27 qershor 2013	16 maj 2016	18 korrik 2016	1 gusht 2016
2	Prizren	NSh Shoqata "Auto Moto"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	11 qershor 2013	16 maj 2016	18 korrik 2016	2 gusht 2016
3	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Bibaj"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	3 mars 2014	16 maj 2016	18 korrik 2016	22 gusht 2016
4	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Xhafa"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	23 qershor 2014	31 gusht 2016	21 shtator 2016	29 shtator 2016

SHTOJCA 5. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT



8. LISTA E RAPORTEVE FINANCIARE VJETORE

Në shtojcë të raportit vjetor janë paraqitur këto raporte financiare:

PASQYRAT FINANCIARE TË BUXHETIT TË AGJENCISË (faqe 1 deri 17)

PASQYRAT FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM (faqe 1 deri 24)